



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 475 Akti

Nr. 467 Vendimi
Tiranë, më 29.10.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 27.10.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Silvana Lule**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Silvana Lule, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 16.12.2019, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

2. Në përfundim të shortit rezultoi se subjekti i rivlerësimit Silvana Lule do të shqyrtohet nga trupi gjyqësor, i cili përbëhet nga komisionerët: Alma Faskaj relatore, Genta Tafa (Bungo) kryesuese dhe Lulzim Hamitaj anëtar.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë.

4. ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Silvana Lule, duke krahasuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting* me deklaratat e pasurisë në vite dhe dokumentacionin justifikues bankar dhe jobankar etj., të dorëzuar nga subjekti me të dhënat e kërkuara me anë të korrespondencës pranë institucioneve publike. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, për subjektin e rivlerësimit Silvana Lule, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

5. DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

6. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Silvana Lule (deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.2.2021, të KDZH-së), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

7. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura

sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

8. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, të trupit gjykues nr. 2, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; si dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesues i trupit gjykues komisionere Genta Tafa (Bungo). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

9. Në datën 14.4.2020 subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi përbërjen e trupit gjykues, për të cilin më 15.4.2020 deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

10. Në datën 5.10.2021, trupi gjykues me vendimin nr. 2, vendosi të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Silvana Lule, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes.

11. Po në të njëjtën datë, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i kaluar barrën e provës për sa ka rezultuar nga hetimi dhe duke i dhënë të drejtën të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40 dhe 45-47, të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe të paraqesë shpjegime/prova shtesë, brenda datës 17.9.2021.

12. Në datën 8.10.2021, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes. Në datën 18.10.2021 nëpërmjet komunikimit elektronik subjekti kërkoi kohë shtesë për të paraqitur mbrojtjen në kuadër të këtij procesi dhe trupi gjykues, pasi shqyrtoi këtë kërkesë, e gjykoi atë të arsyeshme duke e shtyrë afatin e shpjegimeve më 25.10.2021.

13. Në datën 25.10.2021 subjekti i rivlerësimit dërgoi shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit kryesisht, të shoqëruar me dokumentacion.

14. Në datën 25.10.2021, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Silvana Lule në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më 27.10.2021, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

15. Në datën 27.10.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit ishte e pranishme.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Silvana Lule u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

17. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit Silvana Lule shprehu qëndrimin e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni.

18. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Znj. Silvana Lule ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin dhe shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

22. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

23. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

24. Në kreun VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

25. Por, referuar vendimit nr. 2/20171, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite, dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, që gjenden në dosjen e këtij subjekti dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës së dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLD-ja; (ë) denoncimet e

publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

27. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u vijua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti dhe ligjshmërinë e burimit dhe të krijimit të saj.

28. Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës *Vetting*, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Silvana Lule.

29. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat private për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

30. Procesi i rivlerësimit për komponentin e pasurisë nga Komisioni është bazuar në: (i) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (ii) pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratat vjetore të pasurisë për vitet 2008 – 2016 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur; (iii) hetimin e pasurive të personave të tjerë të lidhur; (iv) dokumentacionin e administruar nga hetimi administrativ.

31. Subjekti i rivlerësimit Silvana Lule e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë *Vetting* (duke përfshirë personat e lidhur), në datën 27.1.2017, në bazë të ligjit nr. 84/2016, fakt ky i konfirmuar nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Pra, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi.

32. Subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka ushtruar këto detyra:

- a) në periudhën 2006 – 2008 ka kryer Shkollën e Magjistraturës;
- b) në periudhën nëntor 2008 – tetor 2009 ka kryer stazhin profesional në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë;
- c) në periudhën 15 dhjetor 2009 – 22 shkurt 2016, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Vlorë (tetor 2013 – shkurt 2016, e komanduar në Tiranë);
- d) shkurt 2016 – aktualisht, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.

33. Në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë deklaruar këto pasuri dhe likuiditete:

A/1. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

I. Pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*

1. Në deklaratën *Vetting* subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri në pronësi të saj dhe as detyrime financiare ndaj të tretëve.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

1.1 Në deklaratat periodike vjetore 2008 – 2016 subjekti nuk ka deklaruar pasuri të saj.

1.2 Komisioni mori informacion nga institucionet¹, të cilat konfirmuan² se nuk ka automjet apo pasuri të paluajtshme të regjistruara në emër të subjektit dhe se subjekti dhe personat e lidhur nuk rezultojnë aplikues në procesin e legalizimit.

Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të provave të administruara, trupi gjykues çmon se subjekti ka bërë deklaram të saktë dhe nuk ka pasuri të regjistruara në pronësi të saj.

II. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*

1. Vlera totale *neto* prej 10,013,467 lekësh për periudhën 2006 – dhjetor 2016, e cila përfshin të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, nga pagat dhe nga sigurimet shoqërore (raport lejelindje).

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

1.1 Në deklaratat periodike ka deklaruar të ardhurat nga burimet si më lart.

1.2 Komisioni mori informacion zyrtar³ nga institucionet financiare dhe publike dhe duke u mbështetur në praktikën e tij, përfshiu në analizë të ardhurat e periudhës së stazhit profesional gjatë ndjekjes së Shkollës së Magjistraturës, në tetor të vitit 2008, e në vijim.

Vlerësimi i Komisionit

Në analizë të provave të administruara dhe shpjegimeve, trupi gjykues çmoi se deklarimi i subjektit përputhet me vlerat e konfirmuara nga institucionet në lidhje me të ardhurat e saj.

A/2. Deklarimi i personit të lidhur të subjektit, bashkëjetuesit, në deklaratën *Vetting*

1. Subjekti ka deklaruar si person të lidhur bashkëjetuesin e saj, z. F. H. .

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

1.1 Bashkëjetuesin, si person të lidhur, subjekti e ka deklaruar për herë të parë në deklaratën periodike të vitit 2014, ndërsa e pyetur nga Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1 se në cilat adresa ka banuar që prej marrjes së detyrës, deklaroi adresën ku ka banuar me bashkëjetuesin që prej tetorit të vitit 2013.

1.2 Komisioni pyeti subjektin mbi arsyen pse në DIPP-në e vitit 2013 nuk e ka deklaruar z. F.H. si person të lidhur⁴.

1.3 Subjekti shpjegoi⁵ se në Tiranë është zhvendosur për shkak të komandimit në tetor të vitit 2013 dhe meqenëse komandimi ishte i përkohshëm, jetesa në banesën e marrë me qira prej familjes së bashkëjetuesit ishte diçka e përkohshme dhe se nëse komandimi nuk do të kishte vazhduar, do të ishte kthyer në banesën e prindërve në Vlorë. Subjeti iu bashkëlidhi shpjegimeve aktet e komandimit.

¹DPSHTRR dhe ASHK.

²Informacion dërguar në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 23.11.2020 të KPK-së dërguar ASHK- së, e cila ua ka përcjellë drejtorive vendore. Shkresa nr. *** prot., datë 16.12.2020 e ASHK-së. Shkresa nr. *** prot., datë 16.12.2020, e DPSHTRR.

³Shkresat: nr. *** prot., datë 25.6.2021, nga “Raiffeisen Bank” dhe nr. *** prot., datë 9.7.2021, nga ISSH-ja.

⁴Pyetësori nr. 4.

⁵ Në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

1.4 Duke pasur parasysh sa më lart, trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2013, bashkëjetuesin si person të lidhur dhe pasuritë e tij dhe as adresën e tij si adresë banimi.

Qëndrimi i subjektit

1.5 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti u njoh me këtë konstatim dhe me prapësimet e dërguara, parashtroi se:

“Gjatë vitit 2013 kam ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë deri më 16.10.2013, ndërsa gjatë kësaj kohe z. F. H. ka qënë i punësuar në Drejtorinë Rajonale ALUIZNI Tiranë, të dhëna të cilat konstatohen nga dokumentet që i përkasin dosjes që Komisioni administron, në cilësinë time si subjekt rivlerësimi.

Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm për komandimin e prokurorit mban datën 16.10.2013 dhe është urdhëruar komandimi për një periudhë 4- mujore. Në atë kohë, pas njoftimit të urdhrit, unë kam marrë kontakt me Drejtuesin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të cilit i kam kërkuar leje për të përgatitur dorëzimin e dosjeve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe për të sistemuar akomodimin tim në qytetin e Tiranës, si edhe konstatohet nga të dhënat e administruara nga regjistri i çështjeve penale në Prokurorinë e Tiranës, ngarkesa ime ka filluar vetëm pas datës 12.11.2013⁶.

Në shpjegimet e mia në pyetësorin standard i jam referuar muajit tetor, në pjesën që kam shpjeguar vendbanimet, duke e kujtuar si muajin kur kam marrë komandimin e parë, pa i dhënë rëndësi datës, por edhe si rezulton nga sa më sipër, efektivisht gjatë vitit 2013 unë kam jetuar ndoshta më pak se dy muaj në banesën që shtetasi F. H. dhe familja e tij kishin marrë me qira në qytetin e Tiranës. Në atë periudhë kjo është menduar si një zhvendosje e përkohshme e banimit, për shkak të ndryshimit të vendit të punës. Kjo është edhe arsyeja pse në pyetësorin standard kam vendosur muajin tetor në pjesën që kërkohen vendbanimet e subjektit prej momentit të fillimit të detyrës dhe në pjesën e bashkëjetesës kam shpjeguar se gjatë vitit 2014, kam bashkëjetuar me z. F.H. .

Siç edhe e kam shpjeguar gjatë pyetësorit, duke qënë se komandimi ka qënë një procedurë e përkohshme (i cili nuk pritej nga ana ime), unë dhe z. F. H., në atë kohë nuk kemi pasur plane për të ardhmen. Unë e kam shpjeguar se, nëse komandimi nuk do të përsëritej, do të kthehesha sërish në qytetin e Vlorës, për shkak të detyrës. Sipas ligjit nr. 8737, viti 2001, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë’, i ndryshuar me ligjin nr. 9102, viti 2001 dhe ligjin nr. 1005, viti 2008, parashikohej se Prokurori i Përgjithshëm mund të komandojë prokurorë nga prokuroritë ku punojnë, në prokurori të tjera: (a) jo më shumë se katër muaj në vit, në rastet kur një prokurori nuk funksionon normalisht, për shkak të pamjaftueshmërisë së numrit të prokurorëve dhe të mbingarkesës së tyre. Ky afat mund të zgjatet deri në tetë muaj, nëse prokurori i komanduar jep pëlqimin’. Në fakt, në nëntor të vitit 2015, pasi kisha përfunduar lejen e lindjes dhe unë nuk kisha ende një emërim (komandim tjetër) në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë kam qëndruar sërish së bashku me vajzën e mitur, në banesën e prindërve të mi, në Vlorë, deri në muajin shkurt të vitit 2016.

Në atë periudhë, por edhe gjatë gjithë vitit 2014, pasur parasysh se kemi jetuar në një banesë me qira, bashkë me familjen e bashkëjetuesit, fundjavat i kam kaluar në banesën e prindërve të mi në qytetin e Vlorës.

⁶Shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, çështjet penale të vitit 2013, prokuror S. Lule.

Për sa më sipër, dua të shpjegoj se nisur nga këto rrethana, si edhe referuar legjislacionit shqiptar në lidhje me bashkëjetesën, sipas të cilit kjo e fundit kërkon domosdoshmërisht dy elementë stabilitet dhe vazhdimësi, vetëm periudha dymujore që i përket fundit të vitit 2013, nuk ka pasur një kohëzgjatje të tillë, që të konsiderohet bashkëjetesë mes një çifti.

Sipas nenit 163 të Kodit të Familjes ‘Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas, që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie’. Ndërsa neni 164 parashikon se ‘personat bashkëjetues, mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa, lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës’. Unë dhe z. F.H. nuk e kemi një marrëveshje të tillë gjë që do të thotë se në raportin pasuror, secili administron dhe disponon pasuritë e tij, pa u ndikuar nga pala tjetër.

Në këto kushte, unë e kam deklaruar shtetasin F. H. si bashkëjetues për shkak se gjatë vitit 2014, marrëdhënia jonë ishte e tillë që përmbushte kërkesat e nenit 163 të Kodit të Familjes dhe vlerësoj se në këtë rast kam qenë korrekte me ligjin.

Për më tepër, kërkoj të shtoj se pavarësisht se legjislacioni shqiptar ka një parashikim ligjor shumë të ngushtë për bashkëjetesën, për analogji kërkoj të sjell parashikimet që ligji nr. 95/2016, ‘Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar’, neni 3, sipas të cilit ‘anëtar i afërt i familjes nënkupton përveç bashkëshortit dhe bashkeshortes, fëmijët mbi 18 vjeç dhe çdo person të lidhur nga martesë apo gjaku, i cili banon më shumë se 120 ditë në vit, në të njëjtin vendbanim’. Referuar ligjit konkret, i cili ka specifikime më strikte në lidhje kontrollin e subjekteve të tij, rezulton se minimalisht personat duhet të jetojnë në një banesë më shumë se 120 ditë, me qellim deklarimin e tyre si anëtar i familjes.

Fundi i vitit 2013 ka qenë një periudhë e shkurtër, rrethanat më vonë sollën që ajo të ishte vetëm fillimi i një periudhe që më vonë do quhej bashkëjetesë, e cila u quajt e tillë për shkak të konsolidimit të marrëdhënies më vonë.

Bashkëjetesa, duke kërkuar kohëzgjatje, vazhdimësi dhe stabilitet është një situatë ligjore e cila, ndryshe nga martesë, nuk i fillon efektet e saj menjëherë, ajo kërkon kohë të konsolidohet. Sigurisht që nëse do të bëhej fjalë për ndryshimet në gjendjen time civile, ato do të deklaroheshin nga ana ime atë vit.

Kështu, pasur parasysh se sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike’ i ndryshuar, në deklaratën periodike duhet të deklarohet gjendja deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës, të interesave private që burojnë ndër të tjera ... nga marrëdhëniet e bashkëjetesës, marrëdhënie e cila referuar rrethanave të mia konkrete nuk ka qenë e tillë, e vazhdueshme apo deri në atë kohë të kishte krijuar stabilitet, për shkak se vetë kohëzgjatja nuk e lejonte një gjë të tillë, vlerësoj se bashkëjetesa nuk ka qenë një marrëdhënie e cila do të duhej të deklarohet atë vit.

Në lidhje me mosdeklarimin e adresës në deklaratën e interesave private periodike për vitin 2013, shpjegoj se si edhe sqaruar më lart, periudha e shkurtër kohore nuk i përmbushte parashikimet ligjore sipas nenit 14/2, të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, ‘Për gjendjen civile’ sipas të cilit ‘banesën, në të cilën shtetasi jeton zakonisht për më shumë se tre muaj pa ndërprerje ose më shumë se gjashtë muaj në një vit kalendarik, ka detyrimin ta deklarojë si vendbanimin e tij’.

1.6 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim si në parashtrimet e bëra më parë me shkrim, të sipërcituara.

Vlerësimi i Komisionit

1.7 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se rezultoni e provuar se deklarimi që subjekti ka bërë lidhur me bashkëjetuesin në DIPP-në vjetore është në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon deklarimin e pasurisë dhe të personave të lidhur në cilësinë e bashkëjetuesit. Deklarimi për herë të parë gjatë procesit të rivlerësimit i faktit të adresës së banimit të personit të lidhur, në Tiranë, gjatë peridhës tetor 2013 – dhjetor 2013, është bërë për të qenë transparent gjatë procesit të rivlerësimit, në raport me adresat ku subjekti ka qëndruar, qoftë dhe në periudha të shkurtra kohore. Vetë fakti i ekzistencës së një akti komandimi dhe jo një vendimi transferimi të përhershëm të subjektit në Tiranë, është në koherencë dhe me qëndrimin që bashkëjetesa e subjektit nuk ka ekzistuar gjatë vitit 2013. Qëndrimi i trupit gjykues lidhur me këtë fakt merret në konsideratë edhe lidhur me pasojat e konstatimeve në lidhje me me pasuritë e bashkëjetuesit, të krijuara para periudhës së bashkëjetesës.

2. Personi i lidhur i subjektit (bashkëjetuesi) ka deklaruar disa pasuri të fituara me vendime të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si vijon:

2.1 Sipërfaqe toke prej 3,300 m², e llojit “pemëtore”, me nr. pasurie ***, z. k. ***, në Sarandë-Q. P. . Pjesa në përqindje: 1/24 pjesë.

2.2 Sipërfaqe toke prej 3,500 m², e llojit “pemëtore”, me nr. pasurie ***, z. k. ***, në Sarandë-Q.P. . Pjesa në përqindje: 1/24 pjesë.

2.3 Sipërfaqe toke prej 40,000 m², e llojit kullotë, në Sarandë, P., me nr. pas ***, z. k. ***. Kjo pasuri është përfituar me vendim të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave në vitin 2008, në favor të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar I. H. dhe Xh. H. Pjesa në përqindje: 1/24 pjesë.

2.4 Një sipërfaqe toke prej 3,100 m² tokë bujqësore P., B., Sarandë, përfituar prej vendimit nr. ***, datë 12.9.2008, i ZRKKP-së Vlorë. Kjo pasuri ende nuk është regjistruar në ZRPP.

2.5 Një sipërfaqe prej 10,000 m² tokë bujqësore, B., Sarandë. Me vendim të Zyrës Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave është njohur e drejta e kompensimit të kësaj prone dhe jo kthimi në natyrë.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

2.6 Në deklaratat periodike të personit të lidhur, sipërfaqet e pasurive janë deklaruar në total dhe si origjinë e pasurive janë deklaruar vendime të AKKP-së Vlorë me të tjerë numra dhe data nga ato të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

2.7 ZVRPP-ja Sarandë konfirmoi⁷ se këto pasuri (përveç asaj që është deklaruar e paregjistruar) janë të regjistruara në emër të shtetasit F.H., në bashkëpronësi.

2.8 Komisioni i kërkoi subjektit⁸ të japë të dhëna më konkrete për pasuritë e fituara me vendime të AKKP-së, të deklaruara nga personi i lidhur në DIPP-të vjetore, duke përcaktuar saktësisht secilën prej pasurive të fituara me vendime të AKKP-së, të dhënat e tyre dhe vendimin e AKKP-së për secilën prej tyre.

⁷Shkresat e ZVRPP-së Sarandë përcjellë në ILDKPKI nga ZQRPP-ja me nr***prot., datë 10.10.2017 dhe *** prot., datë 11.7.2018.

⁸Pyetësori nr. 4.

2.9 Subjekti paraqiti sqarime⁹ të shoqëruara me dokumentacionin përkatës për secilën prej pasurive.

Vlerësimi i Komisionit

2.10 Në përfundim, në analizë të shpjegimeve të paraqitura dhe provave të administruara, trupi gjykues çmoi se:

- Këto pasuri janë fituar nga personi i lidhur para se të fillonte bashkëjetesën me subjektin e rivlerësimit dhe nuk ka të dhëna që subjekti ka kontribuar në fitimin e tyre.
- Deklarimi përputhet në deklaratën *Vetting* me dokumentacionin e përcjellë në Komision.
- Pasaktësitë në deklarin e bashkëjetuesit në DIPP-të vjetore në lidhje me sipërfaqet e secilës prej pasurive dhe numrin e vendimeve të AKKP-së, që kanë shërbyer si origjinë e këtyre pasurive, janë korrigjuar në deklaratën *Vetting* dhe nuk vlerësohen si element relevant në vlerësimin e pasurisë.

3. Automjet tip “Citroen C3”, me targa ***, viti i prodhimit 2005, blerë në datën 31.1.2014, me faturë shitjeje nr. *** shitësi shoqëria “****” sh.p.k. Vlera: 420,000 lekë. Pjesa në përqindje: 100%.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura të siguruara nga paga si punonjës i ALUIZNI-t.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

3.1 Kjo pasuri është deklaruar nga personi i lidhur i subjektit, bashkëjetuesi i saj F. H. në deklaratën periodike të subjektit të vitit 2014. Vlera e deklaruar në këtë deklaratë është 4,000 euro. Pjesa në përqindje: 100%.

3.2 Ky automjet me nr. shasie *** është blerë nga personi i lidhur i subjektit, bashkëjetuesi F.H., në vlerën 420,000 lekë dhe është regjistruar në pronësi të tij në datën 31.1.2014¹⁰.

3.3 Policëmbajtës i vetëm i policës së sigurimit TPL dhe pronar në periudhën 1.2.2014 – 17.4.2021 është personi i lidhur i subjektit, F. H.¹¹.

3.4 Komisioni hetoi mbi ekzistencën e mundshme të konfliktit të interesit për shkak të funksionit të subjektit, me shitësin e automjetit.

3.5 Rezultoi¹² se subjekti i rivlerësimit ka hetuar një çështje ku kallëzues ishte z. S. Gj., që është edhe administrator i shoqërisë nga e cila bashkëjetuesi ka blerë automjetin dhe, në përfundim, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për këtë kallëzim të kryer nga shtetasi S.Gj..

3.6 Kallëzimi penal është kryer nga ky person jo në cilësinë e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., por si person fizik tregtar¹³ dhe ky kallëzim është përcjellë në prokurori pothuajse 2 vjet

⁹Në përgjigje të pyetësorit nr. 4.

¹⁰Shkresa nr. *** prot., datë 26.9.2018, e DPSHTRR-së, përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja.

¹¹Informacioni i përcjellë nga AMF me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. ***prot., datë 15.12.2020), si dhe informacioni i marrë nga sistemi elektronik AMF.

¹²Shkresa nr. *** prot., datë 31.5.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.6.2021).

¹³Kallëzuesi si person fizik tregtar regjistruar në QKB me objekt veprimtarie ndër të tjera “dhënie makinash me qira”, ka lidhur kontratë qiradhënie për një makinë me një shtetas, i cili nuk e ka kthyer makinën në afatin e caktuar në kontratë. Kontratën e ka nënshkruar me NIPT-in e personit fizik dhe jo me atë të shoqërisë “****” sh.p.k. Më pas, makinën e kanë kthyer disa persona të tjerë, jo vetë qiramarrësi, i cili sipas qiradhënësit (kallëzuesit) kishte detyrime monetare të pashlyera ende në lidhje me këtë

pasi është blerë automjeti. Për pasojë duket se vendimi nuk është marrë në kushtet e konfliktit të interesit.

3.7 E pyetur nga Komisioni¹⁴ nëse gjatë gjithë periudhës së deklaramit ka përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emrin e dikujt tjetër, subjekti u përgjigj: “Gjatë periudhës së deklaramit nuk kam përdorur prona të regjistruara në emrin e dikujt tjetër, përveç vitit 2014, kur kam përdorur me raste autometin tip ‘Citroen’, me targa ***, në pronësi të F.H. . Shpjegoj me raste, për shkak se gjatë kësaj periudhe për shkak të shtatzënisë, gjendja ime fizike nuk e lejonte të drejtoja automjetin”.

3.8 Në shpjegimet e dhëna në datën 4.12.2015 para inspektorit të ILDKPKI-së të dokumentuara me procesverbal¹⁵, personi i lidhur i subjektit, bashkëjetuesi F. H. ka deklaruar se: “Automjetin tip ‘Citroen C3’ me targa *** e përdor Silvana”.

3.8.1 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 3¹⁶, ka deklaruar se ky automjet është përdorur dhe përdoret aktualisht prej z. E.H. (vëllai i bashkëjetuesit).

3.9 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë u hartua analiza financiare, në të cilën u analizua mundësia e bashkëjetuesit për të blerë automjetin me të ardhurat nga paga nga ALUIZNI, sipas deklaramit të tij për burimin në deklaratën *Vetting*. Në këtë analizë u administruan të dhënat e marra nga deklaratat e dorëzuara në ILDKPKI nga personi i lidhur (bashkëjetuesi) gjatë periudhës kur ishte në funksionin e drejtuesit ALUIZNI-t Tirana 3 dhe dokumentacioni për periudhën kur ai ka qenë punonjës pranë këtij institucioni. Referuar këtyre deklaratave nuk rezultoi shuma *cash* ose kursime të deklaruara prej tij, të cilat do të mund të përfshiheshin në analizën financiare. Pra, në këtë analizë u përfshinë të ardhurat e personit të lidhur prej prillit të vitit 2012 deri në datën e blerjes së automjetit, datë 31.1.2014. Gjithashtu, në vlerën e automjetit u përfshi përveç çmimit të kontratës, edhe vlera e shpenzimeve të tjera (targa, taksa) prej 69,070 lekësh.

Analiza financiare	Prill 2012 - Dhjetor 2012 (vlerat në lekë)	Janar - Tetor 2013 (vlerat në lekë)
Të ardhurat e bashkëjetuesit	572 245	678 969
Shpenzime jetike për 1 anëtar	104 661	117 520
Likuiditete në fillim të periudhës	-	706 855
Likuiditete në fund të periudhës	706 855	1 419 454
Shpenzime udhëtimi	13 972	50 517
Rezultati financiar	-253 243	-201 667

Nga analiza rezultoi se personi i lidhur i subjektit nuk ka pasur mundësi të blejë automjetin me burimin e ligjshëm të deklaruar, pasi rezultoi me pamundësi financiare për periudhën prill 2013 - tetor 2013, në të cilën ka qenë i punësuar në drejtorinë e ALUIZNI-t.

kontratë. Qiradhënësi ka bërë kallëzim penal për të cilin subjekti i rivlerësimit, prokurorja Silvana Lule ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, pasi në rastin konkret kemi të bëjmë me një detyrim të lindur nga kontrata e qirasë dhe çështja në fjalë përbën mosmarrëveshje civile, për të cilën palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi.

¹⁴Pyetësori standard.

¹⁵Pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

¹⁶Datë 20.6.2021.

3.10 Në lidhje me bashkëjetesën, Komisioni, në analizën e vet ka konsideruar deklaratimet e subjektit në DIPP-në e vitit 2014, ku deklaroi si bashkëjetues z. F. H., si dhe shpjegimet në pyetësorin standard, ku deklaroi se bashkëjetesa ka filluar në tetor të vitit 2013.

3.11. Në përfundim, në analizë të provave të administruara, trupi gjykues çmoi se:

- i. Ky automjet është fituar nga bashkëjetuesi gjatë bashkëjetesës.
- ii. Në hetimin nga subjekti i çështjes me kallëzuesin z. S. Gj., subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit.
- iii. Ka mospërputhje midis çmimit të deklaruar në deklaratën periodike dhe vlerës së automjetit sipas kontratës së shitjes (çmimi në deklaratat periodike pas blerjes së automjetit është deklaruar 4,000 euro, ndërsa në deklaratën Vetting dhe në faturën e shitjes është 420,000 lekë. Sipas kursit të këmbimit të kohës, vlera 4,000 euro është rreth 560,000 lekë).
- iv. Ka mospërputhje midis deklaratimit të subjektit në pyetësorin standard dhe deklaratimit të personit të lidhur para ILDKPKI-së në lidhje me kohën e përdorimit të automjetit nga subjekti (subjekti ka thënë se e përdorte me raste në vitin 2014, ndërsa personi i lidhur, në dhjetor të vitit 2015 ka deklaruar që *këtë automjet e përdor Silvana*).
- v. Duket se bashkëjetuesi nuk ka pasur mundësi financiare të blejë automjetin me të ardhura të ligjshme.

3.12 Me dërgimin e rezultateve të hetimit sipas pikës 2, të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e hetimit.

Qëndrimi i subjektit

3.13 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit me të cilat iu kalua barra e provës, subjekti depozitoi në Komision shpjegime të shoqëruara me dokumentacion¹⁷.

3.13.1 Në lidhje me konstatimin e Komisionit mbi diferencën e çmimit të automjetit të kontratës së shitjes me deklaratimin në DIPP, subjekti shpjegoi:

“Në lidhje me sa më lart, kërkoj t’i shpjegoj Komisionit se kjo ka qenë një pakujdesi e bashkëjetuesit dhe duke qenë se nuk kam qenë palë në kryerjen e këtyre veprimeve, është një e dhënë për të cilën unë nuk kam qenë në dijeni dhe nuk mund të ndikoj në plotësimin e saj. Bashkëjetuesi nuk ka pasur eksperiencë në plotësimin e deklaratave periodike. Plotësimin e DPV-së për herë të parë e ka bërë në vitin 2012. Pavarësisht pasaktësisë në deklaratën periodike, kërkoj të shpjegoj se gjithçka është saktësuar në deklaratën Vetting, sipas çmimit të dokumentuar”.

3.13.2 Në lidhje me mospërputhjen e deklaratimeve mbi kohën e përdorjes së automjetit, subjekti shpjegon:

¹⁷(i) shkresë nr. *** prot., datë 12.10.2021, DRSHTRR, në lidhje me lejen e drejtimit S. Lule me afat nga data 9.4.2008 – 8.4.2018; (ii) gjobat në lidhje me automjetin tip “Citroen C3”, me targa ***; (iii) deklaratë noteriale nr. ***, E. H., ku ai deklaroi se automjeti është përdorur prej tij nga viti 2016 pa asnjë kontratë të nënshkruar prej tyre dhe se nga ajo datë policat e sigurimit janë paguar prej tij; (iv) aplikim e-albania E. H., automjet me targa ***; (v) deklaratë individuale e të ardhurave vjetore E. H.; (vi) policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike nr. serie ***, periudha e sigurimit 12.2.2020 - 11.2.2021, e paguar nga shtetasi F.H. .

*“Në pyetësor kam shpjeguar se gjatë vitit 2014 kam përdorur me raste automjetin tip ‘Citroen C3’, me targa ***, në pronësi të bashkëjetuesit, për shkak se atë vit, ky nuk ka qenë një mjet i cili është përdorur eskuzivisht prej meje, nuk e kam pasur për përdorim të përditshëm apo gjatë gjithë kohës. Gjatë këtij viti, përveç bashkëjetuesit, ky mjet është përdorur edhe prej vëllait të tij z. E.H., për të cilin kam shpjeguar se kemi qëndruar në atë kohë në të njëjtën banesë, së bashku me nënën e tyre.*

Vajza ime ka lindur në dhjetor të vitit 2014 dhe për shkak të kushteve fizike të shtatzënisë, ka pasur periudha gjatë këtij viti, që nuk kam pasur mundësi ta përdor. Në vijim, deri në nëntor të vitit 2015, kam qenë me leje lindje dhe nuk e kam përdorur këtë mjet, fëmija ka qenë e vogël, si edhe për shkak se nuk më është nevojitur.

Në shkurt të vitit 2016 kam marrë detyrën sërish në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe duke qenë se banesa ime është pranë vendit të punës, rreth 7-10 min rrugë duke ecur në këmbë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale është më afër, por edhe kopshti që vajza ka frekuentuar, kopësht shtetëror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të trafikut, pamundësisë së parkimit, për mua është më e lehtë mospërdorimi i një mjete në jetën e përditshme.

Prej hetimit ka rezultuar se policëmbajtës i vetëm i policës së sigurimit TPL dhe pronar deri më 17.4.2021 është bashkëjetuesi shtetasi F. H., sepse ai dhe i vëllai, për shkak të marrëdhënies familjare nuk kanë lidhur mes tyre një kontratë përdorimi apo të kenë nënshkruar një akt përdorimi. Në këto kushte, kur bëhet pagesa e policës së sigurimit, ajo rezulton në emër të pronarit, por nisur edhe nga dokumentet e dorëzuara, vlerësuar edhe nënshkrimin ku aktet e Komisionit janë administruar shkresa të firmosura nga bashkëjetuesi im, rezulton se nënshkrimi nuk është i tij. Qëllimi i blerjes së këtij automjeti nga bashkëjetuesi ka qenë përdorimi i tij edhe nga i vëllai, E. .

Në lidhje me deklarinimin e tij në ILDKPI në dhjetor të vitit 2015, besoj se ai duhet t’i jetë referuar faktit që ka pasur raste që e kam përdorur më parë gjatë vitit 2014, por mund të ketë qenë edhe një gabim i përpiluesit të procesverbalit, për shkak se edhe si shpjegova më lart, deri në nëntor të vitit 2015, unë kam qenë me lejen e lindjes. Në fakt, gjatë këtij viti (2015) ky mjet është përdorur nga bashkëjetuesi dhe vëllai i tij E. H. dhe kryesisht pas vitit 2016, është përdorur më së shumti prej këtij të fundit.

Prej datës 8.4.2018 nuk e kam rinovuar lejen e drejtimit, për shkak se si edhe kam shpjeguar më lart, për momentin nuk e kam pasur të nevojshme.

*Në lidhje me këtë konstatim kam mundur të siguroj një pjesë të gjobave për këtë automjet, në të cilën përcaktohet vendi i marrjes së gjobës, prej nga rezulton se të paktën vitet e fundit gjobat janë vënë pranë banesës në të cilën vëllai i bashkëjetuesit ka jetuar, referuar edhe deklarinimit të banesës që ai ka bërë në deklaratën vjetore të të ardhurave (në këtë formular ai ka shënuar si adresë banimi të ndryshme nga të dhënat e identifikueshme lagjja ‘***’, pall. ‘***’, shk. ***, ap. ***, k. ***, Tiranë).*

*Kështu, sipas procesverbalit për konstatimin e shkeljes nr. serie ***, datë 7.9.2021, ora 09⁵⁰; nr. ***, datë 12.7.2021, ora 12⁰⁴, nr. ***, datë 26.3.2021, ora 08³⁰, nr. ***, datë 9.11.2020, ora 08²¹, etj. Gjoha është vendosur në lagjen ‘***’, rr. ‘***’, Tiranë, ndërsa sipas procesverbalit nr. ***, datë 9.10.2019, ora 18³⁸, nr. ***, datë 9.5.2015, ora 03⁰⁰, kundërvajtës E.H. .*

Gjithashtu, kam mundur të siguroj edhe disa prej aplikimeve që E.H. ka bërë nëpërmjet sistemit e-albania për leje pune, gjatë periudhës së pandemisë, duke përdorur automjetin tip 'Citroen', me targa ***. Së fundi, kërkoj të shtoj se kam shpjeguar në pyetësor se e kam përdorur me raste, për shkak se kjo ka qenë e vërteta dhe sepse edhe nëse do ta përdorja, pasur parasysh që ai është automjet në pronësi të bashkëjetuesit, si edhe i deklaruar prej tij, në vlerësimin tim përdorimi i tij nuk do të më sillte penalizime në kuadër të këtij procesi, por edhe të kontrollit nga ILDKPI-ja”.

3.13.3 Në lidhje me pamundësinë financiare për blerjen e automjetit, subjekti shpjegoi:

“Ka qenë një pasaktësi nga ana e bashkëjetuesit deklarimi në DIPP i vlerës 4,000 euro. Referuar edhe faturës së shitjes, vlera e tvsh-së në shitje ka qenë 70,000 lekë. Njësia ligjore pranë Komisionit, në analizën financiare për vitin 2014 ka konsideruar se vlera e automjetit të blerë është 489,070 lekë (420,000 lekë + 69,070 lekë). Vlerësoj se duhet të ndryshohet kjo vlerë, në analizën financiare, pasi nuk është paguar prej bashkëjetuesit tim vlera prej 69,070 lekësh, që i përket detyrimit të TVSH-së në doganë. Në deklaratën doganore ***, datë 23.1.2014, në cilësinë e importuesit është shoqëria ‘***’ sh.p.k. dhe vlera e tvsh-së në doganë e paguar sipas deklaratës është 69,070 lekë. Kjo shumë, është TVSH e zbritshme për subjektin ‘***’ sh.p.k.

Në analizën financiare kryer prej Komisionit, për periudhën prill 2012 – dhjetor 2012, nuk janë përfshirë kursimet familjare në periudhat përpara vitit 2012.

Analiza financiare për vitin 2013 në vlerësimin tim duhet të ndahet në dy periudha, për të treguar qartësisht mundësinë e kursimit dhe blerjes së automjetit tip 'Citroen'. Sikurse është konstatuar edhe nga Komisioni, shuma prej 5,000 euro është depozituar nga bashkëjetuesi F.H. në datën 9.1.2013. Nëse i referohemi mundësisë së kursimit për depozitim e shumës 5,000 euro në këtë datë, në analizë do të përfshihen edhe kursimet familjare të familjes së bashkëjetuesit.

Mundësia e kursimit për periudhën vijuese nga data 10.1.2013 deri në tetor të vitit 2013 do të ndryshojë bazuar në analizën financiare për këtë periudhë.

Analiza financiare	10 janar - tetor 2013 (vlerat në lekë)
Të ardhurat e bashkëjetuesit	683,572
Të ardhurat nga interesi depozit	17,354
Shpenzime jetike për 1 anëtar	117,520
Likuiditete në fillim të periudhës	1,410,355
Likuiditete në fund të periudhës	1,515,111
Vlera e blerjes së automjetit ***	
Shpenzime udhëtimi	50,517
Rezultati financiar	428,133

Sqarime për analizën financiare 10 janar 2013 - 31 tetor 2013

Të ardhurat e bashkëjetuesit janë të ardhurat e kaluara në llogarinë bankare në 'Credins Bank' nga data 10 janar 2013 deri në datën 31 tetor 2013.

Të ardhurat nga interesi i depozitës në shumën 123,77 euro, janë njohur me kursin e këmbimit të likuiditeteve në fund të periudhës, K. K. 140.21.

Likuiditete në fillim të periudhës përbëhen nga shuma 10,000 euro, njohur me kursin e këmbimit të fund periudhës, për të mos krijuar diferenca nga kursi i këmbimit. Gjendja në datën 10 janar në llogarinë e 'Credins Bank' 10,410 lekë dhe llogarinë në 'Raiffeisen Bank'.

Likuiditete në fund të periudhës, përbëhet nga depozita në ‘Tirana Bank’ në vlerën 10,123.77 euro, njohur me kursin e këmbimit 140.21, gjendja e llogarisë në ‘Credins Bank’ në shumën 95,657 lekë.

Nga analiza financiare për mundësinë e kursimit rezulton se bashkëjetuesi ka pasur mundësi të kursejë shumën prej 428,133 lekësh.

Në lidhje me faktin se bashkëjetuesi nuk ka deklaruar kursime apo cash, në momentin kur ka dorëzuar deklaratën pas largimit nga detyra, kërkoj të shpjegoj se kjo e fundit është dorëzuar prej tij në maj të vitit pasardhës, kohë në të cilën shuma ka qenë e shpenzuar për blerjen e mjetit, nisur edhe nga koha kur është dorëzuar deklarata. Gabimi në plotësimin e deklaratës ka ardhur si pasojë e mungesës së informacionit të mjaftueshëm për mënyrën e plotësimit të formularit të deklaratës së interesave pas largimit nga detyra”.

3.13.4 Në lidhje me hetimin e kallëzimit penal të shtetasit S. Gj., pavarësisht se Komisioni nuk i kishte lënë barrë prove dhe kishte vlerësuar se subjekti nuk kishte qenë në konfliktin e interesit, subjekti shpjegoi se:

*“Blerja dhe veprimet e tjera në lidhje me këtë automjet janë veprime që janë kryer prej bashkëjetuesit tim, duke qenë se nuk kam kryer veprime të tilla, nuk mund të prezumohej dijenia ime në lidhje me shoqërinë, ortakët, administratorët prej të cilëve ajo është blerë. Pavarësisht sa më lart, bashkëjetuesi më ka shpjeguar se ky person nuk njihet prej tij dhe se në faturën e shitjes së datës 31.1.2014 shoqëria shitëse ka qenë ‘***’ sh.p.k. Ky person ka qenë administrator për një periudhë shumë të shkurtër në vitin 2013 dhe në momentin e marrjes së vendimit nga ana ime, ky person nuk ka qenë administrator dhe ortak i kësaj shoqërie. Pavarësisht se në lidhje me kallëzimin e tij është vendosur mosfillimi i procedimit, gjë që tregon që nuk mund të ketë pasur favorizim, për sa më lart, e kam shpjeguar se nuk mund të isha në dijeni të faktit se kush ishte ky person”.*

3.14 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim, për secilën nga çështjet e mësipërme.

Vlerësimi i Komisionit

3.15 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se:

3.15.1 Në lidhje me konstatimin mbi diferencën e çmimit të automjetit të kontratës së shitjes me deklarimin në DIPP, kjo është një pasaktësi e cila është saktësuar në deklaratën *Vetting*.

3.15.2 Në lidhje me mospërputhjen e deklarimeve mbi kohën e përdorjes së automjetit, shpjegimet e parashtruara nga subjekti dhe dokumentacioni shoqërues i përcjellë prej tij janë bindëse dhe shpjegojnë mospërputhjen në deklarime.

3.15.3 Në faturën e shitjes së automjetit, vlera e shitjes është 420,000 lekë dhe kjo është vlera që duhet të përfshihet në analizën e Komisionit, pasi provohet me dokumentacion ligjor. Vlera e TVSH-së prej 69,070 lekësh, e llogaritur dyfish, do të zbritet nga vlera e automjetit në analizën financiare.

3.15.4 Në lidhje me konstatimin e subjektit se deklarata është plotësuar në maj të vitit pasardhës dhe meqenëse vlera e kursimeve është përdorur për blerjen e automjetit nuk është deklaruar dhe ky ka qenë një gabim i personit të lidhur në plotësimin e deklaratës, Komisioni, në praktikën e tij

për kursimet, njeh si provë deklaratimet vjetore në DIPP dhe harresa ose gabimet në plotësim nuk e shmangin përgjegjësinë dhe nuk rrisin provueshmërinë e deklaratimit. Për këtë arsye qëndrimi i Komisionit mbetet i njëjtë për këtë çështje.

3.15.5 Në lidhje me analizën financiare të automjetit, trupi gjykues vlerësoi se duhet të mbështetet në deklaratimin e kryer në deklaratën *Vetting* nga bashkëjetuesi. Pra, në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat nga paga e ALUIZNI-t dhe shpenzimet vetëm të bashkëjetuesit gjatë vitit 2013. Gjithashtu, është përfshirë gjendja e likuiditeteve në “Tirana Bank” në fillim të periudhës (janar 2013) të bashkëjetuesit, e cila rezulton nga vlera e depozitës 5,000 euro e derdhur në datën 24.12.2012. Ndërsa parashtrimet e subjektit mbi gjendjen e likuiditeteve në fillim të periudhës nuk janë të provuara, pasi depozitimi i shumës së dytë prej 5,000 euro është bërë në datën 7.1.2013 dhe jo më herët. Ndërsa në “Credins Bank” gjendja e llogarisë së bashkëjetuesit në fillim të vitit 2013 është 10,410 lekë, vlera e së cilës është përfshirë në analizën financiare.

3.15.6 Analiza financiare e automjetit pas ndryshimeve më lart është me pamundësi financiare, sipas tabelës vijuese.

Analiza financiare	Janar - Tetor 2013 (vlerat në lekë)
Të ardhurat e bashkëjetuesit	683 572
Të ardhurat nga interesi i depozitës	11 077
Shpenzime jetike për 1 anëtar	117 520
Likuiditete në fillim të periudhës	706 855
Likuiditete në fund të periudhës	1 419 454
Shpenzime udhëtimi	50 517
Rezultati financiar	-185 987

Pamundësia financiare e subjektit për krijimin e pasurisë rezulton në vlerën 185,987 lekë nga ajo e dërguar me rezultatet e hetimit prej 201,667 lekësh.

3.16 Në përfundim, Komisioni çmoi që vlerësimin në lidhje me këtë gjetje ta bëjë në raport me tërësinë e vlerësimeve për pasuritë e tjera në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë.

4. Automjet tip “Audi” me targa ***, viti i prodhimit 2003, blerë me kontratën nr. ***, datë 26.10.2011, pranë notere S. H., Vlorë. Ky automjet është blerë për shumën 600,000 lekë, bashkëpronar me shtetasin G. H. . Vlera: 600,000 lekë. Pjesa në përqindje: 50%.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: të ardhura nga paga si punonjës i ZRPP-së Vlorë.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

4.1 Kjo pasuri nuk është deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën periodike të subjektit të vitit 2014 dhe as në vitet 2015 dhe 2016.

4.2 Këtë pasuri personi i lidhur i subjektit (bashkëjetuesi) e ka deklaruar në deklaratat e viteve 2012 dhe 2013 (para fillimit të detyrës dhe pas largimit nga funksioni), të plotësuara prej tij si subjekt deklarimi për shkak të detyrës së tij (drejtor i ALUIZNI-t Tirana 3).

4.3 Ky automjet me nr. shasje *** është i regjistruar në DPSHTRR në bashkëpronësi të bashkëjetuesit të subjektit, z. F.H. dhe vëllait të tij G. H.¹⁸. Dosja e automjetit, e përcjellë nga DPSHTRR-ja, ka shënimin “bllokuar nga INTERPOL-i”¹⁹.

4.4 Shtetasit F. dhe G. H. e kanë blerë automjetin nga shtetasi N. B. në datën 26.10.2011²⁰ në vlerën 600,000 lekë. Automjeti është blerë fillimisht nga një shtetas banues në Shkup në datën 19.5.2005, ka hyrë nga pika e kontrollit të kalimit kufitar Durrës dhe është zhdoganuar në datën 19.5.2005.

4.5 Në datën 21.9.2016, bashkëjetuesi i subjektit F.H. dhe vëllai i tij G. H. ia kanë shitur këtë automjet shtetasit N. H. ²¹ në vlerën 1,500 euro.

4.6 Komisioni pyeti subjektin²² mbi arsyen pse nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *Vetting* dhe në deklaratat e interesave periodike vjetore 2016 - 2017 kontrata e shitblerjes së këtij automjeti me palë shitëse G. dhe F. H. dhe palë blerëse N. H. .

4.7 Subjekti deklaroi²³ se sipas shpjegimeve të bashkëjetuesit, pas nënshkrimit të kontratës së shitjes, automjeti i ka rezultuar blerësit me probleme dhe, në këto kushte, ky i fundit e ka kthyer atë. Shuma që përbënte çmimin i është kthyer blerësit dhe palët janë kthyer në gjendjen e mëparshme. Duke mos pasur pretendime nga asnjëra prej palëve, nuk është parë e nevojshme zgjidhja e kontratës nga ana formale. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti paraqiti një deklaratë noteriale²⁴ ku z. F. H. deklaroi këtë fakt të shpjeguar nga subjekti.

4.8 Në kontratën e shitjes së automjetit të lidhur në datën 21.9.2016 midis shtetasve F. dhe G. H. në cilësinë e shitësit dhe N. H. në cilësinë e blerësit, palët janë shprehur se: “*Pala blerëse njeh gjendjen reale fizike, teknike të mjetit objekt kontrate dhe është dakord me çmimin e blerjes*”. Në certifikatën e kontrollit fizik të automjetit lëshuar shtetasit N. H. në datën 3.10.2016 për automjetin me targa ***, rezultoi shënimin “mjeti i rregull”.

4.9 Në periudhën 25.5.2012 – 7.6.2016, policëmbajtës i policës së sigurimit TPL dhe pronar është z. F. dhe/ose G. H.²⁵. Polica e fundit e sigurimit TPL për këtë automjet është shitur në datën 7.6.2016²⁶.

4.10 Komisioni kërkoi informacion mbi arsyen dhe kohën e bllokimit²⁷ dhe nga INTERPOL Tirana, u informua²⁸ se ky automjet vazhdon të jetë në kërkim ndërkombëtar, i shpallur në kërkim INTERPOL Shkupi/Maqedoni e Veriut. Vjedhja është regjistruar në sistemin ASF të INTERPOL-it në datën 12.10.2015, me afat regjistrimi në ASF deri më 12.10.2025.

4.11 Nga sistemi *TIMS* rezultoi se subjekti apo personi i lidhur me të (bashkëjetuesi) nuk kanë kaluar asnjëherë jashtë territorit shqiptar me këtë automjet.

¹⁸Shkresat nr. *** prot., datë 22.6.2018 dhe nr*** prot., datë 26.9.2018, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

¹⁹Shkresa nr***prot., datë 26.9.2018, e DPSHTRR-së, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

²⁰Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 26.10.2011, lidhur në Vlorë para noterës S. H. .

²¹Kontrata e shitblerjes nr. ***, datë 21.9.2016, lidhur në Vlorë para noterës S. H. .

²²Pyetësori nr. 2.

²³Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

²⁴Deklaratë noteriale nr. ***, datë 10.12.2020, lidhur para noterit A. S., Tiranë, administruar në Komision me nr. ***, datë 14.12.2020.

²⁵Sipas sistemit elektronik të AMF-së.

²⁶Shkresa nr. *** prot., datë 11.12.2020, e AMF-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 15.12.2020) dhe sistemi elektronik AMF.

²⁷Shkresa me nr.*** prot., datë 9.6.2021, drejtuar Iterpol Tirana.

²⁸Shkresë nr. *** KLProt/LA***/2016/KA/2021, datë 14.6.2021, të klasifikuar “sekret”.

4.12 Pjesë e dokumentacionit të automjetit janë edhe disa dokumente që lidhin automjetin me shtetasin R.N., por pa qartësuar lidhjen juridike dhe/ose faktike të këtij të fundit me automjetin. Rezulton se dosja e automjetit është transferuar nga DRSHTRR-ja Tiranë në DRSHTRR-në Vlorë pas kërkesës së z. R. N. për transferim dhe pjesë e dosjes janë dokumente të shtetasit për efekt të procedurave të transferimit²⁹. Kërkesa është bërë nga ky i fundit 6 ditë para se automjetin ta blinte personi i lidhur i subjektit.

4.13 E pyetur nga Komisioni mbi këtë fakt, DRSHTRR-ja Vlorë shpjegoi se kërkesa për transferim të dosjes është bërë gabim në emër të z. R. N. dhe se automjeti mbeti në pronësi të bashkëpronarëve H., pasi rezultoi pozitiv në testin e interpolit³⁰.

4.14 Komisioni hetoi mbi ekzistencën e konfliktit të interesit të subjektit për shkak të detyrës së saj, me shitësit e automjetit dhe me z. R. N., i cili ka kërkuar transferimin e dosjes së automjetit në Vlorë. Nga hetimi³¹ rezultoi se gjatë kohës që subjekti ushtronte detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka hetuar një çështje penale kundër të pandehurit R. N. dhe, në përfundim të hetimeve, ka vendosur dërgimin e saj në gjyq për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” më shumë se një herë, por rezultoi se hetimi në lidhje me këtë person është bërë në vitin 2010, kërkesën për transferimin e automjetit në Vlorë, ky shtetas e ka bërë në tetor të vitit 2011, ndërsa bashkëjetesën me blerësin e këtij automjeti subjekti e ka filluar në tetor të vitit 2013.

4.15 Për të analizuar nëse subjekti ka hetuar këtë çështje në kushtet e konfliktit të interesit, trupi gjykues mori në konsideratë faktet si vijojnë:

- a) hetimi në lidhje me këtë person është bërë në vitin 2010, ndërsa bashkëjetesën me blerësin e këtij automjeti e ka filluar në tetor të vitit 2013;
- b) çështja është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në datën 15.7.2010 dhe gjykata ka disponuar me vendim në datën 23.6.2011;
- c) subjekti ka kërkuar deklarinimin fajtor të shtetasit R. N.;
- d) subjekti ka kërkuar masë më të madhe dënimi nga dënimi i dhënë nga gjykata;
- e) kërkesën për transferimin e automjetit në Vlorë, shtetasi R. N. e ka bërë në tetor të vitit 2011 (pasi është dhënë vendimi i gjykatës).

4.16 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se në hetimin e kësaj çështjeje subjekti nuk ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, ndërsa për gjetjet e tjera në lidhje me këtë pasuri vlerësoi se:

4.16.1 Kjo pasuri është fituar nga personi i lidhur (bashkëjetuesi) i subjektit para se të fillonte bashkëjetesën dhe nuk ka të dhëna që subjekti të ketë ndikuar në fitimin e kësaj pasurie, por kontrata e shitjes së automjetit nga bashkëjetuesit është lidhur gjatë bashkëjetesës.

²⁹Vërtetim banimi i z. R. N., lëshuar nga Bashkia Vlorë; certifikatë e kontrollit fizik të mjetit me nr. serie ***, lëshuar z. R. N. nga DPSHTRR-ja Vlorë, sipas së cilës kontrolli u krye më 14.10.2011; vërtetim për çregjistrimin e mjetit nr. ***, datë 11.11.2011, lëshuar nga DPSHTRR-ja Tiranë, sipas të cilit transferimi është bërë bazuar në kërkesën e DPSHTRR-së Vlorë dhe të z. R. N. .

³⁰Shkresa nr. *** prot., datë 2.6.2021 (protokolluar në Komision me nr*** prot., datë 7.6.2021), korrigjuar dhe plotësuar me shkresën nr*** prot., datë 17.6.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 21.6.2021). Me këtë shkresë, DPSHTRR-ja ka sqaruar se: “Mjeti me nr. Vin. *** është regjistruar me targa ***. Targa aktuale e mjetit është ***. Kërkesa për transferim dosje është bërë gabim në emër të z. R.N., kjo vërehet nga veprimi në sistem “për gabime materiale”. Mjeti mbeti në pronësi të z. G. B. H. dhe z. F. B. H. pasi rezultoi pozitiv në testin e interpolit në momentin e ekzekutimit të kontratës nr. ***, datë 21.9.2016, ku pala blerëse është z. N. V. H. . Nuk kemi informacion për arsyen e bllokimit prej Interpolit...”.

³¹Shkresa nr. *** prot., datë 31.5.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.6.2021).

4.16.2 Është i dyshimtë fakti që automjeti rezulton në kërkim ndërkombëtar, regjistruar në sistemin ASF të Interpolit në datën 12.10.2015 (me afat regjistrimi në ASF deri më 12.10.2025), ndërkohë personi i lidhur i subjektit (dhe vëllai i tij) për këtë automjet të bllokuar nga INTERPOL-i ka blerë policën e sigurimit në datën 7.6.2016 dhe në datën 21.9.2016 ia kanë shitur shtetasit N. H. në vlerën 1,500 euro (e kishin blerë 600,000 lekë në vitin 2011).

4.16.3 Shpjegimi që kontrata e shitblerjes së automjetit nuk është deklaruar pasi ajo është revokuar *de facto* për shkak se automjeti kishte probleme, nuk u provua dhe nga dosja e automjetit rezulton se është i rregullt nga ana teknike, fizike dhe blerësi njeh gjendjen e tij. Nëse problemet nënkuptonin faktin e bllokimit të tij nga INTERPOL-i, do të thotë se personi i lidhur i subjektit e dinte që po përdorte një automjet të shpallur në kërkim ndërkombëtar.

4.16.4 Rezulton se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë dalë asnjëherë jashtë kufijve të Shqipërisë me këtë automjet, por në të gjitha udhëtimet jashtë Shqipërisë kanë qenë me automjete të tjera.

4.16.5 Është i dyshimtë fakti që DRSHTRR-ja Vlorë, në datën 20.10.2011 (6 ditë para se automjetin ta blinte bashkëjetuesi i subjektit), ka kërkuar transferimin e dosjes së automjetit në Vlorë, me kërkesë të shtetasit R. N., i cili nuk rezulton pronar në asnjë nga dokumentet e administruara në dosje dhe, më pas, po DRSHTRR-ja ka shpjeguar se emri i tij në dosje është gabim material, ndërkohë që në dosje ndodhet dokumentacioni i tij (i shtetasit R. N.).

4.17 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të japë sqarime në lidhje me sa më lart.

Qëndrimi i subjektit

4.18 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti në Komision shpjegimet si vijojnë, të shoqëruara me dokumentacion³².

4.18.1 *“Në lidhje me faktin që dosja e automjetit ka rezultuar e bllokuar nga INTERPOL-i kërkoj t’i sjell në vëmendje Komisionit se mjeti është blerë prej bashkëjetuesit dhe të vëllait, në vitin 2011, ndërsa është kallëzuar si i vjedhur jashtë territorit të shtetit shqiptar në vitin 2015, pra 4 vjet pasi ata e kanë blerë. Në vitin 2011 bashkëjetuesi dhe i vëllai, sikurse rezultoi nga hetimi i Komisionit, kanë qenë blerësit e tretë, ata kanë qenë në mirëbesim dhe kur kanë shitur mjetin, në vitin 2016, nuk kanë pasur dijeni mbi bllokimin e dosjes prej INTERPOL-it. Ata kanë qenë në padijeni edhe kur është blerë polica e sigurimit, pasi një fakt i tillë rezulton vetëm kur kryhen veprimet me dosjen e mjetit.*

Procedurat për kalimin e pronësisë ndiqen nga personi që e ka blerë mjetin dhe ka qenë ky i fundit, i cili e ka kthyer atë. Gjatë pyetësorit, bashkëjetuesi ka shpjeguar se mjeti pati probleme,

³²Deklaratë noteriale nr. ***, datë 22.10.2021, not. A.S. . Deklarues N. H.: *“Deklaroj se kam lidhur me akt noterial kontratën e shitblerjes së mjetit tip ‘Audi’, me targa ***, sipas kontratës nr***, datë 21.9.2016 me palë shitëse z. G.H. dhe F.H., në vlerën 1,500 euro. Deklaroj se pas lidhjes së kontratës së mësipërme të shitblerjes dhe pasi kam kryer veprimet për regjistrimin e saj në DRSHTRR, më kanë thënë se mjeti ka problem në INTERPOL dhe nuk mund të bëhet kalimi i pronësisë së tij në emrin tim sipas kontratës dhe në këto kushte ia kam kthyer autoveturën palës shitëse duke marrë mbrapsh edhe vlerën e paguar...Duke qenë se nuk kemi pasur asnjë problem tjetër me palën shitëse dhe u kthyem në gjendjen e mëparshme, nuk u pa e rëndësishme zgjidhja e kontratës nga ana formale...”*. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.10.2021, not. S.H. . Deklarues G.H.: *“Deklaroj se kam blerë më 26.10.2011 në bashkëpronësi me vëllain tim F. H. mjetin tip ‘Audi’ me targa *** (në momentin e blerjes ka qenë me targa ***). Deklaroj se edhe pse mjetin e mësipërm ne e kemi blerë të dy bashkë, pas largimit të vëllait tim F. H. në Tiranë nga muaji prill i vitit 2012 ky automjet është përdorur vetëm prej meje dhe familjes time. Deklaroj se unë dhe familja ime nuk kemi pasur në atë periudhë asnjë automjet tjetër as në pronësi e as në përdorim. Kjo është edhe arsyeja që këtë mjet vëllai që në momentin e largimit na i la ne, pasi ne na duhej ta përdornim për shërbime familjare në mungesë të një mjeti tjetër”*.

për shkak se ka qenë një informacion që i vëllai të tij e ka marrë prej blerësit, pasi është ky i fundit që ka ndjekur procedurat në DRSHTRR.

Në lidhje me vlerën e mjetit ata më kanë shpjeguar se kjo ka ardhur për shkak të përdorimit të tij, ai ka qenë një mjet i vitit 2006 dhe gjatë kohës së përdorimit të tij nga vëllai i bashkëjetuesit, ka pasur raste kur mjeti kishte shfaqur probleme mekanike. Vlera e mjetit tip 'Audi' në treg ka qenë pothuajse e njëjtë me vlerën e shitur, pasi në vitin 2016 për shkak se kishte kaluar afati 10-vjeçar i prodhimit të mjetit, nuk ka pasur më çmim reference, duke bërë që çmimi i mjeteve të ngjashme në tregun e shitjes të ulej ndjeshëm.

*Në lidhje me kontratën e shitjes të lidhur gjatë bashkëjetesës dhe të mosdeklaruar në deklaratën Vetting, kërkoj të shpjegoj se kjo ka ardhur për shkak të faktit se blerësi e ktheu atë, për shkak se nuk përfunduan procedurat e kalimit të pronësisë. Në lidhje me këtë situatë, vëllai i bashkëjetuesit është vënë në dijeni prej z. N.H. dhe mjeti nuk është përdorur më prej këtij momenti. Sipas deklaratës nr. ***, datë 22.10.2021, noter A. S., deklaruesi N. H. ai ka shpjeguar se '... në DRSHTRR më kanë thënë se mjeti ka probleme në INTERPOL dhe nuk mund të bëhet kalimi i pronësisë dhe në këto kushte ia kam kthyer autoveturën palës shitëse, duke marrë mbrapsh edhe vlerën e paguar, për çmimin e blerjes ...'. Mosdeklarimi i kësaj kontrate vërtetë ka qenë një gabim i bashkëjetuesit, situatë për të cilën unë nuk kam pasur dijeni, por ka ardhur për shkak të faktit se kontrata vërtet u revokua dhe shuma që përbënte çmimin u kthye mbrapsht. Për shkak se kalimi i pronësisë/kontrata e shitjes nuk u regjistrua në regjistrat përkatës, për shkak se mjeti ende figuron në emër të tyre, sipas vërtetimit dërguar në pyetësonin nr. 2, por edhe për shkak se shuma që përbënte çmimin u kthye, ai nuk ka deklaruar nënshkrimin e kësaj kontrate.*

*Dua të sqaroj Komisionin se ky automjet është përdorur më së shumti prej familjes së vëllait të bashkëjetuesit, pasur parasysh se prej vitit 2012 bashkëjetuesi është zhvendosur në Tiranë dhe prej vitit 2014, ai ka pasur mjetet që janë deklaruar 'BMW' dhe 'Citroen' (deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.10.2021, noter S. H., deklarues G. H.). Vëllai i bashkëjetuesit, z. G.H., më ka shpjeguar se prej vitit 2016, mjeti nuk është përdorur më.*

Si edhe rezulton nga hetimi i Komisionit prej vitit 2016, në lidhje me këtë automjet nuk janë blerë polica sigurimi, prej këtij viti ky mjet nuk ka asnjë gjobë dhe aktualisht mjeti nuk përdoret".

4.19 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim, për secilën nga çështjet e mësipërme.

Vlerësimi i Komisionit

4.20 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se janë bindëse.

4.21 Fakti që automjeti është shpallur në kërkim ndërkombëtar disa vite pasi është blerë nga personi i lidhur i subjektit dhe vëllai i tij, tregon se në momentin e blerjes blerësit nuk mund të kishin dijeni për faktin që ishte i vjedhur në një shtet tjetër, për më tepër që ishin blerësit e tretë të tij.

4.22 Në lidhje me kontratën e shitjes së automjetit të lidhur midis personit të lidhur në cilësinë e shitësit dhe z. N. H. në cilësinë e blerësit, sillet në vëmendje përcaktimi i nenit 772 të Kodit Civil: "Në rastin kur dorëzimi i sendeve me të meta përbën një mospërmbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore, blerësi ka të drejtë të deklarojë zgjidhjen e kontratës". Në rastin

konkret, në këtë kontratë, në garancinë për eviksion, pala shitëse ka garantuar palën blerëse se: “Mjeti objekt kontrate është plotësisht i lirë nga çdo lloj barre pengu, detyrim ndaj të tretëve ose sekuestroje mbi të, duke e garantuar blerësin se mbi mjetin e mësipërm nuk ka të drejta pronësie dhe të drejta relative me to asnjë palë e tretë dhe se mban çdolloj përgjegjësie ligjore për pronësinë e tij”.

Blokimi nga INTERPOL-i i dosjes së automjetit objekt kontrate, është një e metë e rëndësishme e sendit, e cila pamundëson ndjekjen e procedurave pranë DPSHTRR-së për kalimin e pronësisë në favor të blerësit. Pra, është një e metë që përbën një mospërmbushje të rëndësishme të detyrimeve kontraktore dhe, si e tillë, bazuar në përcaktimin e sipërcituar të Kodit Civil, përbën shkak ligjor që kontrata të quhet e zgjidhur me deklaratën e blerësit.

Për shkak të kësaj të mete të rëndësishme, vullneti i blerësit për zgjidhjen e kontratës është përputhur me vullnetin e shitësit, pasi sipas deklaratave noteriale të tyre, ata nuk kanë pasur probleme dhe janë kthyer në gjendjen e mëparshme: blerësi ka marrë mbrapsh vlerën e paguar, ndërsa shitësi ka marrë automjetin.

Pavarësisht nga analiza juridike nëse zgjidhja e kësaj kontrate konsiderohet ligjore me deklarin e zgjidhjes nga ana e blerësit (sipas dispozitës së sipërcituar të Kodit Civil), apo ishte i domosdoshëm një akt noterial për zgjidhjen e saj, subjekti gjendet në kushtet kur *de facto* kjo kontratë është zgjidhur dhe nuk solli ndryshim të pronësisë së automjetit, i cili mbeti në pronësinë e personit të lidhur.

4.22.1 Bazuar në këtë analizë, trupi gjykues çmoi se mosdeklarimi i kësaj kontrate shitjeje nga subjekti, ka ardhur pikërisht për shkak të faktit se ajo qe e zgjidhur dhe nuk kishte sjellë pasoja juridike, rrjedhimisht, nuk kishte sjellë ndryshime sa i përket kësaj pasurie.

4.23 Në lidhje me dyshimin e ngritur për faktin se nga dosja e automjetit rezultoi që gjashtë ditë para se këtë automjet ta blinte personi i lidhur i subjektit, DRSHTRR-ja Vlorë ka kërkuar transferimin e dosjes në Vlorë me kërkesë të shtetasit R.N., i cili nuk rezultoi pronar në asnjë prej dokumenteve të administruara, ky institucion konfirmoi se kërkesa për transferim është bërë gabim në emër të z. R. N. dhe ky është një gabim material. Nuk u provua lidhja faktike dhe/ose juridike e këtij shtetasi me automjetin në fjalë.

5. Automjet tip “BMW”, me targa ***, viti i prodhimit 2006, blerë me kontratën nr. ***, datë 27.8.2014, noter L. C., Vlorë, për shumën 1,000,000 lekë. Vlera: 1,000,000 lekë. Pjesa në përqindje: 100%.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: shuma e siguruar nga shitja e një automjeti që e ka disponuar më parë, në të njëjtën shumë, kontratë nr. ***, datë 10.9.2014, tek i njëjti noter.

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se:

5.1 Në deklaratën periodike të subjektit të vitit 2014 personi i lidhur, bashkëjetuesi F. H., ka deklaruar automjetin tip “BMW”, por pa përcaktuar targën e automjetit. Vlera e deklaruar është 8,000 euro. Pjesa në përqindje: 100%.

5.2 Subjekti, e pyetur nga Komisioni³³ mbi të dhënat e automjetit të deklaruar nga bashkëjetuesi në DIPP periodike të saj, sqaroi se bëhet fjalë për të njëjtin automjet³⁴.

³³Pyetësoni nr. 4.

³⁴Në përgjigje të pyetësonit nr. 4 subjekti shpjegoi se: “Në vitin 2014, viti i parë i deklarimit si person i lidhur, bashkëjetuesi shpjegon se bëhet fjalë për automjetin tip BMW, me targa *** (me burim shitjen e një automjeti tjetër tip BMW). Në vitet 2015

5.3 Ky automjet me targa *** dhe nr. shasje *** është i regjistruar në pronësi të z. F. H.³⁵. Ky i fundit e ka blerë nga z. O. J. në datën 27.8.2014, në vlerën 1,000,000 lekë dhe vlera është likuiduar 100% jashtë zyrës së noterisë³⁶.

5.4 Në datën 10.9.2014³⁷, personi i lidhur, z. F.H., i ka shitur shtetasit S.S. automjetin tip “BMW” me targa *** me nr. shasje ***, në vlerën 1,000,000 lekë. Kjo kontratë shitjeje, vlera e së cilës është deklaruar si burim i blerjes së kësaj pasurie, është lidhur pas blerjes së pasurisë në fjalë (automjeti me targa ***). Në kontratë palët janë shprehur se vlera e kontratës është likuiduar 100% jashtë zyrës së noterisë.

5.5 Në lidhje me konfliktin e interesit nuk rezultoi që subjekti të ketë hetuar çështje ku të ketë qenë i përfshirë shitësi i automjetit³⁸.

5.6 Rezultoi se në kufirin shqiptar, me këtë automjet janë regjistruar hyrje-dalje nga persona të ndryshëm përveç subjektit, bashkëjetuesit dhe familjarëve të tij. Subjekti kishte hetuar një procedim penal ku kallëzues/viktimë ishte z. A. Sh. (i referuar në kërkesën për gjykimin e çështjes drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë vetëm me emër dhe mbiemër, pa atësi) dhe një prej shtetasve që ka udhëtuar me automjetin në fjalë së bashku me vëllain e personit të lidhur, është z. A. E. Sh. .

5.7 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë u hartua analiza financiare në të cilën nuk u përfshinë të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***, i cili rezultonte të ishte shitur pas blerjes së automjetit në fjalë. U analizua mundësia për të blerë këtë automjet me kursimet nga të ardhurat e vitit 2014 deri në datën e blerjes (datë 27.8.2014).

Analiza financiare	1.1.2014 - 27.8.2014 (vlerat në lekë)
Të ardhurat e subjektit	715 848
Të ardhurat e bashkëjetuesit	-
Shpenzime jetike për 2 anëtarë	293 331
Likuiditete në fillim të vitit 1.1.2014	67 140
Likuiditete në datën 27.8.2014	17 476
Shpenzime kredie pranë RBAL	82 312
Vlera e blerjes së automjetit ***	1 000 000
Vlera e blerjes së automjetit ***	489 070
Shpenzime udhëtimi deri më 24.8.2014	13 347
Rezultati financiar	- 1 211 875

5.8 Nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëjetuesi nuk kanë pasur mundësi të blejnë automjetin me targa *** me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar në vlerë negative prej 1,211,875 lekësh.

dhe 2016 është shënuar nuk kam ndryshime, duke nënkuptuar që këtë mijet vazhdon ta ketë në pronësi, gjendja pasurore është e njëjtë dhe nuk ka pasur shtesa apo pakësime në raport me deklaratimet e mëparshme, si edhe shpjegimet në ILDKPI”.

³⁵Shkresa nr. *** prot., datë 22.6.2018, e DPSHTRR-së, pjesë e dosjes së ILDKPKI- së.

³⁶Kontrata nr. ***, datë 27.8.2014, notere L. C., Vlorë.

³⁷Kontrata nr. ***, datë 10.9.2014, not. L. C., Vlorë.

³⁸Shkresat nr. ***prot., datë 3.6.2021 (administruar në Komision me nr*** prot., datë 3.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 31.5.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 2.6.2021), dërguar respektivisht nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

5.9 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se:

- a) ky automjet tip “BMW”, me targa ***, është blerë nga personi i lidhur i subjektit gjatë bashkëjetesës së tyre;
- b) ka mospërputhje në vlerën e deklaruar në deklaratën *Vetting*, vlera 1,000,000 lekë, me deklaratën periodike ku është deklaruar në vlerën 8,000 euro;
- c) procedimi penal me të dëmtuar shtetasin A. Sh. (një ndër përdoruesit e automjetit) është hetuar nga subjekti në vitin 2009. Bashkëjetesën me z. F. H. subjekti e ka filluar në tetor të vitit 2013, ndërsa automjetin e bashkëjetuesit, z. A. Sh. e ka përdorur në vitin 2015. Subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi lidhjen e personit të lidhur të saj, me përdoruesin e automjetit, të hetuar prej saj;
- d) vlera e shitjes së automjetit tip “BMW” me targa *** në datën 10.9.2014 nuk mund të ketë shërbyer si burim për blerjen e këtij automjeti në datën 27.8.2014, sikurse ka deklaruar personi i lidhur i subjektit, për vetë faktin se shitja është bërë pas blerjes së automjetit me targa ***, pagesa e të cilit (këtij të fundit) sipas kontratës është likuiduar jashtë zyrës së noterisë;
- e) rezultoi se personi i lidhur ka pasur pamundësi financiare për blerjen e automjetit me të ardhura të ligjshme në vlerën 1,211,875 lekë.

5.10 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me pamundësinë financiare për të blerë automjetin me targa ***, për të cilin rezultoi vlera negative prej 1,211,875 lekësh.

Qëndrimi i subjektit

5.11 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe barrës së provës, subjekti paraqiti në Komision rapësimet si vijojnë, të shoqëruara me dokumentacion³⁹.

5.11.1 “Në lidhje me blerjen e automjetit tip ‘BMW’ me targa ***, viti i prodhimit 2006 sqaroi se:

Bashkëjetuesi vendosi të shesë BMW e tij për shkak se ishte me benzinë dhe konsumonte shumë, por gjithashtu nuk donte të vendoste edhe impiant gazi pasi ky automjet do të përdorej për familjen. Për këto arsye, ai nxorri në shitje automjetin tip ‘BMW’. Në bisedë me të njohur të tij është prezantuar me shtetasin S. S., që ishte duke kërkuar të blinte një autoveturë të tipit ‘BMW’. Në diskutim me këtë person, i parashtroi se arsyeja e vetme që kërkonte ta shiste këtë automjet ishte fakti i konsumit të lartë që kishte, pasi ishte me benzinë. Shtetasi S. S. i deklaroi se kishte pasur një makinë të ngjashme, por me naftë edhe me të njëjtin vit prodhimi dhe që ia kishte

³⁹1. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 23.10.2021, para notere B.N. e z. S.S., ku deklaroi se: “Në muajin gusht të vitit 2014, pas bisedimeve me z. F. H., i cili më ka shprehur se donte të shiste mjetin e tij tip ‘BMW’, me targa ***, i kam propozuar atij që këtë të fundit ta blija unë, ndërsa ai të blinte mjetin tip BMW, me targa *** të z. O. J., mjet të cilin e kisha pasur unë më parë. Në këto kushte, më 27.8.2014 kemi shkuar të tre tek noteri, duke i vënë në dispozicion dokumentet e secilit mjet, si edhe mjetet tona të identifikimit dhe duke bërë mes nesh, në të njëjtën ditë edhe likuidimin e çmimit. Atë ditë, për shkak të angazhimeve, nuk kam mundur të pres deri në përpilimin e kontratës dhe kam shumar më vonë, por nuk e kam gjetur noterin. Disa ditë më pas, kujtoj se kam shkuar në Itali dhe pasi jam kthyer, kam shkuar tek noteri për nënshkrimin e kontratës së shitblerjes”.

2. Kontratat nr. ***, datë 10.9.2014 dhe nr***, datë 27.8.2014 për shitblerjet e mjeteve me targa *** dhe *** me palë respektivisht F.H. e S.S. dhe O. J. e F. H. .

3. Fletë Regjistri i Barrëve Siguroese për mjetin me nr. shasie *** (mjeti me targa ***), nga rezultoi se kërkimi është bërë në datën 19.8.2014, në orën 09:33.

4. Fletë Regjistri i Barrëve Siguroese për mjetin me nr. shasie *** (mjeti me targa ***), nga rezultoi se kërkimi është bërë në datën 19.8.2014, në orën 09:35.

*shitur shokut të tij, shtetasit O.J. . Duke qenë se shtetasi S.S. pranoi çmimin dhe vendosi ta blejë automjetin tip 'BMW', me targa *** dhe bashkëjetuesi nga biseda me S. kishte kuptuar që shtetasi O. J. donte ta shiste automjetin tip 'BMW', blerë jo shumë kohë më parë, i kërkoi S. për të lënë një takim edhe me shtetasin O. J. .*

Bashkëjetuesi F.H. pasi kishte marrë dakordësinë nga shtetasi S.S. për blerjen e automjetit dhe pasi kishte parë edhe BMW në pronësi të shtetasit O. J. vendosi që të shiste BMW me benzinë edhe të blinte BMW e ngjashme, por me naftë.

Palët ranë dakord që do të bënin veprimet noteriale në të njëjtën ditë dhe gjithashtu edhe likuidimet. Dokumentet e automjeteve janë dërguar te noterja L. C., e cila duhet të bënte gati draft kontrata dhe të merrte gjithashtu edhe RBS.

*Nga ana e noteres kërkimi në Regjistrin e Barrës Siguruese është bërë në të njëjtën datë. RBS-të për të dyja makinat janë dhënë në të njëjtën datë, 19.8.2014, madje nga këqyrja e RBS-ve evidentohet se numri i dokumentit për automjetin tip 'BMW' me targa *** është ***, data e rezultatit të kërkimit 19.8.2014, ora e rezultatit të kërkimit është 09:33:02 AM dhe për automjetin BMW, me targa ***, numri i dokumentit është ***, data e rezultatit të kërkimit 19.8.2014, ora e rezultatit të kërkimit është 09:35:04 AM.*

Dy dokumentet e RBS-ve janë gjeneruar nga sistemi i Regjistrin të Barrës Siguruese në të njëjtën datë, madje numrat e dokumenteve janë njëra pas tjetrës, gfarë është një provë e pakundërshtueshme që qëllimi i palëve ka qenë që veprimet si të blerjes dhe të shitjes të bëheshin në të njëjtën kohë.

*Fakti se nënshkrimi i kontratave dhe regjistrimi i tyre është bërë në data të ndryshme 27.8.2014 blerja dhe 10.9.2014 shitja, është për arsyen se shtetasi S.S. nuk ka pritur përpilimin e kontratave nga noteri në datën 27.8.2014, për shkak të një impenjimi urgjent që kishte. Palët kanë bërë likuidimet midis tyre në datën 27.8.2014. Shtetasi O.J. dhe bashkëjetuesi F.H. kanë pritur përpilimin e kontratave dhe firmosjen e tyre, duke bërë gjithashtu edhe regjistrimin e kontratës për kalimin e pronësisë së automjetit ***. Ndërkohë, bashkëjetuesi F. H. ka firmosur po në të njëjtin moment edhe kontratën për shitjen e automjetit me targa ***. Shtetasi S.S. mbas likuidimit dhe pamundësisë për të qëndruar te noteri deri në përfundim të përpilimit të kontratave, i ka thënë bashkëjetuesit që do të kalonte më vonë për ta firmosur dhe do linte një kopje të kontratës te noteri.*

Sikurse deklaroi edhe shtetasi S.S., ka qenë i impenjuar me punë në datën 27.8.2014 dhe do kalonte të firmoste kontratën më vonë. Gjithashtu, ai ka shpjeguar se nga sa kujton, ka udhëtuar edhe në Itali dhe kur është kthyer nga Italia ka firmosur kontratën te noteri. Për këtë arsye, kjo e fundit është regjistruar në datën 10.9.2014.

Ndonëse kontratat kanë qenë tip dhe në të njëjtin format, nga palët likuidimi është bërë në datën 27.8.2014. Zgjatja e firmosjes së kontratës nuk ka qenë për faj të bashkëjetuesit. Asnjëri prej palëve nuk mendonte se do të kishim nënshkrimin e kontratës në ditë të ndryshme, për sa kohë palët ishin likuiduar në datën 27.8.2014. Madje edhe pse RBS-të kishin dalë në datën 19.8.2014 dhe palët ishin paraqitur pranë noterit në datën 27.8.2014, ishte për të vetmen arsye që të ishin të gjithë së bashku përpara noterit.

Vlerësoj se Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare deri në datën 27.8.2014 si vlerën e blerjes, ashtu edhe vlerën e shitjes së automjetit. Sikurse është konstatuar nga Komisioni, në analizën e përgjithshme financiare nuk ka ndodhur që për vitin 2014 bashkëjetuesi të ketë

*përdorur ndonjë shumë të hollash, të cilat nuk justifikohen apo të kenë qenë pikërisht lekët e shitjes së automjetit tip 'BMW' ***. Si firmosja e kontratës së blerjes dhe shitjes është bërë nga bashkëjetuesi në të njëjtën ditë, ashtu edhe kalimi i shumës së të hollave është bërë gjithashtu në të njëjtin moment ndërmjet shtetasve S.S., bashkëjetuesi F.H. dhe shtetasit O.J. . Pavarësisht se deklarata e shtetasit S.S. në këtë proces nuk mund të provojë e vetme këtë fakt, mbështetur edhe në të dhënat e tjera, faktet apo indiciet e administruara gjatë procesit, faktit që bashkëjetuesi ka deklaruar si burim shitjen e mjetit tjetër, veprimet janë kryer tek i njëjti noter, kontrata e regjistruar në pak ditë diferencë, si edhe faktin se noterja ka kërkuar RBS pikërisht të njëjtën ditë dhe orë, vetëm me diferencë minutash, provojnë që palët janë likuiduar mes tyre në të njëjtën ditë.*

Në analizën financiare, për periudhën 1.1.2014 deri më 27.8.2014, duhet të përfshihet edhe gjendja cash për blerjen e automjetit tip 'Citroen', mbas analizimit dhe evidentimit të mundësisë së kursimit për vitin 2013.

*Për sa më lart, mjeti që ka deklaruar gjatë bashkëjetesës është siguruar prej shitjes së mjetit me targa ***, që bashkëjetuesi e ka disponuar edhe para datës në të cilën është lidhur kontrata e blerjes, një gjë e tillë rezulton edhe nga sistemi TIMS, sipas të cilit ai e ka përdorur këtë mjet për udhëtim.*

Kështu rezulton se ky mjet disponohet prej tij para fillimit të bashkëjetesës dhe unë nuk kam pasur asnjë kontribut apo ndikim në krijimin e kësaj pasurie.

*Gjithsesi, kërkoj të shpjegoj se shuma e përdorur për blerjen e mjetit *** përfaqëson kursimet e familjes së origjinës së bashkëjetuesit, i cili deri në nëntor të vitit 2014 ka qenë me ta në përbërjen familjare. Ai ka qenë një investim i përbashkët familjar, ata kanë pasur një ekonomi të përbashkët. Në lidhje me burimin e krijimit për blerjen e automjetit ***, në vlerën 950,000 lekë kanë shërbyer të ardhurat familjare, ku në vlerën e këtyre të ardhurave përfshihet edhe shuma e dhënë prej vëllait të tij E.H. . Nga sa më referon bashkëjetuesi, në momentin e blerjes së automjetit, vëllai i tij E. ka kontribuar me rreth 450,000 lekë për blerjen e automjetit. Për këtë arsye bashkëjetuesi ka blerë nga të ardhurat e tij automjetin tip 'Citroen' në kompensim të kontributit të dhënë nga vëllai i tij për blerjen e automjetit 'BMW'. Nga të gjitha provat e dorëzuara Komisionit (duhet të përmendim gjokat e marra në vendin e punës, e-maile nga e-albania) rezulton e provuar se automjeti 'Citroen' është përdorur dhe vazhdon të përdoret prej shtetasit E. H. ”.*

5.11.2 Në lidhje me deklarimin e vlerës 8,000 euro deklaruar prej personit të lidhur në DIPP, subjekti prapësoi se: “... kërkoj t'i shpjegoj Komisionit se kjo ka qenë një pasaktësi e bashkëjetuesit dhe sikurse kam shpjeguar edhe më lart, duke qenë se nuk kam qenë palë në kryerjen e këtyre veprimeve, është një e dhënë për të cilën unë nuk kam qenë në dijeni. Pavarësisht pasaktësisë në deklaratën periodike kërkoj të shpjegoj se gjithçka është saktësuar në deklaratën Vetting, sipas çmimit të dokumentuar”.

5.11.3 Në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, kallëzues A. Sh., subjekti shpjegoi se nuk bëhet fjalë për të njëjtin person që ka udhëtuar me automjetin e personit të lidhur (bashkëjetuesit), pasi “personi i cili ka paraqitur kallëzimin penal në kuadër të procedimit penal nr. ***, viti 2009, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë, është shtetasi A. Sh., i biri i Rr. dhe i L., lindur më 18.2.1970, ndërsa personi që ka udhëtuar me mjetin e bashkëjetuesit, është z. A.Sh., i biri i E. dhe i E., lindur më 21.7.1952. Pra, personi i dëmtuar

në kuadër të procedimit penal të hetuar nga ana ime, nuk është i njëjti me atë që ka udhëtuar me mjetin, në pronësi të bashkëjetuesit”.

5.12 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim, për secilën nga çështjet e mësipërme.

Vlerësimi i Komisionit

5.13 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se janë bindëse.

5.14 Rezultoi e provuar se kërkimi nga ana e noteres në sistemin e Regjistrimit të Barrëve Siguruese është bërë në të njëjtën ditë për të dyja automjetet dhe njëra pas tjetrës, me dy minuta diferencë ndërmjet tyre, çka është provë që qëllimi i palëve ka qenë që veprimet juridike të shitjes dhe blerjes të kryheshin në të njëjtën kohë, pavarësisht nga fakti se për shkaqe objektive nuk është mundur të formalizoheshin të dyja kontratat në të njëjtën datë. Në kontratën e lidhur me z. S. S., të cilit personi i lidhur i ka shitur automjetin, palët kanë disponuar se vlera (e deklaruar si burim i blerjes së automjetit të ri, pasurisë që po analizojmë) është likuiduar jashtë zyrës së noterisë dhe z. S. S., në deklaratën noteriale të sipërcituar ka deklaruar se çmimi është likuiduar prej tij më 27.8.2014.

5.15 Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe dokumentacionit të administruar, vlerësoi se personi i lidhur i subjektit ka pasur mundësi financiare të blejë këtë pasuri (automjetin e ri), pasi vlera e të dyja kontratave është e njëjtë (1,000,000 lekë). Vlera 1,000,000 lekë e fituar nga shitja e automjetit me targa *** është përdorur për blerjen e automjetit me targa ***.

6. Apartament me sip. 125.18 m², me kontratë porosie nr. ***, datë 28.12.2013, për ap. 2+1, k. ***, kulla ***, ap. nr. ***, për një vlerë prej 75,108 euro. Vlera: 75,108 euro. Pjesa në përqindje: 100%.

Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*: “*Kjo vlerë është likuiduar duke përdorur shumën e fituar nga shitja e apartamentit në pronësinë time, me kontratën nr. ***, datë 24.12.2013, vlera 6,300,000; kam përdorur depozitën që e kam pasur më parë në vlerën 10,000 euro dhe një shumë të marrë prej tim vëllai, shtetasit G. H., në vlerën 15,000 euro (deklaratë noteriale)”.*

6.1 Kjo pasuri nuk është deklaruar në asnjë prej deklaratave periodike vjetore 2014 – 2016.

6.2 Subjekti, e pyetur nga Komisioni⁴⁰ mbi arsyen e mosdeklarimit të kësaj pasurie në DIPP-të 2014 – 2016, shpjegoi se: “*Në lidhje me sa më sipër, bashkëjetuesi, shtetasi F. H., më ka shpjeguar se në deklaratën e parë, ajo që lidhet me vitin 2014, gabimisht duke qenë një kontratë porosie dhe ende jo kalim pronësie, ka menduar se do ta deklaronte atë kur ta dispononte realisht, ta merrte në dorëzim apo kur të merrte pronësinë.*

Megjithatë, në momentin që është pyetur nga inspektori i ILDKPKI -së për këtë deklaratë, ai ka shpjeguar të gjithë situatën dhe ka paraqitur personalisht edhe dokumentacionin, kontratë sipërmarrjeje, pikërisht për këtë apartament. Në kushtet kur ka menduar se situata e tij në lidhje me pasurinë ishte korrigjuar dhe saktësuar sipas procesverbalit përkatës, nga ana e tij në deklaratat periodike në vijim, vitet 2015 dhe 2016, është shënuar se nuk ka ndryshime në lidhje me sa ka deklaruar, si edhe me ato që ka deklaruar në pyetësorin e ILDKPKI-së. Në deklaratat periodike, ai ka vendosur si adresë banimi apartamentin në fjalë. Në këto kushte, pasaktësia në

⁴⁰Pyetësori nr. 2.

deklaratën e parë duket se ka sjellë edhe situatën në vazhdim, por që ai ka menduar se e ka korigjuar duke u shprehur në pjesën përshkruese të deklaratës.

Këtë mënyrë të shprehuri e ka parë si të përshtatshme për shkak të gabimit më sipër dhe duke menduar se nuk mund të deklarohet si një ndryshim pasurie në deklaratën periodike në vijim, ndërsa ka deklaruar sipas kontratës në deklaratën e pasurisë Vetting”.

6.3 ILDKPKI-ja ka përcjellë⁴¹ procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive dhe interesave private”, të mbajtura nga Inspektori i ILDKPKI-së me subjektin e deklaramit F. H., në datën 4.12.2015. Në këtë procesverbal, shtetasi F. H., si subjekt deklarues për shkak të detyrës së tij, është pyetur nga inspektori, ndër të tjera, mbi arsyen e mosdeklaramit të apartamentit në bllokun e ndërtuar nga shoqëria “E.” sh.p.k. në rrugën “****”, për të cilën OSHEE-ja ka bërë me dije se në datën 28.1.2015 ka lidhur kontratë energjie elektrike për përdorim familjar. Në këtë deklaratë z. F. H. ka shpjeguar, ndër të tjera, se: *“Sipas instruksioneve që kam marrë atë kohë në ILDKP, kam plotësuar deklaratën e interesave private për periudhën që kam qenë në funksion 1.9.2012 – 25.10.2013. (...) Në datën 30.12.2013 kam paguar këstin e parë për prenotimin e një apartamenti në Tiranë, sipas kontratës së porosisë me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. e datës 28.12.2013, ndodhur në rrugën ‘***’. Duke qenë kontratë porosie dhe jo përfundimtare, nuk kam ditur si ta deklarohet (...). Në dhjetor të vitit 2014, kur kam plotësuar pjesën time në deklaramin e Silvanës, unë nuk e kam deklaruar as shtëpinë në Vlorë dhe as këtë të prenotuar në Tiranë, duke menduar se kjo do të deklarohet kur të bëhet kontrata përfundimtare dhe regjistrimi në ZVRPP. Kontratën e energjisë me OSHEE-në e ka lidhur vetë shoqëria ndërtuese ‘***’ sh.p.k. në datën 30.6.2015, pa praninë time, me të dhënat e marra nga kontrata e porosisë, pas përfundimit dhe dorëzimit të apartamentit nga ndërtuesi dhe do të deklarohet në deklaramin e ardhshëm në mars”.*

6.4 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës Vetting dokumentacionin si vijon:

a) Kontratë porosie⁴², lidhur në datën 28.12.2013 ndërmjet z. F. H. (personi i lidhur i subjektit) dhe shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k., për apartament me sip. 125.18 m², kundrejt çmimit 600 euro/m², në vlerën totale 75,108 euro, e cila do të likuidohet si vijon:

- kësti i parë në vlerën 55,000 euro do të likuidohet më 30.12.2013;
- kësti i dytë dhe i fundit në vlerën 20,108 euro do të likuidohet më 6.1.2014.

b) Kontratë shitjeje e apartamentit të banimit me sip. 89.98 m², në vlerën 6,300,000 lekë, në Vlorë, lidhur në datën 24.12.2013. Palë shitëse F. H., palë blerëse G. H. dhe M. H.⁴³.

c) Statement bankar nga “Tirana Bank”, për periudhën 7.1.2013 - 30.12.2013. Rezulton depozitë në emër të z. F. H. në shumën 10,044 euro, e cila është mbyllur më 27.12.2013 dhe kjo shumë ka kaluar në llogari rrjedhëse.

d) Në datën 30.12.2013 është bërë transferim i shumës 45,000 euro në llogarinë e shtetasit F. H. me përshkrimin “blerje shtëpie rep. ***, datë 4.12.2013, G. H.” dhe po më 30.12.2013 rezulton transferimi i shumës 55,000 euro në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., blerje shtëpie sipas kontratës me nr. *** rep., datë 28.12.2013, nga shtetasi F. H. .

⁴¹Me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.12.2020).

⁴²Kontrata nr. ***, datë 28.12.2013.

⁴³Kontrata nr. ***, datë 24.12.2013.

e) Faturë depozitimi në arkë në “Tirana Bank” datë 30.12.2013, e shumës 15,000 euro nga shtetasi F. H., me përshkrimin “shlyerje e kështit të kontratës nr. ***, datë 28.12.2013” për shoqërinë “****” sh.p.k.

f) Deklaratë noteriale⁴⁴, në të cilën shtetasi G. H. ka deklaruar se zhvillon aktivitetin privat si avokat pranë Dhomës së Avokatisë në Vlorë dhe i ka dhënë hua vëllait të tij F. H. shumën 15,000 euro, me qëllim blerje apartamenti. Shuma do të kthehet me këste të vogla sipas mundësive të tij.

g) Leje qëndrimi për të huaj (permesso di soggiorno per stranieri) për shtetasin F. H. . Data e hyrjes në Itali 10.6.2002. Leja e parë e qëndrimit në datën 24.7.2003, skadenca më 23.7.2004. Rinovimi në datën 7.8.2006 – skadenca në datën 23.7.2007.

h) Formular i të ardhurave nga shteti italian (trajtuar më poshtë).

6.5 I pyetur nga ILDKPKI-ja në lidhje me vlerën e këtij apartamenti, sipërfaqen, kohën kur është blerë dhe burimin e krijimit⁴⁵, z. F. H. (bashkëjetuesi i subjektit) si subjekt deklarues për shkak të detyrës së tij, ka shpjeguar se: *“Apartamentin në Vlorë në datën 24.12.2013 ia kam shitur vëllait tim G. H. sipas kontratës nr. ***, datë 24.12.2013 në vlerën 6,300,000 lekë dhe shumën e përfituar e kam konvertuar në euro dhe e kam depozituar në ‘Tirana Bank’. Në datën 30.12.2013 kam paguar këstin e parë për prenotimin e një apartamenti në Tiranë, sipas kontratës së porosisë me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. e datës 28.12.2013, ndodhur në rrugën ‘***’. (...) Konfirmoj se deri më 31.12.2014 kam paguar shumën 55,000 euro. I detyrohem shoqërisë ‘***’ sh.p.k. ende rreth 10,000 euro, pasi gjatë vitit 2015 kam paguar 10,000 euro, marrë pjesërisht hua nga im vëlla. Të gjitha këto do t’i deklaroj me saktësi në deklarinimin e ardhshëm që plotësohet në mars 2016 (për vitin 2015)”*.

6.6 ASHK-ja ka konfirmuar⁴⁶ se në pronësi të shtetasit F. B. H. figuron e regjistruar pasuria e ndodhur në Tiranë në z. k. ***, vol. ***, f. ***, apartament me sip. 114.8 m². Bashkëlidhur shkresës gjendet:

- kartela e pasurisë sipas së cilës në pronësi të shtetasit F. B. H. është e regjistruar pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, me kontratë shitjeje nr****, datë 29.1.2019. Adresa e pasurisë: rruga “****”, sh. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë;
- kontrata e porosisë nr. ***, datë 29.12.2013, lidhur midis shtetasit F. H. dhe shoqërisë “****”sh.p.k. për këtë apartament, vlera totale e të cilit është 75,108 euro;
- kontrata e shitjes nr. ***, datë 29.1.2019, lidhur midis shitësit “****” sh.p.k. dhe blerësit “F. H.”, për pasurinë e sipërpërmendur. Çmimi i blerjes është 70,000 euro, vlerë e cila është likuiduar nga blerësi në favor të shitësit sipas kontratës së porosisë, në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit shqiptar⁴⁷.

6.7 Nga dokumentacioni i mësipërm rezultuan mospërputhje në lidhje me kohën e shlyerjes së detyrimit ndaj shoqërisë “****” sh.p.k., konkretisht:

⁴⁴Deklaratë noteriale nr. ***, datë 24.1.2017, notere S. H. .

⁴⁵Pocesverbali “Mbi Shpjegimet e Subjektit të Deklarimit të Pasurive dhe Interesave Private”, i mbajtur nga Inspektori i ILDKPKI-së, më 4.12.2015, pjesë e dosjes.

⁴⁶Shkresa nr. *** prot., datë 5.2.2021 e ASHK, Tirana Veri (protokolluar në Komision me nr. ***, datë 8.2.2021).

⁴⁷Pika 3.2 e nenit 3 të kontratës. Kjo kontratë u vu në dispozicion edhe nga noterja M. D. me shkresën e administruar në Komision me nr. *** prot., datë 14.6.2021.

- Në kontratën e shitblerjes së apartamentit thuhet që vlera është likuiduar sipas kontratës së porosisë, pra kësti i parë në vlerën 55,000 euro, në datën 30.12.2013 dhe kësti i dytë dhe i fundit në vlerën 20,108 euro, në datën 6.1.2014.
- Nga statementi bankar në “Tirana Bank” rezulton se shuma 55,000 euro është transferuar në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k. më 30.12.2013 dhe nga fatura e depozitimit në arkë në “Tirana Bank” rezulton depozitimi i shumës 15,000 euro nga shtetasi F. H., me përshkrimin “shlyerje e kështit të kontratës nr. ***, datë 28.12.2013” për shoqërinë “****” sh.p.k. është bërë më 30.12.2013.
- Në kundërshtim me këto, në deklaratën që ka bërë bashkëjetuesi si subjekt deklarues për shkak të detyrës së tij para inspektorit të ILDKPKI-së, në datën 4.12.2015, ka deklaruar: *“Konfirmoj se deri më 31.12.2014 kam paguar shumën 55,000 euro, i detyrohem firmës ‘***’ sh.p.k. ende rreth 10,000 euro, pasi gjatë vitit 2015 kam paguar 10,000 euro, marrë pjesërisht hua nga im vëlla”*.
- Ky detyrim nuk është deklaruar në asnjë prej DIPP-ve të subjektit (në deklaratën e personit të lidhur) dhe as në DIPP- në pas largimit nga detyra, viti 2013, të personit të lidhur si subjekt deklarues.
- Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur i subjektit ka deklaruar se sipas kontratës së porosisë për apartamentin ka ende detyrime të pashlyera ndaj shoqërisë “****”sh.p.k., në vlerën 5,108 euro.

6.8 Komisioni i kërkoi subjektit të japë sqarime⁴⁸ në lidhje me diferencën në vlerën 5,000 euro, që rezulton midis kontratës së porosisë dhe asaj të shitjes, si dhe në lidhje me mospërputhjet midis deklarimeve në ILDKPKI, *Vetting* dhe kontratave të sipërpërmendura, mbi vlerën dhe periudhat e pagesave për këtë apartament.

6.8.1 Në lidhje me diferencën e çmimit midis kontratës së porosisë dhe asaj të shitjes, subjekti sqaroi⁴⁹ se: *“Diferenca prej 5,000 euro, e cila është deklaruar edhe si detyrim në deklaratën *Vetting*, nuk i është paguar shoqërisë, sepse palët me lidhjen e kontratës përfundimtare, kanë rënë dakord që çmimi përfundimtar të quhej i likuiduar, me sa ishte paguar më parë. Apartamenti, i cili ka të njëjtën vendosje, nje kat më lart, ka të njëjtin çmim shitje për metër katror. Vlera është likuiduar sipas kontratës së porosisë – shprehur në kontratë – nënkupton se është paguar që në atë moment dhe nuk janë bërë pagesa të tjera më pas”*.

6.8.2 Në lidhje me mospërputhjet e tjera mbi vlerën dhe periudhën e pagesave, subjekti sqaroi se: *“Sipas shpjegimeve të marra prej bashkëjetuesit, në lidhje me pagesat e kësteve, pavarësisht se ato janë cituar në kontratën e porosisë, kësti i parë më 30.12.2013 dhe kësti i dytë më 6.1.2014, në fakt sipas të dhënave bankare janë paguar kësti i parë (55,000 euro, transfertë bankare) dhe kësti i dytë (15,000 euro, pagesë në bankë) më 30.12.2013. Një gjë e tillë vërtetohet prej lëvizjeve bankare dhe deklarimi në procesverbalin e ILDKPI duhet të ketë qenë një gabim material, besoj i personit që e ka përpiluar, si edhe një pavëmendje e bashkëjetuesit (gjatë vitit 2015 nuk është bërë asnjë pagesë) kur e ka nënshkruar, pasur parasysh se dokumentet bankare e bëjnë të qartë një gjë të tillë”*.

6.8.3 Subjekti i shoqëroi shpjegimet me dokumentacionin si vijon:

⁴⁸Pyetësori nr. 4.

⁴⁹Përgjigje të pyetësorit nr. 4.

- mandatdepozitimi në arkë në “Tirana Bank”, sipas të cilit shtetasi F. H. në datën 30.12.2013 ka derdhur *cash* shumën 15,000 euro, me përshkrimin “shlyerje e kështit të kontratës nr. ***, datë 28.12.2013. Burimi i fondeve: shitje shtëpie”;
- kontratë shitblerjeje datë 7.12.2016 me shitës “****” sh.p.k. dhe blerës një person që nuk është bashkëjetuesi i saj, për një apartament tjetër në të njëjtin kat, i cili ka sip. 130.49 m² dhe është blerë kundrejt vlerës totale 72,000 euro. Pra, çmimi është përafërsisht 551 euro/m².

6.9 Me kërkesë të Komisionit, shoqëria “****” sh.p.k. vendosi në dispozicion⁵⁰ kontratën e porosisë dhe kontratën e shitjes, të sipërpërmendura, si dhe sqaroi se: *“Pagesa në masën 70,000 euro, është realizuar në ‘Tirana Bank’, më 30.12.2013. Mandat bankar për këtë pagesë nuk disponohet nga ana jonë, pasi mandatpagesa mbahet nga personi i cili ka realizuar pagesën (urdhëruesi i pagesës). Me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 29.1.2019, shoqëria ‘***’ sh.p.k. dhe F. H. kanë kaluar pronësinë e apartamentit, duke përcaktuar si vlerë totale të kalimit të pronësisë vlerën prej 70,000 euro”*. Pra, sipas kontratës së shitjes, çmimi me të cilin z. F. H. ka blerë apartamentin është përafërsisht 600 euro/m².

6.10. Rezultoi se objekti ku ndodhet apartamenti është regjistruar në bazë të lejes së legalizimit nr. ***, datë 17.7.2013 për objektin “godinë banimi dhe shërbimi 16 kat me 2 kate nën tokë”, dhënë subjektit ndërtues “****”sh.p.k., miratuar nga Drejtoria Rajonale e ALUIZNIT TIRANË 3, Drejtori F. H.⁵¹.

6.11 Në regjistrin noterial të vendosur në dispozicion nga Ministria e Drejtësisë⁵² për kontratat e lidhura nga shtetasi F. H., nuk rezultonte kontrata e porosisë e sipërpërmendur me nr. ***, datë 28.12.2013, prandaj iu kërkua noterës që ka vërtetuar këtë kontratë, ta vendoste atë në dispozicion⁵³. Në përgjigje të kërkesës, noterja e dërgoi⁵⁴ kontratën me këto të dhëna, por rezultoi se ky akt në fakt është kontratë shitje e lidhur midis shitësve B. D., F. D., E. D., A. (D.) B. dhe blerësit G. D., pra me këto të dhëna rezultonte tjetër akt noterial.

6.12 Pas këtij konstatimi, u vu në dijeni noterja për faktin që ekzistonin dy akte të ndryshme me të njëjtin numër dhe datë dhe iu dërguan ato bashkëlidhur, duke i kërkuar të sqarojë nëse kontrata e porosisë në fjalë, vënë në dispozicion nga subjekti dhe nga shoqëria e ndërtimit, është vërtetuar nga ana e saj me numrin dhe datën e sipërpërmendur dhe nëse është regjistruar në Rregjistrin e Përgjithshëm të Akteve Noteriale. Gjithashtu, u kërkua që nëse ishte regjistruar, ta vendoste në dispozicion edhe fletën e regjistrit.

6.13 Në përgjigje të kësaj⁵⁵, noterja sqaroi se kontrata e porosisë objekt i kërkesës sonë është lidhur midis palëve dhe nuk është redaktuar në zyrën e saj noteriale dhe se shoqëria “****” sh.p.k. prej vitesh është klient i zyrës së saj dhe si praktikë, çdo kontratë e lidhur në zyrat e shoqërisë, një kopje e saj depozitohet nga shoqëria në ruajtje në zyrën e saj noteriale në dokumentet e shoqërisë, për të pasur dijeni të plotë për shitjet e kryera nga shoqëria ndërtimore. Giithashtu, sqaroi se: *“Kur realizohej kontrata e shitjes, bashkëngjitur me vulë të noterit vendosej edhe kontrata e porosisë për të provuar mënyrën e likuidimit të vlerës së shitjes e konkretisht kontrata e porosisë e lidhur midis palëve i është bashkangjitur si dokument me vulë të noterit, krahas*

⁵⁰Me shkresën nr. *** prot., datë 15.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.7.2021).

⁵¹Nga disa dokumente bashkëlidhur shkresës nr*** prot., datë 15.7.2021, të ASHK/Drejtoria Vendore Tiranë Jug, (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.7.2021).

⁵²Me shkresën nr*** prot., datë 4.12.2020 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 9.12.2020).

⁵³Shkresa nr. *** prot., datë 28.6.2021, drejtuar noterës M. D. .

⁵⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 5.7.2021).

⁵⁵Me shkresën nr*** prot., datë 19.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 22.7.2021).

kontratës përfundimtare të shitjes me nr. ***, datë 29.1.2019, e lidhur midis shoqërisë 'E.'sh.p.k. dhe F. H. ”.

6.14 Në vijim, Komisioni i kërkoi noteres⁵⁶ të sqarojë qartësisht për sa vijon: (i) “Numri *** dhe data 28.12.2013 në kontratën e porosisë të administruar në dosjen tonë, është vendosur nga ana juaj apo jo?; (ii) nënshkrimi dhe vula juaj e vendosur në kokën e kontratës së porosisë, përbri numrit të sipërpërmendur, janë vendosur nga ju apo jo?; (iii) nëse ju si praktikë të punës tuaj kishit edhe administrimin e kontratave joformale të klientit tuaj ‘***’ sh.p.k., sikurse keni shpjeguar, na sqaroni kur e keni administruar në zyrën tuaj këtë kontratë porosie dhe si është dokumentuar administrimi i saj?; (iv) a është dokumentuar ajo në regjistrin noterial dhe a është administruar ajo nga ana juaj konform legjislacionit në fuqi?; (v) na vendosni në dispozicion kopjen e kontratës së porosisë që keni administruar në zyrën tuaj sipas shpjegimeve që keni parashtruar në shkresë”.

6.15 Në përgjigje⁵⁷, noterja shpjegoi se:

6.15.1 “Siç ju kam sqaruar në shkresat e mëparshme, kontrata e porosisë e datës 28.12.2013 me palë kontraktuese shoqërinë ‘***’ sh.p.k. dhe F. H. është lidhur midis palëve dhe nuk është lidhur, redaktuar dhe noterizuar në zyrën time noteriale. Numri ***, datë 28.12.2013 janë të aktit noterial kontratë shitje me palë shitëse B. D. etj., siç jua kam paraqitur dhe shpjeguar dhe ju në shkresat e mëparshme. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar nuk e mbaj mend me saktësi, por di të them që nr. ***, datë 28.12.2013, janë vendosur pa lidhje të kontrata e porosisë datë 28.12.2013 me palë kontraktuese ‘***’ sh.p.k. dhe F. H., sepse nuk është akt i noterizuar në zyrën time noteriale siç thuhet dhe tek kontrata e porosisë që është e lidhur midis tyre dhe nuk është lidhur dhe noterizuar nga unë noterja.

Saktësisht nuk më kujtohet, por mund të them se janë shkruar padashje numrat nga ana ime ose e sekretares time nga volumi i punës, i kam pasur në tavolinën time duke bërë regjistrimin e kontratës së shitjes të cituar më lart gabimisht për inerci është ngatërruar me dokumentet dhe kontrata e porosisë, pasi janë në të njëjtën ditë.

Vula dhe nënshkrimi në kontratën e porosisë janë vendosur nga ana ime në momentin kur kontrata e porosisë është bashkëngjitur kontratës përfundimtare të shitjes si pjesë e dokumentacionit të kontratës së shitjes⁵⁸. Duke qenë se është pjesë e dokumentacionit të kontratës së shitjes, janë vulosur me vulë të njomë çdo faqe, si dhe është firmosur ngjitur me vulën time të njomë. Unë e kam për detyrë të vulos të gjithë dokumentacionin bashkëngjitur aktit notarial sipas ligjit ‘Për noterinë’ 110/2018.

Në periudhën e vitit 2013 kur është lidhur kontrata e porosisë e cituar, nuk kishte regjistër të veçantë hipotekor për kontratat e porosisë ashtu siç funksionon sot dhe me kërkesën time si praktikë pune doja të isha e informuar për porositë që bëheshin nga shoqëria me klientë për objektin që po ndërtohej, për të mos pasur problem në aktet që mund të kryeja unë për këtë objekt që ishte në ndërtim. Kontrata e porosisë ka ardhur në ditën që është lidhur me shoqërinë. Një kopje të kontratës që paraqitej nga shoqëria, e ruaja në dosjen që mbaja unë që i përket klientit.

⁵⁶Me shkresën nr. ***prot., datë 26.7.2021.

⁵⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 3.8.2021).

⁵⁸Duhet mbajtur parasysh fakti që ky numër kontrate nuk është vetëm në kopjen e administruar nga noterja për ta pasur parasysh në veprimet e tjera që mund të bënte subjekti ndërtues për këtë objekt, por është referuar edhe në mandatin e depozitimit në arkë pranë “Tirana Bank”, sipas të cilit F. H. në datën 30.12.2013 ka derdhur cash në “Tirana Bank” shumën 15,000 euro, me përshkrimin “shlyerje e kështit të kontratës nr***, datë 28.12.2013”.

Kontrata e porosisë nuk është dokumentuar në regjistrin noterial, pasi në këtë regjistrë regjistrohen aktet që noterizohen në zyrën noteriale. Kontrata e porosisë nuk është lidhur dhe as noterizuar në zyrën time noteriale dhe, si e tillë, nuk administrohet në arkivën noteriale sipas ligjit nr. 110/2018.

Këtë kontratë porosie ia kam bashkëngjitur kontratës përfundimtare të shitjes, kopje të cilën ua kam paraqitur edhe ju”.

6.16 Për një hetim të plotë dhe gjithëpërfshirës, lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit për shkak të funksionit të saj me shitësin e apartamentit (shoqëria “***” sh.p.k. dhe/ose ortaku dhe administratori i shoqërisë), Komisioni hetoi⁵⁹ nëse subjekti i rivlerësimit gjatë kohës së ushtrimit të detyrës ka hetuar kallëzime dhe/ose procedime penale ku shoqëria “***” sh.p.k. dhe/ose shtetasit I. H., R. B. (ortaku dhe administratori i shoqërisë kanë qenë kallëzues/viktima/të dëmtuar apo të kallëzuar, të dyshuar, persona nën hetim apo të pandehur.

6.17 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁶⁰ dhe ajo pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶¹ është konfirmuar se nuk rezulton që këta persona⁶² të jenë hetuar apo proceduar nga prokuroja Silvana Lule.

Edhe subjekti deklaroi se gjatë ushtrimit të detyrës nuk ka pasur asnjë vendimmarrje në lidhje me këta persona⁶³, duke e shoqëruar deklarinimin e saj me vërtetime nga prokuroritë ku ushtron dhe ka ushtruar detyrën⁶⁴.

6.18 UK Vlorë ka konfirmuar se shtetasi F.H. (atësia mungon) është klient me nr. kontrate ***, nr. klienti ***, lagjja “***”⁶⁵. Meqenëse nga Regjistri i Gjendjes Civile rezultojnë disa shtetas me këtë emër dhe mbiemër, Komisioni i kërkoi UK Vlorë që të identifikojë abonentin (me atësi dhe/ose ID)⁶⁶.

6.19 Gjithashtu, për të evidentuar nëse në apartamentin që shtetasi G. H. ia ka blerë vëllait të tij F. H., banon vërtet G. apo kontrata e shitblerjes ka qenë fiktive dhe blerësi nuk e posedon në fakt apartamentin, iu kërkua Bashkisë Vlorë informacion se kush e paguan taksën vendore mbi pasurinë e paluajtshme, si dhe informacion mbi adresën e banimit të z. G. H.⁶⁷.

6.20 Në lidhje me adresën, Bashkia Vlorë/Zyra e Gjendjes Civile, informoi⁶⁸ se shtetasi G.B.H., nga verifikimi i kryer në EKGJC rezulton i regjistruar në Vlorë, me adresë të përditësuar nga Projekti i Popullimit të vitit 2017: rruga: “***”, ndr. ***, h. ***, ap. ***.

Pra, edhe pse më 24.12.2014 kishte blerë nga vëllai F. H. apartamentin e sipërpërmendur në lagjen “***”, Vlorë, adresa e banimit nuk është adresa e këtij apartamenti.

⁵⁹Shkresa nr. *** prot., datë 21.5.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresa nr. *** prot., datë 21.5.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ku ka ushtruar detyrën më parë.

⁶⁰Shkresa nr. *** prot., datë 3.6.2021, protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.6.2021.

⁶¹Shkresa nr. *** prot., datë 31.5.2021 (protokolluar në Komision me nr.*** prot., datë 2.6.2021).

⁶²“***” sh.p.k. dhe/ose I. H., R. B. (ortaku dhe administratori i shoqërisë).

⁶³Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, me të cilin u pyet nga Komisioni në lidhje me këtë.

⁶⁴Shkresa nr. *** prot., datë 29.6.2021, e Prokurorisë Vlorë dhe shkresa nr.*** prot., datë 1.7.2021, e Prokurorisë Tiranë, vënë në dispozicion nga subjekti.

⁶⁵Shkresa nr. *** prot., datë 28.6.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 1.7.2021).

⁶⁶Shkresa nr. *** prot., datë 7.7.2021.

⁶⁷Shkresa nr. *** prot., datë 18.6.2021.

⁶⁸Shkresa nr. *** prot., datë 30.6.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 5.7.2021).

6.21 Në lidhje me taksën e pasurisë, Bashkia Vlorë i kërkoi UK Vlorë si agjent tatimor i vjeljes së kësaj takse, që të sqaronte Komisionin.

6.22 Në vijim të korrespondencës, UK Vlorë sqaroi⁶⁹ se: “Kontrata nr. ***, që i përket abonentit F. H. është lidhur nga firma e ndërtimit ‘***’ që ka ndërtuar objektin, e cila ka paraqitur listën emërore të gjithë pronarëve të apartamenteve. Gjatë kontaktit që u bë me personin që banon në këtë apartament, u konstatua se në këtë banesë banon z. G. H., të cilit i është kërkuar të paraqitet pranë zyrave të UK Vlorë për të bërë kalimin e banesës në emrin e tij. Në datën 8.7.2021 z. G.H. është paraqitur dhe ka bërë procedurën për ndërrim emri nga F. B. H. në G. B. H., duke paraqitur akt shitblerjen e apartamentit ku rezultoi se z. G. B. H. e posedon këtë banesë prej vitit 2013. Pagesat e faturave të ujit për këtë kontratë janë kryer nga znj. M. H. (bashkëshorte e G. H.) pranë BKT Vlorë”. Bashkëlidhur, ndër të tjera, dërgoi certifikatën për vërtetim pronësie të apartamentit në fjalë, me nr. pas. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, nga e cila rezultoi se ky apartament është regjistruar në emër të shtetasve G. dhe M. H. . Certifikata është lëshuar më 7.1.2014.

6.23 Në lidhje me analizën financiare për burimin e krijimit të pasurisë

Bashkëjetuesi ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim për apartamentin e blerë në Tiranë në datën 28.12.2013, me vlerë 75,108 euro, si vijon:

- a) shumën prej 6,300,000 lekësh të fituar nga shitja e apartamentit në Vlorë në pronësi të shtetasit F. H. me kontratë nr. ***, datë 24.12.2013;
- b) shumën prej 10,000 euro të depozitës në emër të z. F. H., të mbajtur në “Tirana Bank”;
- c) hua të marrë prej vëllait të tij, shtetasit G. H., në vlerën 15,000 euro sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.1.2017.

6.24 Konsiderata të përgjithshme mbi analizën e pasurisë apartament me vendndodhje në rrugën “***”.

6.24.1 Subjekti ka deklaruar gjatë procesit të rivlerësimit se bashkëjetesa me shtetasin F. H. ka filluar në tetor të vitit 2013. Gjithashtu, bashkëjetuesi ka deklaruar⁷⁰ se ka shlyer këstin e parë të apartamentit në datën 30.12.2013, e konfirmuar edhe prej të dhënave shkresore nga institucionet bankare⁷¹ dhe kontrata e porosisë me shoqërinë “***” sh.p.k. është lidhur në datën 28.12.2013. Ndërsa nga sistemi *TIMS* rezultoi se ata kanë udhëtuar bashkë prej datës 24.10.2012 në drejtim të Italisë, e shpjeguar nga subjekti⁷² me destinacion banesën e vëllait të saj. Në vijim të deklaratimeve të mësipërme, mëqenëse trupa çmoi se pasuria është krijuar gjatë bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit, Komisioni ka analizuar dhe ka përfshirë në analizën financiare të subjektit edhe analizën e kësaj pasurie.

6.24.2 Gjithashtu, në vijim të konstatimeve të mësipërme, duke u nisur nga fakti se është konfirmuar se vlera e transferuar te shitësi është 70,000 euro, kontrata e shitjes së pasurisë është nënshkruar me vlerën 70,000 euro dhe mbi këtë kontratë është bërë edhe regjistrimi final në zyrat e ZVRPP (DVASHK), në analizën financiare vlera e apartamentit është konsideruar 70,000 euro.

6.25 Burimi i parë: vlera 6,300,000 lekë, fituar nga shitja e apartamentit në Vlorë me sip. 89.98 m² në pronësi të shtetasit F.H. me kontratë nr. ***, datë 24.12.2013, palë blerëse G.H. dhe M.H. .

⁶⁹Me shkresën nr. ***prot., datë 12.7.2021 (administruar në Komision me nr*** prot., datë 14.7.2021).

⁷⁰Shkresë nr. *** prot., datë 2.12.2020, nga ILDKPKI-ja (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.12.2020).

⁷¹Shkresa nr. *** prot., datë 7.12.2020, nga “Tirana Bank”.

⁷²Pyetësor nr. 1 (standard).

6.25.1 “Tirana Bank”⁷³ konfirmon se në datën 30.12.2013 është transferuar në llogarinë e shtetasit F. H. shuma 45,000 euro nga llogaria e shtetasit G. H. me përshkrimin “kalim te F.H. blerje rep. ***, datë 4.12.2013, G. H.”. Kjo vlerë së bashku me gjendjen e depozitës së z. F. H., prej 10,000 euro është transferuar në të njëjtën datë në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., vlera totale e transferuar është 55,000 euro.

6.25.2 Si më lart shpjeguar, rezulton se apartamenti në Vlorë është blerë nga shtetasi F. H. në datën 29.5.2012⁷⁴, në vlerën 45,000 euro, nga shoqëria “****”.

6.25.3 Komisioni çmoi se deklarimi i subjektit dhe bashkëjetuesit përputhet me të dhënat e konfirmuara nga instiucionet financiare për transfertën e vlerës 45,000 euro të shitjes së apartamentit.

6.26 Analiza financiare e bashkëjetuesit për blerjen e apartamentit në Vlorë.

6.26.1 Subjekti, i pyetur⁷⁵ nga Komisioni për të provuar të ardhurat e bashkëjetuesit për blerjen e apartamentit në vitin 2012, me vlerë 45,000 euro ka shpjeguar: “Shtetasi F. H. më ka shpjeguar se ka punuar në punë të ndryshme në Itali prej vitit 1997 – 2000; prej vitit 2000 deri në vitin 2004 ai ka punuar pranë aktivitetit tregtar të shtetasit italian M. C., ndërsa gjatë viteve 2005 – 2007 ka punuar pranë të njëjtit person në mënyrë sezonale. Për sa më sipër, duke pasur parasysh kushtet ekonomike dhe sociale në të cilat kanë punuar si shtetas i huaj, ai ka mundur të sigurojë disa të dhëna që lidhen me punësimin e tij në vitet 2003 – 2007, si edhe një deklaratë prej personit i cili e ka punësuar, që lidhet me mënyrën e pagës dhe të kontributeve. Në kushtet kur qyteti në fjalë është përcaktuar si zonë e verdhë nga shteti italian lidhur me masat për parandalimin e Covid-19 dhe institucionet në atë vend punojnë me staf të reduktuar, deri në këto momente të dhënat më lart ka mundur t'i sigurojë në rrugë elektronike (e-mail). Të njëjtat dokumente janë në pritje të vulës apostile në institucionet italiane dhe do të dërgohen në Komision në momentin e parë që mbërrijnë në Shqipëri, duke iu kërkuar paraprakisht pranimin e tyre”. Në deklaratën e datës 7.12.2020 të shtetasit italian M. C. është deklaruar se në periudhën 2000 – 2008 ka qënë i punësuar prej tij, fillimisht pa kontratë pune dhe shpërblehej vetëm me 4 orë pune për shkak të taksave të larta. Shtetasi italian vazhdon duke deklaruar se në fakt z. F. H. punonte 8 orë/ditë dhe paguhej dopion e rrogës për orët e bëra shtesë me një rrogë mesatare prej 850 euro + shpërblim. Gjatë këtyre viteve z. F. H. ka qënë i punësuar në aktivitetin e tij tregtar, si dhe ka mbuluar strehimin, ushqimin dhe shpenzimet ekstra. Gjithashtu, është përcjellë edhe nxjerrje llogarie nga sigurimet shoqërore për shtetasin F. H., nga ku është dërguar informacion për të ardhurat e periudhës 2003 – 2007.

6.26.2 Prej këtyre dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, rezultoi se z. F. H. ka pasur të ardhura *neto* gjatë kësaj periudhe vlerën 15,903 euro ose rreth 2,009,666 lekë. Duke u nisur nga një analizë e thjeshtë, rezulton se bashkëjetuesi nuk ka pasur mundësi të krijojë pasurinë (apartament) me vlerë blerjeje 45,000 euro në maj të vitit 2012 kundrejt të vetmeve të ardhura të konstatuara nga Komisioni në vlerën totale 15,903 euro.

6.27 Në lidhje me burimin e vlerës 10,000 euro të depozitës në emër të z. F. H., në “Tirana Bank”:

⁷³Shkresa nr. *** prot., datë 7.12.2020.

⁷⁴Kontrata nr. ***, datë 29.5.2012, lidhur para noters M.V., Vlorë. Kjo kontratë është pjesë e dosjes së përcjellë nga ILDKPKI-ja dhe është konfirmuar nga Drejtoria e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me shkresën nr. ***prot., datë 7.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 10.12.2020).

⁷⁵Shihni pyetësorin nr. 2, pyetja nr. 3.3, f. nr. 4.

6.27.1 Nga të dhënat e konfirmuara nga “Tirana Bank”⁷⁶ rezultoi se kjo depozitë është hapur në datë 27.12.2012 dhe bashkëjetuesi ka depozituar vlerën 5,000 euro *cash* me përshkrimin “kursime familjare”. Ndërsa në datën 9.1.2013 ka depozituar edhe vlerën 5,000 euro me përshkrimin “kursime familjare”, të cilat të dyja janë transferuar në depozitë me vlerë 10,000 euro. Kjo depozitë më pas është mbyllur në datën 27.12.2013 dhe vlera është transferuar në datën 30.12.2013, në llogarinë e shoqërisë “***” sh.p.k.

6.27.2 Komisioni konstatoi se vlera 10,000 euro është krijuar para fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit.

6.27.3 Komisioni ka hartuar analizën financiare të mëposhtme mbi mundësitë e krijimit të depozitës me vlerë 10,000 euro dhe mundësinë financiare për blerjen e apartamentit në Vlorë nga bashkëjetuesi F. H. .

Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet e dhëna me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit dhe gjithashtu ato të rezultuara nga insitucionet përkatëse.

Analiza financiare	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	5.29.2012
Të ardhura nga emigracioni të provuara me dokumentacion	338,632	831,550	650,683	-	812,110	181,607					
Të ardhura nga paga ZRPP V*** prill 2009 - mars 2011								294,732	503,939	94,972	
Blerja e automjetit tip “Audi” me targa ***, në bashkëpronësi me G* H*										300,000	
Blerja e apartamentit në V***											6,287,400
Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë								75,435	- 22,327	- 53,976	
Shpenzime jetike për 1 anëtar			116,842		80,202	86,848		136,620	136,620	136,620	58,145
Shpenzime udhëtimi			6,337		12,370	18,137		24,162	97,201	64,204	
Rezultati financiar	338,632	831,550	527,505	0	719,538	76,622	0	58,515	292,445	-351,876	-6,345,545

Duke përmbledhur tabelën e mësipërme rezulton sa më poshtë:

Analiza financiare	Periudha 2002 – 29.5.2012 (vlerat në lekë)
Të ardhura nga emigracioni të provuara me dokumentacion	2 814 582
Të ardhura nga paga ZRPP Vlorë prill 2009 - mars 2011	893 643
Blerja e automjetit tip “Audi” me targa ***, në bashkëpronësi me G. H.	300 000
Blerja e apartamentit në Vlorë	6 287 400
Ndryshimi i gjendjes së likuiditeteve në bankë	- 868
Shpenzime jetike për 1 anëtar	751 897
Shpenzime udhëtimi	222 410
Rezultati financiar	- 3 852 614

6.28 Nga sa më sipër, u kontaktua se bashkëjetuesi nuk ka pasur mundësi për blerjen e apartamentit në Vlorë me të ardhura të ligjshme. Gjithashtu, për shkak të periudhës së shkurtër kohore, pra apartamenti është blerë në maj të vitit 2012 dhe derdhjet *cash* për krijimin e depozitës janë bërë në dhjetor të vitit 2012 dhe në janar të vitit 2013, dhe mungesës së fitimit të të ardhurave të deklaruara gjatë kësaj periudhe nga bashkëjetuesi, Komisioni konstatoi se nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin edhe të burimit të dytë, depozitës në vlerën 10,000 euro.

Konstatohet se bashkëjetuesi është në pamundësi financiare për blerjen e apartamentit në Vlorë dhe krijimin e depozitës me të ardhurat e deklaruara dhe të ligjshme.

6.29 Burimi i tretë: hua në vlerën 15,000 euro të marrë prej vëllait të bashkëjetuesit, shtetasit G. H., sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.1.2017 me qëllim blerje apartamenti.

⁷⁶Shkresa nr*** prot., datë 7.12.2020.

6.29.1 Subjekti ka përcjellë me deklaratën *Vetting* faturë depozitimi në arkë në “Tirana Bank” në datën 30.12.2013 të shumës 15,000 euro nga shtetasi F.H., me përshkrimin “shlyerje e këstit të kontratës nr. ***, datë 28.12.2013” për shoqërinë “****” sh.p.k.

6.29.2 Ky detyrim nuk është deklaruar në asnjë prej DIPP-ve të subjektit (në deklaratën e personit të lidhur) dhe as në DIPP pas largimit nga detyra, viti 2013, të personit të lidhur si subjekt deklarues.

6.29.3 Komisioni ka pyetur subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. G.H. për dhënien e huas, të shoqëruar me dokumentacion provues⁷⁷. Në përgjigje të këtij pyetësi, subjekti ka shpjeguar se: “Në lidhje me burimin e të ardhurave të z. G. H., sipas këtij të fundit, ai ka punuar si përmbarues gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vitet 1997 – 2000; avokat i shtetit në Zyrën Rajonale Vlorë, për vitet 2005 – 2009, si edhe ka ushtruar profesionin e avokatit prej vitit 2020 e në vazhdim. G. H. është martuar me znj. M.H. në vitin 2003. M. H. që prej vitit 2002 deri në vitin 2014 ka qenë e punësuar në ‘Tirana Bank’”. Subjekti ka bashkëlidhur me shpjegimet dokumentacionin⁷⁸ për të provuar të ardhurat e vëllait të bashkëjetuesit dhe bashkëshortes së tij, të cilat janë përfshirë në analizën financiare të mëposhtme.

Rezultoi se huaja në vlerën 15,000 euro nuk është shlyer ende (as subjekti nuk ka deklaruar shlyerjen e saj dhe as nga institucionet bankare nuk është konfirmuar kjo gjë).

6.30 Të ardhurat e z. G. H. nga ushtrimi i profesionit të avokatit:

6.30.1 Nga QKB-ja⁷⁹ konfirmohet se vëllai i bashkëjetuesit është regjistruar si person fizik me aktivitet “avokat”, prej datës 7.1.2010, me seli në Vlorë dhe NIPT ***. Në tabelën e mëposhtme të analizës financiare janë pasqyruar të ardhurat nga avokatia të deklaruara në DPT⁸⁰ dhe paga e konfirmuar nga të dhënat e ISSH-së⁸¹ (paga e tij si avokat), të cilat përputhen me fitimin *neto* dhe pagën e deklaruar në librat financiarë referuar faqes zyrtare të QKB-së.

Të ardhurat/fitimi <i>neto</i> nga avokatia të konfirmuara nga institucionet	2011	2012	2013
	-25 709 lekë	213 335 lekë	480 388 lekë

6.30.2 Gjithashtu, nga sistemi elektronik i ASHK-së rezulton se shtetasi G. dhe M. H. edhe në vitin 2011 kanë blerë një apartament me sip. 105 m², kundrejt vlerës 5,200,000 lekë⁸², në lagjen “****”.

⁷⁷Pyetësi nr. 2.

⁷⁸Vërtetim nr. *** prot., datë 3.12.2020, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të ardhurat e G. H. për vitet 1997 – 2000; vërtetim nr. *** prot., datë 9.12.2020, nga Avokatura e Shtetit për vitet 2006 – 2009, vërtetim nr. *** prot., datë 3.12.2020 nga Bashkia Vlorë, drejtorja e taksave dhe tarifave vendore për të ardhurat si avokat të G. H. për periudhën 2010 – 2013 dhe vërtetim nga “Tirana Bank” datë 9.12.2020 për të ardhurat e M. H. gjatë viteve 2005 – 2014.

⁷⁹Shkresa nr*** prot., datë 7.12.2020, nga QKB-ja.

⁸⁰Shkresa nr. *** prot., datë 5.7.2021.

⁸¹Shkresa nr*** prot., datë 4.12.2020, nga ISSH-ja.

⁸²Blerë nga shoqëria “****” sh.p.k., kontrata nr. ***, datë 27.12.2011, notere J.V., Vlorë.

Periudha	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	12/30/2013	Totali 2005-2013
Të ardhura nga paga si avokat + fitimi neto						270,000	16,312	412,973	687,496	1,386,781
Të ardhura nga paga në avokaturën e shtetit		786,788	810,491	767,164	607,612					2,972,055
Të ardhura nga paga e M*** D***	812,000	865,000	982,200	1,084,233	1,008,000	1,088,180	936,274	587,964	1,018,750	8,382,601
Blerja e apartamentit të parë në V***							5,200,000			5,200,000
Blerja e apartamentit nga F*** H***									6,300,000	6,300,000
Vlera e dhënë hua te F*** H***									2,103,150	2,103,150
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	4,132	50,954	(14,719)	(40,182)	(189)	1,598	20,098	(1,185)	(20,000)	506
Shpenzime në ZRPP nga llog R***								15,300		15,300
Shpenzime kredie pranë T*** Bank									1,404,764	1,404,764
Shpenzime jetike	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	409,860	418,644	423,072	3,548,358
Rezultati financiar	479,197	1,268,031	1,342,464	1,441,352	1,205,756	946,727	-4,678,965	546,487	-7,120,482	-4,569,433

6.31 Rezultoi se vëllai i bashkëjetuesit nuk ka pasur mundësi financiare në vlerën 4,569,433 lekë për të dhënë hua vlerën 15,000 euro z. F. H. dhe të blejë apartamentin prej tij.

6.32 Në përmbledhje të sa më sipër mbi mundësinë financiare të personit të lidhur (bashkëjetuesit) për të blerë me të ardhura të ligjshme apartamentin në Tiranë, rezulton si vijon:

Burimet e deklaruar	Vlera e deklaruar (në euro)	Vlera e marrë në konsideratë nga Komisioni (në euro)
Vlera e shitjes së apartamentit në Vlorë	45 000	-
Depozita e bashkëjetuesit	10 000	-
Hua e marrë prej shtetasit G. H.	15 000	-
<i>Totali</i>	<i>70 000</i>	<i>-</i>
Vlera e pasurisë (apartament në Tiranë)	70 000	

Rezultoi se personi i lidhur (bashkëjetuesi) nuk ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë me të ardhura të ligjshme, duke rezultuar me një vlerë pamundësie 70,000 euro ose 9,814,700 lekë.

6.33 Në përfundim, në analizë të provave të administruara, trupi gjykues çmoi se:

- Bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit nuk ka pasur mundësi të blejë (gjatë kohës së bashkëjetesës) apartamentin në Tiranë, duke rezultuar në pamundësi financiare në vlerën 70,000 euro ose 9,814,700 lekë.
- Bashkëjetuesi e ka blerë këtë pasuri gjatë periudhës së bashkëjetesës.
- Personi i lidhur i subjektit, bashkëjetuesi i saj, në cilësinë e drejtorit të ALUIZNI-t Tiranë 3 ka miratuar lejen e legalizimit të objektit ku ndodhet apartamenti i blerë prej tij dhe më pas ka lidhur kontratën e sipërmarrjes. Për pasojë konstatohet se në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të lidhur midis shoqërisë “***” sh.p.k. (shitësi) dhe shtetasit F.H. (blerësi) rezulton një çmim 5,108 euro më pak se çmimi i përcaktuar nga palët në kontratën e porosisë të lidhur më parë për këtë apartament dhe të deklaruar në *Vetting*. Duket se personi i lidhur ka pasur një trajtim preferencial në çmimin e kësaj kontrate.

6.34 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me pamundësinë financiare për të blerë apartamentin.

Qëndrimi i subjektit

6.35 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe barrës së provës, subjekti shpjegoi për këtë pasuri me prapësimet si vijojnë:

“Si fillim, në lidhje me blerjen e apartamentit kërkoj t’i shpjegoj Komisionit se apartamenti është blerë në fillimet e një periudhe, që më vonë ka marrë kuptimin e bashkëjetesës, dhe se unë nuk kam kontribuar në blerjen e tij (si edhe ka rezultuar nga hetimi), ai është blerë me fondet që bashkëjetuesi ka siguruar. Pavarësisht se apartamenti është porositur në vitin 2013, unë nuk kam jetuar në atë apartament deri në vitin 2015, ndërkohë që i vetmi interes vetjak që më lidh me këtë pasuri është përdorimi për shkak të marrëdhënies së bashkëjetesës (vendim nr. 217, datë 5.12.2019, KPK) dhe jo përdorimi, në konceptin që ligji ka parashikuar sipas Kodit Civil”.

6.36 Në lidhje me burimet e kësaj pasurie, subjekti shpjegoi:

Burimi i parë dhe i dytë, apartamenti i blerë në Vlorë dhe depozita në vlerën 10,000 euro

Pavarësisht sa më lart, si edhe ka konstatuar Komisioni, kësti/pjesa prej 55,000 euro është paguar me një shumë, e cila ka ekzistuar kohë para se bashkëjetesa edhe të fillonte. Si edhe unë kam shpjeguar, por edhe Komisioni ka vlerësuar, shuma prej 10,000 euro është krijuar para fillimit të bashkëjetesës, rrjedhimisht edhe blerja e apartamentit në Vlorë.

Në këtë kohë, z. F.H. nuk ka qenë një person i lidhur për mua⁸³, për këtë arsye i kërkoj Komisionit që këtë pasuri ta konsiderojë si një pasuri të fituar para se të fillonte bashkëjetesa, duke qenë se nuk kam ndikuar apo kontribuar në fitimin e saj.

Kështu, nuk ka rezultuar asnjë e dhënë nga asnjë burim, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, për lidhje të miat si subjekt rivlerësimi, me pasurinë objekt shqyrtimi.

Gjithsesi, vlerësoj të shpjegoj se bashkëjetuesi pasi ka mbaruar shkollën e mesme, për shkak të vështirësive ekonomike familjare pas vdekjes së babait, por edhe social-historike në Shqipëri (viti 1997), ka shkuar të punojë në shtetin italian deri në vitin 2007. Ai më ka shpjeguar se edhe gjatë kohës që ndiqte studimet në Universitetin e Vlorës, sipas mundësisë, punonte në mënyrë sezonale në shtetin italian. Një gjë e tillë rezulton edhe prej sistemit TIMS.

*Në vijim të sa më sipër, kërkoj t’i vë në dukje Komisionit se në kontratën nr. ***, datë 29.5.2012, përveç se është shpjeguar se çmimi është likuiduar prej palës blerëse para nënshkrimit të kësaj kontrate, rezulton gjithashtu se pjesën ku janë shënuar të dhënat e blerësit F. H., është shënuar se ai banon në adresën lagjja ‘***’, banesë ***-katëshe, ndërtuar nga ‘***’ sh.p.k.*

Në lidhje me apartamentin në Vlorë, i cili ka qenë në pronësi të bashkëjetuesit, shpjegoj se data e lidhjes së kontratës është 29.5.2012, por momenti i blerjes dhe kryerjes së pjesës më të madhe të pagesës, ka qenë në vitin 2009 – 2010”.

Me shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2021, nga FSHU-ja (Furnizuesi i Shërbimit Universal) u bë me dije se nga sistemi i faturimit, kontrata me ***, i përket abonentit F. H. . Bashkëlidhur shkresës është vendosur në dispozicion edhe sistemi i printuar, ku identifikohet fakti se kabina elektrike i përket shoqërisë “****”, VL *** dhe data e lidhjes së kontratës është 31.7.2010. Edhe kontrata me UK Vlorë është lidhur në gusht të vitit 2010, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 19.10.2021 nga UK Vlorë.

⁸³Vendim nr. 86, datë 17.12.2018, i Komisionit; vendim nr. 262, datë 17.6.2020, i Komisionit.

Subjekti vijon shpjegimet se: “Bashkëjetuesi ka arritur të gjejë edhe pagesën e një kësti likuiduar shoqërisë së ndërtimit, që mban datën 31.7.2010, në vlerën 19,200 euro (për shkak të kohës së largët që ka kaluar nuk duket i qartë shkrimi në mandate). Në momentin që është bërë procedura për lidhjen e energjisë elektrike është paguar edhe kësti.

Bashkëjetuesi më informon se me shoqërinë ‘***’ sh.p.k. ka lidhur kontratë porosie, firmosur në zyrat e shoqërisë. Nga sa kujton, kontrata e porosisë është lidhur në periudhën nëntor ose dhjetor 2009, ku edhe ka paguar këstin e parë. Deri në momentin e lidhjes së kontratës së energjisë elektrike, bashkëjetuesi më informon se ka paguar rreth 40,000 euro. Shoqëria ‘***’ sh.p.k. ka shitur të gjithë pallatin në periudhën 2009 dhe 2010, por kontratat e shitjes janë nënshkruar në vitin 2012 për shkak të momentit të hipotekimit të pallatit.

Apartamenti i blerë nga bashkëjetuesi është në të njëjtin pallat dhe në të njëjtin kat, me apartamentin e blerë edhe nga nëna e tij, mbasi kjo e fundit kishte shitur apartamentin në vitin 2010, fakt ky që tregon se nëna e bashkëjetuesit ka shitur apartamentin e vjetër për të blerë dhe paguar apartamentin e ri.

Edhe shtetasja H. H. ka lidhur kontratën e shitjes në datën 29.5.2012, fakt që provon gjithashtu se data 29.5.2012 është momenti i daljes së certifikatave të pronësisë për apartamentet e porositura.

Nëse i referohemi edhe ekstraktit të QKB-së për shoqërinë ‘***’ sh.p.k., me NIPT ***, evidentohen dorëzimet e pasqyrave financiare. Me çështjen CN***, datë 14.9.2016 janë depozituar edhe pasqyrat financiare për vitin 2009. Nga analiza e pasqyrave financiare në këtë vit rezulton se objekti në pjesën më të madhe të tij është shitur në vitin 2009, ku edhe janë deklaruar të ardhurat nga shitja për objektin. Këto të ardhura janë ndarë në pjesën e kompensimit të pronarëve të tokës dhe të ardhura të përjashtuara për shitjen e apartamenteve ndaj të tretëve. Aktualisht, shoqëria nuk ushtron më aktivitetet dhe nuk kemi arritur të sigurojmë dokumente të tjera financiare për të provuar momentin e shitjes së objektit të ndërtuar nga kjo shoqëri.

Bazuar në dokumentacionin dhe shpjegimet më lart, vlerësoj se provohet fakti se apartamenti është porositur dhe likuiduar kohë përpara datës së nënshkrimit të kontratës së shitjes.

Kështu, periudha në të cilën bashkëjetuesi ka disponuar këtë pasuri, ka qenë përpara kohës kur kanë nisur marrëdhëniet e bashkëjetesës dhe njohjes dhe ai nuk gëzonte në këte moment ndonjë status relevant për procesin e rivlerësimit, për sa kohë marrëdhënia ende nuk kishte filluar dhe palët nuk kishin asnjë lidhje të ndonjë natyre nga ato të parashikuara në pikat 13 dhe 14 të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016⁸⁴. Referuar këtyre rrethanave ligjore, në atë kohë F. H. ka qenë i përjashtuar nga ndonjë kualifikim i mundshëm si person i lidhur, për sa kohe nuk rezultoi asnjë e dhënë tjetër që mund të më lidh mua si subjekt, me ndonjë investim apo shpenzim të mundshëm në këtë pasuri (vendim nr. 86, datë 17.12.2018, KP.)

Burimi i tretë: hua prej 15,000 euro të marrë prej vëllait të bashkëjetuesit, shtetasit G. H., sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 24.1.2017 me qëllim blerje apartamenti.

Në lidhje me këtë pjesë, fillimisht kërkoj të sqaroj se për arsyet e tyre, z. G. dhe znj. M. H. në vitin 2013 kanë pasur për qëllim të ndryshonin banesën që kishin blerë më parë. Për shkak se nuk gjetën një alternativë tjetër, por nisur edhe nga fakti se apartamenti i bashkëjetuesit ishte në

⁸⁴Vendim nr. ***, J/R, i Kolegjit, paragrafi 23.7.

të njëjtin pallat dhe kat me atë të nënës së tyre, e cila jeton e vetme, ata së bashku me bashkëjetuesin tim, ranë dakord që të shisnin apartamentin e tyre dhe të blinin apartamentin që bashkëjetuesi kishte në të njëjtin pallat.

Gjatë pyetësorit nr. 2, unë kam paraqitur burimin e ligjshëm të huas, nisur edhe nga vendimi nr. 15/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit sipas të cilit '... në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës se parashikuar prej nenit 32, pika 4, e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur.

Njësia Ligjore pranë Komisionit ka kryer analizën financiare për burimin e ligjshëm të të ardhurave për dhënien e huas, por në këtë analizë nuk është përfshirë shitja e apartamentit në pronësi të shtetasve G. dhe M. H. .

Apartamenti është shitur sipas kontratës nr. ***, të datës 4.12.2013. Vlera e apartamentit të shitur është 7,132,250 lekë. Nëse i referohemi analizës financiare kryer për shtetasin G.H., është shitur pikërisht apartamenti i blerë në vlerën 5,200,000 lekë, me kontratën e shitjes së vitit 2011. Nga analiza rezulton sikur shtetasi G. H. ka në pronësi dy apartamente. Në fakt, apartamenti i blerë në vlerën 5,200,000 lekë është shitur në vlerën 7,132,250 lekë dhe të ardhurat nga shitja kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit të bashkëjetuesit F.H. . Sikurse kam sqaruar më lart, ky apartament ishte ngjitur me apartamentin e shtetasve H. H., nëna e bashkëjetuesit, dhe vëllai i tij G. H. kërkonte të ishte pranë dhe afër nënës së tij. Kjo ishte edhe arsyeja pse vëllai G. H. bleu apartamentin e bashkëjetuesit F. H. . Apartamenti në vlerën 5,200,000 lekë është blerë me kredi. Sikurse konstatohet edhe nga Komisioni përpara se apartamenti të shitej është bërë edhe mbyllja e kredisë pranë 'Tirana Bank' në shumën 10,019 euro. Kam arritur të siguroj kopje të kontratës së hipotekimit të datës 21.6.2005, nënshkruar pranë noteres J.V. . Në kontratën e hipotekimit është përcaktuar se pasuria hipotekohet nga hipotekuesit, në favor të përfituesit për të garantuar kthimin e kredisë së marrë prej znj. M.D. (H.) me kontratën për hua afatgjatë nr. ***, datë 20.6.2005 për shumën e përgjithshme 40,000 euro.

Kursimet e shtetasit G. H. dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në vlerën 7,132,250 lekë kanë shërbyer si burim krijimi për blerjen e apartamentit të bashkëjetuesit F. H. dhe dhënien e borxhit në shumën 15,000 euro.

Periudha	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	12/30/2013	Totali 2005-2013
Të ardhura nga paga si avokat + fitimi neto						270,000	16,312	412,973	687,496	1,386,781
Të ardhura nga paga në avokaturën e shtetit		786,788	810,491	767,164	607,612					2,972,055
Të ardhura nga paga M*** D***	812,000	856,000	982,200	1,084,233	1,008,000	1,088,180	936,274	587,964	1,018,750	8,382,601
Të ardhura nga shitja e apartamentit									7,132,250	7,132,250
Të ardhur nga kredia në T*** Bank	5,200,000									5,200,000
Blerja e apartamentit të parë në V***	5,200,000									5,200,000
Blerja e apartamentit nga F*** H***									6,300,000	6,300,000
Vlera e dhënë hua te F*** H***									2,103,150	2,103,150
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	4,132	50,954	(14,719)	(40,182)	(189)	1,598	20,098	(1,185)	(20,000)	506
Shpenzime në ZRPP nga llog R***										15,300
Shpenzime kredie pranë T*** Bank	139,818	267,570	229,729	269,473	339,846	348,445	2,230,605	170,787	1,553,206	5,549,477
Shpenzime jetike	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	409,860	418,644	423,072	3,548,358
Rezultati financiar	339,379	1,000,461	1,112,735	1,171,879	856,911	598,282	-1,709,570	375,700	-1,560,931	2,193,846

Kështu, në analizën financiare duhet ndryshuar viti i likuidimit të apartamentit, prej vitit 2011 në vitin 2005. Në tepricën 2,193,846 lekë nuk janë përfshirë interesat bankare për shlyerjen e kredisë, të cilat nuk kanë qenë shumë të larta, pasi znj. M. H. ka qenë punonjëse e 'Tirana Bank'.

*Gjithashtu, në analizë nuk janë përfshirë edhe të ardhurat e përfituara nga shtetasi G.H. në pozicionin e ekspertit për projektin operacional 'Klinikat e Ligjit', në shumën neto prej 12,580 USD⁸⁵. Shtetasi G. H. më referon se nga shuma 12,580 USD është zbritur tatimi në burim 10% që është paguar nga fondacioni '***'. Shuma e përfituruar 11,322 USD është mbas pagesës së tatimit në burim të paguar, shumë kjo e përfituruar në përfundim të projektit. Në vërtetimin e datës 7.7.2021, përcaktohet se fondacioni ka kryer të gjitha pagesat tatimore përkatëse sipas ligjeve në fuqi. Fondacioni, në respekt të nenit 33 'Mbajtja në burime tatimit mbi të ardhurat', ka kryer pagesën në masën 10% sipas përcaktimeve në ndryshimet ligjore, ndodhur me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004, që ka hyrë në fuqi në datën 2.1.2005.*

Pavarësisht sa më lart, në lidhje me këtë pasuri kërkoj të vë në dukje se unë jam përdoruese e kësaj banese për shkak të marrëdhënies së bashkëjetesës dhe jo pronare e saj, duke mos gëzuar asnjë nga të drejtat reale që lidhen me një send të paluajtshëm. Pronësia, në lidhje me këtë apartament i përket vetëm bashkëjetuesit.

Në kuptim të ligjit unë nuk jam dhe as mund të bëhem ndonjëherë pronare e kësaj banese, edhe nëse në të ardhmen do të lidh martesë, përveç se nuk ekziston asnjë rrethanë ligjore apo faktike që më lidh mua si subjekt me ndonjë investim të mundshëm mbi këtë pasuri.

Në vijim të arsyetimit, kërkoj të shtoj se, edhe nëse sot do të ishim përpara një martese ligjore, në kuptim të familjes, bashkësisë ligjore, dispozitave që e rregullojnë këtë pjesë në Kodin e Familjes, apartamenti do të ishte një pasuri vetjake e bashkëjetuesit/bashkëshortit (neni 77 i Kodit të Familjes) dhe unë nuk mund të bëhesha asnjëherë bashkëpronare në lidhje me të (vendim nr. 262, datë 17.6.2020, te Komisionit)".

6.37 Subjekti i shoqëroi prapësimet me provat si vijon:

- Kontratë shitjeje me të cilën znj. H. H. ka blerë nga shoqëria "****" dhe shtetasi A. P. apartamentin me sip. 66.03 m², kundrejt çmimit 27,000 euro⁸⁶.
- Ekstrakt të regjistrimit tregtar të shoqërisë "****" sh.p.k.
- Kontratë shitjeje me të cilën shtetasit G. dhe M. H. i kanë shitur palës blerëse A.K. dhe A. K. apartamentin e tyre të ndodhur në Vlorë në lagjen "****" në pallatin e ndërtuar nga shoqëria "****" sh.p.k., kundrejt çmimit të shitjes 7,132,250 lekë⁸⁷.
- Nxjerrje llogarie nga "Tirana Bank" për znj. M. D. (H.), nga e cila rezulton se më 4.12.2013 është kryer veprimi "depozitë për M. D., blerje apartamenti sipas kontratës me nr. ***, datë 4.12.2013" Vlera: 46,000 euro.
- Kontratë hipotekimi nr. ***, datë 21.6.2005, me objekt "hipotekimi i pasurisë së paluajtshme të hipotekuesve për efekt garancie të sigurimit të kthimit të kredisë së dhënë prej përfituesit ('Tirana Bank') në emër të shtetasve M.D. (H.) dhe G.H. . Pasuria hipotekohet për të garantuar kthimin e kredisë së marrë prej znj. M.D. (H.) me kontratë për hua afatgjatë nr. ***,

⁸⁵Përcjellë Komisionit me përgjigjet e pyetësorit nr. 5, datë 21.9.2021, administruar në Komision me nr. ***, datë 24.9.2021.

⁸⁶Kontratë shitjeje nr. ***, datë 29.5.2012, not. J. V. . Me këtë kontratë, znj. H. H. ka blerë apartament me sip. 66.03 m², shk. ***, kati i katërt banim, ap*** ndodhur në Vlorë në lagjen "****", z.k***.

⁸⁷Kontrata nr. ***, datë 4.12.2013, not. J. B. .

datë 20.6.2005 për shumën e përgjithshme prej 40,000 euro”.

6.38 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

6.39 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues, në lidhje me burimet e krijimit të apartamentit, çmoi si vijon:

6.39.1 Për burimin e parë - apartament në qytetin e Vlorës, shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe janë të provuara me dokumentacion ligjor. Subjekti ka arritur të provojë se apartamenti është blerë gjatë viteve 2009 - 2010 duke përcjellë mandatarkëtime të pagesës së kryer prej tij në këtë periudhë dhe kontratën e lidhjes së energjisë elektrike në datën 31.7.2010, ku provohet se kështu e apartamentit ishin shlyer përpara datës së lidhjes së kësaj kontrate.

6.39.2 Për burimin e dytë – depozita e kursimit në “Tirana Bank” me vlerë 10,000 euro, trupi gjykues vlerësoi se kjo depozitë është krijuar përpara datës së fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit dhe nuk ka të dhëna që subjekti ka ndikuar në krijimin e saj. Shpjegimet e subjektit ishin bindëse pasi gjatë hetimit nuk rezultoi asnjë provë për fillimin e marrëdhënies së bashkëjetesës përpara datës së deklaruar nga subjekti⁸⁸.

6.39.3 Burimi i tretë – hua prej 15,000 euro të marrë nga vëllai i bashkëjetuesit, z. G. H., subjekti arriti të provojë se për blerjen e apartamentit në qytetin e Vlorës në vitin 2005, prej vëllait të bashkëjetuesit janë përdorur fondet monetare të siguruara nga kredia bankare e marrë në “Tirana Bank” prej bashkëshortes së tij, znj. M. D. (H.), në vitin 2005, me vlerë 40,000 euro. Pas përcjelljes së provave të marrjes së kredisë prej bashkëshortes së z. G. H., është përfshirë në analizën e Komisionit edhe mënyra e shlyerjes së kësaj kredie në periudhën 2005 – 2013. Gjithashtu, pas dërgimit të kontratës së shitjes nr. ***, datë 4.12.2013, të këtij apartamenti në qytetin e Vlorës, u përfshinë në analizën e Komisionit edhe të ardhurat nga shitja në vlerën 7,132,250 lekë. Komisioni vlerësoi se edhe shpjegimet e subjektit mbi të ardhurat nga shërbimi i konsulencës së z. G.H. në projektin “Klinika e Ligjit”, janë shteruese dhe bindëse pasi janë të mbështetura në legjislacionin tatimor të kohës⁸⁹, duke përfshirë në këtë mënyrë edhe të ardhurat nga ky projekt në analizën financiare. Në vijim të çmimeve dhe vlerësimeve të mësipërme të Komisionit, të arritura pas dërgimit të shpjegimeve, provave dhe mbajtjes së seancës dëgjimore, u hartua analiza financiare e vëllait të bashkëjetuesit e cila është si vijon.

Periudha	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	12/30/2013	Totali 2005-2013
Të ardhura nga paga si avokat + fitimi neto						270,000	16,312	412,973	687,496	1,386,781
Të ardhura nga paga në avokaturën e shtetit		786,788	810,491	767,164	607,612					2,972,055
Të ardhura nga projekti K**** e L****	982,668									
Të ardhura nga paga e M**** D****	812,000	865,000	982,200	1,084,233	1,008,000	1,088,180	936,274	587,964	1,018,750	8,382,601
Të ardhura nga shitja e apartamentit									7,132,250	
E ardhur nga kredia në T**** Bank	4,901,600									
Blerja e apartamentit të parë në V****	5,200,000									5,200,000
Blerja e apartamentit nga F**** H****									6,300,000	6,300,000
Vlera e dhënë hua te F**** H****									2,103,150	2,103,150
Ndryshimi i likuiditeteve në bankë	4,132	50,954	(14,719)	(40,182)	(189)	1,598	20,098	(1,185)	(20,000)	506
Shpenzime në ZRPP nga llog R****								15,300		15,300
Shpenzime kredie pranë T**** Bank	139,818	267,570	229,729	269,473	339,846	348,445	2,230,605	170,787	1,553,206	5,549,479
Shpenzime jetike	328,671	328,671	409,860	409,860	409,860	409,860	409,860	418,644	423,072	3,548,358
<i>Rezultati financiar</i>	<i>1,023,647</i>	<i>1,004,593</i>	<i>1,167,821</i>	<i>1,212,246</i>	<i>866,095</i>	<i>598,277</i>	<i>-1,707,977</i>	<i>397,391</i>	<i>-1,520,932</i>	3,041,162

⁸⁸Subjekti deklaroi se bashkëjetesa ka filluar në tetor të vitit 2013, ndërsa krijimi i depozitës rezultoi i provuar nga statement bankar i “Tirana Bank” me derdhjet në llogari të tij në datën 27.12.2012 dhe datë 9.1.2013.

⁸⁹Tatimi në burim, ligji nr. 9326, datë 6.12.2004.

6.39.4 Prej sa më sipër, rezulton se vëllai i personit të lidhur të subjektit (bashkëjetuesit) ka pasur mundësi financiare të blejë me të ardhura të ligjshme apartamentin e z. F.H. me vlerë 6,300,000 lekë dhe t'i japë hua atij vlerën prej 15,000 euro në vitin 2013.

6.40 Në analizimin e kësaj pasurie të personit të lidhur të subjektit, trupi gjykues mban në konsideratë edhe qëndrimin e Komisionit në vendimin nr. 217, datë 5.12.2019 (vendim i cili mori formë të prerë pasi nuk u ankimua), në të cilin ka vlerësuar se: “(a) Të dyja pasuritë e deklaruar nga bashkëjetuesi i subjektit janë në pronësi të plotë të tij; (b) në asnjë rast si burim krijimi i këtyre pasurive nuk kanë shërbyer të ardhura të subjektit të rivlerësimit; (c) në asnjë rast subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime dhe nuk ka pasur transaksione bankare ose jo bankare që kanë lidhje me blerjen e pasurive dhe likuidimin e çmimit të blerjes; (d) ... (e) i vetmi interes privat i buruar prej bashkëjetesës me z. ..., sipas parashikimit të nenit 3, të ligjit nr. 85/2012, i ndryshuar, ka qenë që subjekti ka banuar në apartamentin e banimit në pronësi të bashkëjetuesit, fakt të cilin e ka deklaruar në deklaratat periodike. Për sa më sipër, Komisioni vlerësoi se (i) në pikëpamjen substanciale, në deklaratat periodike, subjekti e ka deklaruar sipas ligjit të vetmin interes privat të rrjedhur nga bashkëjetesa me z. ..., përdorimin e apartamentit në pronësi të plotë të tij. Konkretisht, në të dyja deklaratimet, kjo pasuri është deklaruar si adresë banimi dhe subjekti ka deklaruar bashkëjetesën me shtetasin ...”.

6.40.1 Sa më sipër, pas vlerësimeve dhe konsideratave të Komisionit mbi mundësinë financiare të personit të lidhur të subjektit, bashkëjetuesit, për krijimin e pasurisë apartament në qytetin e Tiranës, rezultoi se ka pasur mundësi ta blejë këtë apartament me të ardhura të ligjshme, të cilat janë krijuar para fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit. Subjekti arriti të provojë në mënyrë shteruese se pagesat e kësteve, të cilat janë shlyer me transaksione bankare, kanë burime të ligjshme dhe/ose janë të krijuara në periudha më të hershme se fillimi i bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit.

7. Aksionar dhe administrator në shoqërinë “**” sh.p.k.,** me kapital në vlerën 100,00 pjesëmarrja 33,33 %. Kjo shoqëri nuk ka ushtruar aktivitete dhe, si rrjedhojë, nuk ka përfiturar të ardhura prej momentit të krijimit (as si aksioner dividend, as si administrator page). Vlera: 100,00 (njëqind). Pjesa në përqindje: 33,33 %.

Hetimi/analiza ligjore financiare i/e kryer nga Komisioni

7.1 Subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri të personit të lidhur në asnjë prej deklaratave periodike vjetore 2014 – 2017 dhe as në atë të vitit 2018.

7.2 Kjo shoqëri është themeluar në datën 8.4.2014, me objekt veprimtarie aktivitete në fushën e ndërtimit, me administrator personin e lidhur të subjektit, bashkëjetuesin, z. F. H.⁹⁰.

7.3 E pyetur nga Komisioni mbi arsyen e mosdeklarimit të kësaj pasurie në DIPP-të e bashkëjetuesit për vitet 2014 – 2016⁹¹, subjekti shpjegoi se kjo shoqëri nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitete tregtar dhe nuk ka sjellë të ardhura, prandaj bashkëjetuesi nuk e ka pasur në vëmendje në deklarimin e parë në vitin 2014 dhe duke qenë se këtë gjë e ka sqaruar në procesverbalin e mbajtur nga inspektori i ILDKPKI-së në vitin 2015, në deklaratat e viteve pasardhëse ka shënuar nuk ka ndryshime në pasuri në raport me ato të deklaruar më parë, si edhe ato për të cilat ka shpjeguar në ILDKPKI. Në këto rrethana - vijon shpjegimin subjekti – ai (personi i lidhur)

⁹⁰Shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2020, e QKB-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.12.2020).

⁹¹Pyetësori nr. 2.

shpjegon se shprehur në këtë mënyrë, këtë të fundit e ka menduar të korrigjuar /saktësuar për sa i përket deklaratave periodike, ndërsa e ka deklaruar atë rishtazi në deklaratën *Vetting*.

7.4 ILDKPKI-ja ka përcjellë⁹² procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive dhe interesave private”, të mbajtura nga Inspektori i ILDKPKI-së dhe subjektit të deklaramit F.H. në datën 4.12.2015. Në këtë procesverbal është pyetur nga inspektori, ndër të tjera, mbi arsyen pse nuk është deklaruar prej tij ky aktivitet, pra shoqëria tregtare “****” sh.p.k., ku rezulton aksionar me 33.33 % të aksioneve dhe nëse ka përfiturar të ardhura nga ky aktivitet.

Në këtë procesverbal z. F. H. si subjekt deklarues ka shpjeguar se: *“Ky aktivitet kishte për objekt ndërtimin, pas marrjes së lejes së ndërtimit, për objekt të ndodhur në rrugën ‘****’ në Tiranë, që nuk u realizua pasi nuk u dha leja. Do paraqitem në QKR për mbylljen e këtij aktiviteti. Gjatë kësaj periudhe nuk kam përfiturar asgjë, unë isha i punësuar vetëm si administrator nëse do të fillonte aktiviteti”*.

7.5 Pavarësisht se në këtë procesverbal z. F.H. ka deklaruar që do paraqitet në QKR për mbylljen e këtij aktiviteti, rezulton se ende në QKB kjo shoqëri ka statusin “aktiv” dhe adresa e saj është: *“Rruga: ‘***, Pallati ***, Ap. ***, Tiranë’”*⁹³.

7.6 Subjekti, e pyetur nga Komisioni⁹⁴, shpjegoi se mbyllja nuk është realizuar sepse nuk ka gjetur dakordësinë e ortakëve të tjerë, të cilët nuk kanë pranuar të shlyejnë detyrimet dhe ka shpjeguar se *duke qenë se nuk është bërë mbyllja e saj, ajo është deklaruar në deklaratën Vetting duke kuptuar se është aktive, si edhe në deklaratat periodike, duke shpjeguar se nuk ka pas ndryshime në gjendjen pasurore*.

7.7 Nga DPT-ja rezulton se ky aktivitet tregtar ka status si tatimpagues “pasiv” prej datës 26.8.2016 dhe ka detyrime tatimore të pashlyera në vlerën 323,672 lekë deri në datën 28.6.2021.

7.8 Nuk rezultoi që kjo shoqëri të jetë shpallur ndonjëherë fituese për procedurat e prokurimit elektronik⁹⁵.

7.9 Rezultoi se personi i lidhur i subjektit, z. F. H., ka marrë me qira një apartament me sip. 86.96 m², kundrejt çmimit 450 euro/muaj, me qëllim përdorimin e këtij apartamenti për aktivitet privat dhe adresa e tij korrespondon me adresën e selisë së shoqërisë, por qiranë e ka lidhur si individ dhe jo si administrator i shoqërisë⁹⁶.

7.10 I pyetur nga Komisioni mbi aktivitetin privat për të cilin përdoret ky apartament dhe pse nuk është deklaruar qiraja, subjekti shpjegoi se kjo kontratë është lidhur me qëllim që të ishte zyra qendrore e shoqërisë, por bashkëjetuesi nuk e ka paguar qiranë sipas kësaj kontrate, sepse shoqëria nuk solli asnjëherë të ardhura për të dhe, në këto kushte, pronari ua ka dhënë këtë pasuri me qira personave të tjerë. Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti vendosi në dispozicion të Komisionit kontratën e qirasë të lidhur me z. F. H. dhe kontratat me të cilat pronari i apartamentit, pas përfundimit të afatit të kontratës së qirasë me z. H., ua ka dhënë këtë apartament me qira personave të tjerë⁹⁷. Gjithashtu, vendosi në dispozicion edhe statement të llogarisë bankare të z.

⁹²Me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.12.2020).

⁹³Nga ekstrakti i shoqërisë sipas të dhënave në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

⁹⁴Pyetësori nr. 4.

⁹⁵Shkresa nr. *** prot., datë 15.7.2021, e Agjencisë së Prokurimit Publik (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 19.7.2021).

⁹⁶Kontrata e qirasë nr***, datë 26.3.2014, administruar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 10.6.2021.

⁹⁷(i) Kontratën e qirasë të sipërpërmendur të lidhur midis bashkëjetuesit të saj dhe pronarit të apartamentit z. A. M. me afat 2.4.2014 – 2.4.2015; (ii) kontratë qiraje për të njëjtin apartament, të lidhur midis pronarit të tij A. M. (qiradhënës) dhe z. G. Ç.

A. M. për periudhën 6.1.2014 – 1.8.2015, nga e cila nuk rezulton të jetë kryer derdhje nga z. F. H. .

7.11 Komisioni hetoi lidhur me ekzistencën e ndonjë konflikti të mundshëm të interesit të subjektit për shkak të funksionit të saj me shoqërinë dhe/ose ortakët e saj. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (ku ka ushtruar detyrën më parë) konfirmuan se nuk rezulton që shoqëria dhe/ose ortakët e saj të jenë hetuar apo proceduar nga subjekti⁹⁸ .

7.12 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se:

- a) Nga adresa e shoqërisë sipas ekstraktit të QKB-së (Rruga “***”, p. ***, ap***, Tiranë), duket se apartamenti për të cilin është lidhur kontrata e qirasë nga z. F. H., është selia e shoqërisë. Kjo u konfirmua nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 4.
- b) Z. F.H. kontratën e qirasë për apartamentin në fjalë e ka lidhur në emrin e tij, jo si përfaqësues (administrator) i shoqërisë “***”.
- c) Me përfundimin e afatit 1-vjeçar të kontratës së qirasë të lidhur me z. F.H., pronari i apartamentit ia ka dhënë atë me qira një shtetasi tjetër, por ky fakt nuk do të thotë që gjatë atij viti që kontrata ishte e vlefshme, z. F. H. nuk e ka përdorur këtë apartament. Përkundrazi, fakti që kontrata pasardhëse e qirasë është lidhur pikërisht një ditë para përfundimit të kontratës me z. F. H., tregon se marrëdhënia e qirasë me të ekzistonte jo vetëm *de jure*, por edhe *de facto*.
- d) Nga statement bankar i llogarisë së pronarit të apartamentit nuk rezulton që gjatë periudhës së kohëzgjatjes së qirasë me z. F. H. të jetë bërë derdhje nga ky i fundit në këtë llogari, sikurse është përcaktuar në nenin 3 të kontratës⁹⁹, por kjo nuk përjashton mundësinë që pagesa të jetë bërë *cash* ose të jetë derdhur në një llogari tjetër bankare të z. A. M. .
- e) Qiramarrësi që ka marrë me qira apartamentin pas përfundimit të kontratës së qirasë të z. F. H., është z. G. Ç., avokati pranë të cilit z. F.H. ka deklaruar se ka punuar si konsulent ligjor gjatë vitit 2014¹⁰⁰ dhe person që sipas sistemit *TIMS* ka lëvizur jashtë kufirit shqiptar me automjetin e z. F. H. (përmendur dhe më lart), çka konfirmon që midis tyre ka raporte miqësore dhe/ose interesash.

7.13 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me mosdeklarimin e pjesëmarrjes si

(qiramarrës) me afat 1.4.2015 – 1.4.2016; (iii) kontratë qiraje për të njëjtin apartament, lidhur midis pronarit A. M. (qiradhënës) dhe fondacionit “***”, me afat 1.2.2016 – 31.1.2018.

⁹⁸Respektivisht shkresat me nr. *** prot., datë 3.6.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.6.2021) dhe nr. ***prot., datë 31.5.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.6.2021).

⁹⁹Pika 3.2 e nenit 3 të kontratës: Çdo pagesë e qirasë sipas kësaj kontrate do të bëhet nga qiramarrësi në llogarinë bankare të qiradhënësit pranë BKT- së me nr***.

¹⁰⁰Deklaruar në *Vetting*, në zërin “përshkrimi i të ardhurave”, pjesa “Deklaratë e pasurisë e personit të lidhur”. Komisioni pyeti subjektin (pyetësori nr. 4) edhe nëse gjatë ushtrimit të detyrës ka patur vendimmarrje në lidhje me shtetas avokat i të cilëve ka qenë G.Ç. ose ndonjë përfaqësues tjetër i studios ligjore “Ç.” dhe subjekti deklaroi se nuk ka pasur asnjë vendimmarrje në lidhje me ndonjë person avokat i të cilit të ketë qenë z. G. Ç. apo edhe ndonjë përfaqësues tjetër i studios Ç. . Kjo është konfirmuar edhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2021 dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 29.6.2021.

administrator dhe ortak me 33% të kapitalit nga personi i lidhur, bashkëjetuesi i saj, në shoqërinë “****” sh.p.k.

Qëndrimi i subjektit

7.14 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit dhe barrës së provës, subjekti prapësoi se:

“Në lidhje me këtë situatë kërkoj t’i shpjegoj Komisionit se në deklarimin e parë që bashkëjetuesi ka blerë si person i lidhur për mua, ai e ka pranuar që ka qënë një gabim nga ana e tij, por kjo ka ardhur për shkak se kjo shoqëri as atë vit as më vonë nuk mundi të ushtronte asnjëherë një aktivitet tregtar, ajo nuk ka sjellë ndonjëherë të ardhura për të, si edhe rezulton nga deklaratimet periodike më vonë. Duke qënë se kur është thirrur për të dhënë shpjegime në ILDKPI ai e ka sqaruar këtë situatë duke depozituar edhe dokumentacionin përkatës, në deklaratat në vijim, ai ka shpjeguar se nuk kam ndryshime në pasuri në raport me ato të deklaruara më parë, si edhe me ato shpjeguar në procesverbalin e ILDKPI- së.

*Në deklaratën Vetting, shoqëria ‘****’ sh.p.k., është deklaruar prej tij, por deri në këtë moment ai nuk ka gjetur mirëkuptimin e ortakëve, të cilët nuk i janë përgjigjur për të kryer pagesat që duhen për ta mbyllur atë. Secili prej ortakëve është përgjigjur vetëm për vlerën e kapitalit të regjistruar dhe pjesës takuese të kuotës.*

Gjithsesi, kjo shoqëri nuk i ka sjellë asnjëherë të ardhura bashkëjetuesit, si edhe rezulton nga hetimi nuk ka pasur të ardhura prej saj të cilat eventualisht, do të mund të ishin përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo për përballimin e ndonjë shpenzimi.

*Shoqëria ‘****’ nuk ka pasur asnjëherë aktivitet tregtar dhe nuk ka pasur asnjëherë shitje dhe, si rrjedhim, nuk ka shpërndarë asnjëherë fitim/dividend dhe aktualisht është në gjendje pasive në DRT. Kjo pasaktësi në deklaratën e parë dhe mënyra se si ajo është munduar të rikuperohet në deklaratimet në vijim, nuk ka ndikuar në krijimin e asnjë pasurie dhe se është deklaruar saktësisht në deklaratën Vetting. Për sa më sipër, kërkoj që kjo pasaktësi në deklaratat periodike të konsiderohet formale, duke qënë se nuk ka sjellë ndonjë pasojë dhe më pas është korrigjuar prej tij në deklaratën Vetting, ku bashkëjetuesi ka deklaruar sipas ligjit, pjesëmarrjen në të”.*

7.15 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim, për secilën nga çështjet e mësipërme.

Vlerësimi i Komisionit

7.16 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me tërësinë e provave të administruara, trupi gjykues çmoi se janë bindëse dhe kjo pasuri është deklaruar në deklaratën Vetting.

GJETJE TË TJERA

1. Personat e lidhur të subjektit, nga fillimi i ushtrimit të detyrës

1.1 Deri në deklaratën e vitit 2013, në përbërjen familjare të subjektit sipas certifikatës së gjendjes civile, kanë qënë edhe prindërit edhe motra e subjektit. Ajo është shkëputur nga trangu i familjes më 21.11.2014¹⁰¹, ndërkohë që subjekt rivlerësimi është bërë në nëntor të vitit 2008.

1.2 Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka shpjeguar se në periudhën tetor 2013 – maj 2015 ka bashkëjetuar me z. F. H., me nënën dhe vëllain e tij, H. dhe E. H. .

¹⁰¹Deklarimi në përgjigje të pyetësorit standard.

1.3 Sa më sipër, në analizën financiare është konsideruar numri i anëtarëve të familjes sipas deklaramit të subjektit në pyetësin standard¹⁰².

2. Në lidhje me adresat e banimit dhe objekte në pronësi të subjektit

Hetimi i kryer nga Komisioni

2.1 Sipas deklaramëve të subjektit¹⁰³, subjekti ka banuar në adresat si vijojnë:

- në periudhën nëntor 2008 - tetor 2009 (periudha e stazhit profesional) ka jetuar në Tiranë në një banesë në lagjen “****”, të marrë me qira me kontratë jo shkresore, bashkë me dy vajza të tjera qiramarrëse, në vlerën 19,000 lekë dhe është paguar nga secila, në mënyrë të barabartë;
- në periudhën tetor 2009 – tetor 2013, vendbanimi në banesën e prindërve në Vlorë, banesë private pranë vendit të quajtur “F ****”, sot rruga “H****”;
- në periudhën tetor 2013 – maj 2015, vendbanimi Tiranë, rruga “****”, banesë private e marrë më parë me qira prej z. F. H. dhe nënës e vëllait të tij E. H.;
- në maj të vitit 2015 dhe në vazhdim vendbanimi është apartamenti në pronësi të bashkëjetuesit, trajtuar më sipër.

Adresa ku ka pasur gjendjen civile, në periudhën 2008 – 2011 ka qenë Vlorë, lagjja “H.Ç.” (banesa e prindërve).

2.2 Në DIPP- të vjetore në vite ka deklaruar si adresa ku ka gjendjen civile:

- DIPP para fillimit të detyrës, 2008 – Bashkia Vlorë, lagjja nr. 1, “H. Ç.”;
- DIPP 2008, 2009 – qyteti Vlorë, lagjja “H. Ç.”;
- DIPP 2010 – Vlorë, lagjja “H. Ç.”, pranë ish fabrikës së çimentos;
- DIPP 2011 – Vlorë, lagjja “H. Ç.”;
- DIPP 2012 - 2014 – nuk ka deklaruar adresë banimi ose vendqëndrimi;
- DIPP 2015 e në vijim – adresa: rruga “****”, kompleksi P****, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë.

2.3 ASHK/Drejtorja Qendrore dhe Drejtoritë Vendore të saj kanë konfirmuar që nuk ka pasuri të regjistruara në emër të subjektit Silvana M. Lule dhe se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk rezultojnë aplikues në procesin e legalizimit¹⁰⁴.

3. Në lidhje me automjetin tip “BMW”, me targa * (targa e vjetër ***)**

Hetimi i kryer nga Komisioni

3.1 Komisioni administroi¹⁰⁵ dhe shqyrtoi dosjen e automjetit të shitur nga personi i lidhur i subjektit, z. F. H., tip “BMW” me targa ***, vlera e të cilit deklarohet se është burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit tip “BMW”, trajtuar më lart. Nga dosja rezultoi se:

3.1.1 Këtë automjet personi i lidhur e kishte blerë nga z. A. K. më 22.10.2013¹⁰⁶ në vlerën 950,000 lekë dhe më 10.9.2014 ia ka shitur z. S. S. në vlerën 1,000,000 lekë.

¹⁰²Në nëntor 2008 - tetor 2009 janë llogaritur shpenzime jetike vetëm për subjektin e rivlerësimit; prej nëntorit 2009 – tetor 2013 është trajtuar familja me 5 anëtarë (subjekti, prindërit, motra dhe gjyshja, ndërsa vëllai i saj rezulton jashtë Shqipërisë); tetor 2013 - dhjetor 2014 është trajtuar familje me 4 anëtarë (subjekti, bashkëjetuesi, vëllai i bashkëjetuesit E. dhe nëna e bashkëjetuesit); janar – maj 2015 është trajtuar familje me 5 anëtarë, pasi është shtuar edhe vajza prej momentit të lindjes; qershor 2015 e në vazhdim është trajtuar familja me 3 anëtarë (subjekti, bashkëjetuesi dhe vajza e tyre).

¹⁰³ Në përgjigje të pyetësorit standard.

¹⁰⁴Shkresat në përgjigje të shkresës së Komisionit me nr. *** prot., datë 23.11.2020 dhe shkresa nr. *** prot., datë 16.12.2020.

¹⁰⁵Shkresa nr. *** prot., datë 27.9.2018, e DPSHTRR-së.

3.1.2 Personi i lidhur nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP pas largimit nga funksioni (për shkak të detyrës, ka qenë subjekt deklarues) dhe as në DIPP-në e subjektit të vitit 2014 ku ka qenë person i lidhur dhe nuk ka deklaruar as automjetin dhe as shitjen e tij.

3.1.3 Bashkëjetesën me z. F. H. subjekti e ka filluar në tetor të vitit 2013, ndërsa nga sistemi *TIMS* rezulton se subjekti ka udhëtuar me z. F. H. me këtë automjet më 11.8.2013.

3.1.4 Nuk rezultoi që subjekti të ketë qenë në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të funksionit të saj me shitësin dhe blerësin e automjetit¹⁰⁷.

3.1.5 Në përfundim, Komisioni konstatoi se blerja dhe shitja e këtij automjeti nga personi i lidhur i subjektit është bërë gjatë kohës së bashkëjetesës, ndërkohë që në DIPP-në e vitit 2014 nuk është deklaruar as automjeti dhe as shitja e tij.

3.1.6 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me sa më lart.

Qëndrimi i subjektit

3.2 Subjekti nuk paraqiti shpjegime të tjera përveç shpjegimeve të trajtuara më lart, në analizën e automjetit me targa ***, si burim i të cilit ka shërbyer shitja e automjetit me targa ***.

Vlerësimi i Komisionit

3.3 Në deklaratën vetting *Vetting* është deklaruar shitja e këtij automjeti me kontratën nr. ***, datë 10. 9.2014, vlera e të cilit është përdorur si burim për blerjen e automjetit me targa targa ***, trajtuar më lart dhe trupi gjykues vlerësoi se mosdeklarimi i kësaj kontrate në DIPP-në e vitit 2014 është korrigjuar me deklarimin e saj në deklaratën *Vetting*.

4. OJF dhe studio ligjore e personit të lidhur/bashkëjetuesit të subjektit

Hetimi i kryer nga Komisioni

4.1 Rezultoi se personi i lidhur i subjektit, bashkëjetuesi, është një ndër themeluesit dhe anëtar bordi i një OJF-je të themeluar më 21.11.2019¹⁰⁸, si dhe ortak me 50% të kuotave në një shoqëri tregtare të themeluar në datën 9.9.2020, me objekt veprimtarie ushtrimin e veprimtarisë në fushën e avokatisë, këshillime ligjore, etj.¹⁰⁹.

4.2 Shoqëria tregtare ka shlyer detyrimet tatimore dhe ka kryer pagesat e kontributeve shoqërore prej shtatorit të vitit 2020 e në vijim dhe nuk ka detyrime të pashlyera në vonesë. Ndërsa për vitin 2020 rezultati financiar i shoqërisë është deklaruar me humbje në vlerën 822,691 lekë¹¹⁰.

4.3 Nuk rezultoi që subjekti të ketë hetuar çështje ku av. G. H. dhe/ose ndonjë përfaqësues i studios ligjore, të kenë qenë përfaqësues të ndonjë subjekti me cilësitë kallëzues/viktima/të dëmtuar apo të kallëzuar, të dyshuar; persona nën hetim apo të pandehur¹¹¹.

¹⁰⁶Kontratë nr. ***, notere G. Sh. .

¹⁰⁷Shkresat nr. *** prot., datë 31.5.2021, Prokuroria Vlorë (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 2.6.2021) dhe nr. *** prot., datë 3.6.2021, Prokuroria Tiranë (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 3.6.2021).

¹⁰⁸Regjistri noterial dërguar nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. *** prot., datë 4.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.12.2020) dhe shkresa e administruar në Komision me nr. *** prot., datë 14.6.2021.

¹⁰⁹Shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2020, e QKB-së (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.12.2020).

¹¹⁰Shkresa nr. *** prot., datë 5.7.2021, e DPT-së.

¹¹¹Shkresa nr. *** prot., datë 7.7.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, administruar në Komision me nr. *** prot., datë 7.7.2021).

Vlerësimi i Komisionit

4.4 Pasi analizoi dokumentacionin e administruar në lidhje me këto pasuri, trupi gjykues vlerësoi se OJF-ja dhe shoqëria tregtare në fjalë janë krijuar pas deklaratës *Vetting* dhe nuk ka të dhëna që subjekti ka ndikuar në krijimin e tyre. Subjekti nuk ka hetuar ndonjë çështje në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Pasuri të prindërve të subjektit

Hetimi i kryer nga Komisioni

5.1 Pasuri truall + ndërtesë

5.1.1 Nga hetimi¹¹² rezultoi se në favor të personave të lidhur, prindërve të subjektit, është e regjistruar një pasuri truall + ndërtesë, përfituar me kontratë privatizimi në vitin 1995¹¹³.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmoi se kjo pasuri është fituar nga prindërit e subjektit para se subjekti të bëhej subjekt rivlerësimi dhe nuk ka të dhëna që ajo ka ndikuar në formimin e kësaj pasurie.

5.2 Automjete

5.2.1 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka informuar Komisionin¹¹⁴ se shtetasi M.L.L. (babai i subjektit) ka në pronësi automjetin tip “Opel Astra”, me targa ***, ngjyrë e zezë.

5.2.2 Nga sistemi elektronik i AMF-së rezulton se shtetasi M. L., që prej datës 2.3.2016 e në vijim ka blerë policia sigurimi për automjetin me targa ***, me nr. shasie ***. Në të gjitha policat ai rezulton pronar dhe përdorues i automjetit.

5.2.3 Komisioni i është drejtuar DPSHTRR-së¹¹⁵ me kërkesë për të informuar mbi çdo të dhënë të gjendur për çdo automjet në pronësi (ose që kanë pasur në pronësi) ose në përdorim të prindërve të subjektit, vëllait dhe motrës së saj, si dhe të vëllait dhe nënës së bashkëjetuesit, me të cilët subjekti ka jetuar për njëfarë kohe.

5.2.4 DPSHTRR-ja informoi¹¹⁶ se nga personat e sipërpërmendur ka automjet në pronësi babai i subjektit, z. M.L. . Rezulton se këtë automjet ai e ka blerë në vitin 2016, pra gjatë kohës që babai nuk ka qenë person i lidhur me subjektin.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmoi se këtë automjet babai i subjektit e ka blerë gjatë kohës që nuk ka qenë person i lidhur i subjektit dhe nuk ka të dhëna që ky i fundit të ketë ndikuar në krijimin e kësaj pasurie.

6. Transferta monetare drejt Italisë

Hetimi i kryer nga Komisioni

¹¹²Shkresa nr. *** prot., datë datë 16.2.2021, e ASHK/Drejtoria Vendore Vlorë (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 25.2.2021).

¹¹³Pasuria nr. ***, e llojit “truall” me sip. 100 m² dhe “ndërtesë” me sip. 75 m², e cila është e regjistruar në vol. ***, f. ***, në z.k. ***, në favor të shtetasve M. L. L. dhe L. P. L., e përfituar me kontratë privatizimi datë 24.9.1995.

¹¹⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 9.7.2021.

¹¹⁵Shkresa nr. *** prot., datë 1.7.2021.

¹¹⁶Shkresa nr. *** prot., datë 9.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 12.7.2021).

6.1 Rezultoi se janë kryer disa dërgesa parash të nisura nga babai i subjektit, drejt Italisë, me përfitues z. A. D. (2 transferta të kryera në vitet 2011 dhe 2012) dhe z. G. D. (22 transferta, të kryera përgjatë viteve 2012 – 2020) në vlerën totale 23,949 euro¹¹⁷.

6.2 Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime mbi këto veprime të kryera nga babai i saj, duke përfshirë qëllimin e tyre dhe lidhjen e tij me përfituesin e këtyre transfertave, si dhe i kërkoi të vendosë në dispozicion edhe dokumentacionin përkatës që tregon burimin e këtyre vlerave dhe qëllimin e transfertave¹¹⁸.

6.3 Në përgjigje, subjekti shpjegoi: “*Sipas shpjegimeve të babait tim, shtetasit G. dhe D. D. janë miq të hershëm të tij. Ata jetojnë prej shumë vitesh, ndoshta 20 vjet, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në Itali. Për këtë arsye, kanë autorizuar babain tim të tërheqë pensionet e tyre të pleqërisë dhe ai ua ka dërguar atyre në Itali (shtetasi A.D., është i biri i G. dhe D.D.). Këto veprime janë kryer në bazë të prokurave të të posaçme, prokurë nr. ***, datë 28.10.2011 dhe prokurë nr. ***, notere M. Gj. .*

Pra, këto dërgesa janë pensionet e pleqërisë të personave që u janë dërguar, të tërhequra në Shqipëri tek Posta Shqiptare nga babai im, për shkak se përfituesit e tyre nuk ndodhen në vendin tonë”.

6.4 Bashkëlidhur sqarimeve, subjekti ka depozituar dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Shkresë nga Posta Shqiptare, filiali Vlorë¹¹⁹, me të cilën kjo e fundit informon se:

- Z. M.L. ka tërhequr pensionin e pleqërisë të z. G.D. në bazë të prokurës nr***, datë 28.10.2011 për periudhën 28.10.2011 – 21.03.2014.
- Z. M.L. ka tërhequr pensionin e pleqërisë të shtetasve G. dhe D. D. në bazë të prokurës nr. ***, datë 21.3.2014. Pensionin e pleqërisë e ka tërhequr prej periudhës 21.3.2014 – 21.4.2021, pagesa e pensionit është bërë në bazë të prokurës së lëshuar nga pensionistët.

b) Prokurat me të cilat shtetasit G. dhe D. D. kanë autorizuar z. M. L. të tërheqë pensionin¹²⁰ dhe vërtetimin e notere M.Gj., të nxjerrjes nga arkiva të prokurave të sipërpërmendura¹²¹.

6.5 Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka konfirmuar¹²² se z. G.D. ka përfituar pension që në muajin gusht të vitit 2005¹²³, ndërsa znj. D. D., që nga nëntori i vitit 2012¹²⁴.

6.6 Vlera totale e pensionit të përfituar prej tyre për këtë periudhë është në vlerën 58,077 euro (7,721,362 lekë).

Vlerësimi i Komisionit

Pasi shqyrtoi dhe analizoi dokumentacionin e sipërpërmendur dhe shpjegimet e subjektit, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet e subjektit në lidhje me këto transferta përputhen me

¹¹⁷Informacion i përcjellë nga institucionet financiare AK Invest dhe MoneyGram me shkresën nr. *** prot., datë 7.12.2020 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 9.12.2020).

¹¹⁸Pyetësori nr. 4.

¹¹⁹Nr. *** prot., datë 28.6.2021.

¹²⁰Prokura nr. ***, datë 28.10.2011 dhe nr. ***, datë 21.3.2014, notere M.Gj. Vlorë.

¹²¹Vërtetim nr. ***, datë 28.6.2021.

¹²²Me shkresën nr. *** prot., datë datë 21.6.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 23.6.2021).

¹²³Për periudhën gusht 2005 – maj 2015 ka përfituar pension të parakohshëm ushtarak dhe nga muaji maj 2015, pension pleqërie dhe pension suplementar ushtarak.

¹²⁴Nga nëntori i vitit 2012 ka përfituar pension të parakohshëm ushtarak dhe pension pleqërie, korrik 2009 – nëntor 2012 ka përfituar pension suplementar ushtarak.

dokumentacionin e përcjellë.

7. Të dhëna nga regjistri noterial

Hetimi i kryer nga Komisioni

7.1 Nga informacioni i dërguar nga Ministria e Drejtësisë¹²⁵ rezultoi se në Regjistrin Noterial Shqiptar nuk figurojnë veprime/akte noteriale të kryera për subjektin Silvana M. Lule, ndërkohë që rezultojnë disa veprime të kryera për personat e lidhur të subjektit¹²⁶.

7.2 Rezultoi që veprimet e kryera nga shtetasit M. L., L. L. dhe H. H. janë prokura dhe vërtetime të njësisë me origjinalin, prandaj nuk përbëjnë interes për këtë proces, ndërsa për z. F. H. janë regjistruar një sërë aktesh noteriale, të cilat me kërkesë të Komisionit¹²⁷, u vendosën në dispozicion nga noterët.

7.3 Rezultoi se disa prej kontratave të nënshkruara nga z. F. H. janë kontrata të kalimit të pronësisë së parcelave ndërtimore të lidhura nga bashkëjetuesi i subjektit si përfaqësues i ALUIZNI-t¹²⁸, pra janë kontrata të lidhura prej tij për shkak të detyrës, si përfaqësues i ALUIZNI-t, prandaj vlerësohet se nuk përbëjnë interes për këtë proces. Veprimet e tjera noteriale janë kontratat e referuara në analizën e bërë për secilën pasuri dhe aktet që lidhen me OJF-në e trajtuar më lart.

7.4 Nuk rezultuan veprime noteriale të kryera nga shtetasit B.L. dhe Dh. L.; B. L. ka kryer vetëm njësim me origjinalin, ndërsa për E. H. rezultuan veprime juridike me përshkrimin “kontratë shitje ose dhurim-kalim pasurie të paluajtshme”¹²⁹.

7.5 Rezultoi se z. E. H. ka lidhur kontratë sipërmarrje për prenotim apartamenti me shoqërinë “****” në datën 5.3.2015¹³⁰ (pra, gjatë kohës kur subjekti jetonte me të, me bashkëjetuesin dhe me nënën e tyre) dhe në datën 9.2.2017 ka lidhur kontratën e shitblerjes me shoqërinë “****”¹³¹. Pavarësisht se kjo kontratë shitblerjeje është lidhur në vitin 2017, nga informacioni i dërguar nga BKT-ja¹³² rezulton se z. E.H. ka derdhur në llogarinë e shoqërisë “****” shumën 45,647 euro në datën 5.3.2015 (pra, gjatë kohës kur subjekti jetonte me të, me bashkëjetuesin dhe nënën e tyre).

8. Konstatim nga tërësia e hetimit administrativ

8.1 Gjatë hetimit, Komisioni konstatoi se në lidhje me pasuritë e subjektit dhe të personave të lidhur, u konstatuan se një sërë veprimesh juridike të personit të lidhur (bashkëjetuesit) të subjektit janë kryer me persona që kanë qenë pjesë e kallëzimeve dhe/ose procedimeve penale të hetuara nga subjekti.

¹²⁵Shkresa nr. *** prot., datë 4.12.2020 (protokolluar në Komision me nr*** prot., datë 9.12.2020).

¹²⁶Shtetasit F.H. (bashkëjetuesi), M.L. (babai i subjektit), L. L. (nëna e subjektit) dhe H. H. (nëna e bashkëjetuesit të subjektit).

¹²⁷Shkresat nr*** prot., ***prot., *** prot., *** prot., *** prot., ***prot., *** prot., datë 10.6.2021, nr. ***prot., datë 5.7.2021.

¹²⁸Kontrata nr***, datë 3.4.2013, e dërguar nga noterja M.Sh.¹²⁸, kontratat nr. ***, datë 8.7.2013 dhe nr. ***, datë 17.9.2013, të dërguara nga noterja L.M.¹²⁸, kontrata nr. ***, datë 27.5.2013, lidhur para noter J. Zh., kontrata nr. ***, dërguar nga notere N. Gj.¹²⁸, kontrata nr. ***, datë 8.5.2013, dërguar nga notere A.M. .

¹²⁹Dh., B. dhe B.L. (gjyshja, vëllai dhe motra e subjektit) subjekti i ka deklaruar në përbërje familjare sipas certifikatës familjare nga marrja e detyrës në vitin 2008, deri në DIPP-në e vitit 2013 (Dh. dhe B. L., deri në DIPP-në e vitit 2010, B. L. deri në DIPP-në e vitit 2013). Për E. H. (vëllai i bashkëjetuesit të subjektit) subjekti ka deklaruar që ka jetuar së bashku me të dhe me nënën e bashkëjetuesit, që nga tetori 2013 – maj 2015.

¹³⁰Kontratë nr***, datë 5.3.2015.

¹³¹Kontratë shitjeje nr. ***, datë 9.2.2017.

¹³²Shkresa nr. *** prot., datë 15.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 16.7.2021).

8.2 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit

8.3 Pas njohjes me rezultat e hetimit, subjekti prapësoi si vijon:

“Në lidhje me shtetasin R. N., ai nuk është një person që bashkëjetuesi dhe i vëllai z. G.H. e njohin apo kanë pasur ndonjë lidhje.

*Gjithashtu, unë nuk e kujtoj procedimin penal në të cilin ky person ka pasur cilësinë e të pandehurit, por gjithsesi kërkoj të shpjegoj se si koha në të cilën unë kam hetuar çështjen penale (viti 2010), ashtu edhe ajo në të cilën rezultoi nga dosja e mjetit, se ky person ka bërë një kërkesë për mjetin me targa *** (viti 2011), i përkasin një periudhe në të cilën nuk e njihja bashkëjetuesin. Pasur parasysh se nuk rezultoi asnjë e dhënë nga hetimi mbi ndonjë lidhje të mundshme të këtij personi me këtë mjet, mendoj se si edhe ka shpjeguar DRSHTRR-ja, duhet të bëhet fjalë për ndonjë gabim material të institucionit.*

*Në lidhje me shtetasin S.Gj. kërkoj të shpjegoj edhe një herë se ky nuk person nuk njihet prej bashkëjetuesit tim, por nisur edhe nga të dhënat e ekstraktit historik për ‘***’ sh.p.k., ai është bërë administrator i kësaj shoqërie në vitin 2020 dhe nuk ka qenë i tillë në momentin që bashkëjetuesi ka bërë mjetin apo unë kam vlerësuar kallëzimin penal, të bërë nga ai”.*

8.4 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrori të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim, për secilën nga çështjet e mësipërme.

Vlerësimi i Komisionit

8.5 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me provat e administruara gjatë hetimit, trupi gjykues çmoi se shpjegimet janë bindëse.

9. Analiza financiare për periudhën 2008 – 2016

9.1 Nga hetimi i Komisionit rezultoi se nga analiza e deklaratave të interesave pasurore private/vjetore, deklaratës *Vetting* dhe dokumentacionit të përcjellë për periudhën e hetimit që përfshin vitet 2008 – 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pamjaftueshmëri të ardhurash të ligjshme për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë, duke rezultuar në vlerë negative në analizën financiare prej 3,363,855 lekësh.

9.2 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të paraqitur shpjegime apo prova për të provuar të kundërtën e hetimit në lidhje me pamundësinë financiare të rezultuar gjatë hetimit.

Qëndrimi i subjektit

9.3 Subjekti, me prapësimet, shpjegon në lidhje me analizën financiare si vijon:

“Në analizën financiare për vitin 2013 duhet të përfshihet huaja që shtetasi G. H. i ka dhënë vëllait të tij F. H. për blerjen e apartamentit me sip. 124 m². Nga shpjegimet dhe argumentet e dhëna në analizimin e burimit të tretë të krijimit për blerjen e apartamentit u provua mundësia financiare që vëllai i bashkëjetuesit kishte për të dhënë hua.

*Me paraqitjen e provës për shitjen e apartamentit sipas kontratës nr. ***, të datës 4.12.2013, kundrejt çmimit 7,132,250 lekë, shtetasi G. H. rezulton se ka të ardhura të ligjshme dhe rezulton me mundësi financiare për blerjen e apartamentit të bashkëjetuesit F. H. dhe dhënien e huas në shumën 15,000 euro.*

Gjithashtu, në analizën financiare për vitin 2013 duhet të përfshihen edhe të ardhurat familjare të bashkëjetuesit që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip 'BMW'. Kontributi i dhënë prej vëllait të bashkëjetuesit E. H. në shumën 450,000 lekë që shërbeu si një prej burimeve për blerjen e automjetit tip 'BMW', duhet të përfshihet në analizë. Bazuar edhe në provat e paraqitura Komisionit, rezulton e provuar se automjeti tip 'Citroen' vazhdon edhe posedohet prej vëllait të bashkëjetuesit, E..

*Në analizën financiare për vitin 2014 duhet të përfshihen të ardhurat nga shitja e automjetit tip 'BMW' me targa ***. Vlerësoj se shpjegimet dhe provat e dërguara në analizën e burimit të krijimit për blerjen e automjetit tip 'BMW' ***, tregojnë se momenti i likuidimit si të shitjes dhe blerjes është në datën 27.8.2014.*

Në analizën financiare për vitin 2015 nuk duhet të përfshihet detyrimi në shumën 2,064,750 lekë (ose 15,000 euro), pasi huaja e marrë është në vitin 2013 dhe jo në vitin 2015”.

Vlerësimi i Komisionit

9.4 Nga shpjegimet e dhëna me prapësimet dhe gjatë seancës dëgjimore nga subjekti i vlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se, bashkëjetuesi i subjektit ka provuar se ka blerë apartamentin me të ardhura të ligjshme, të cilat janë krijuar përpara fillimit të bashkëjetesës. Në analizën financiare përfundimtare të Komisionit janë përfshirë të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Vlorës të z. F.H. me vlerë 6,300,000 lekë dhe huaja e dhënë nga vëllai i tij z. G.H. me vlerë 15,000 euro në vitin 2013.

9.5 Gjithashtu Komisioni çmon se subjekti arriti të provojë bindshëm dhe në mënyrë shteruese se si burim për blerjen e automjetit tip 'BMW' me targa *** ka shërbyer vlera e shitjes së automjetit tip "BMW" me targa ***.

9.6 Ndërsa nuk u përfshi në analizën financiare shpjegimi i subjektit mbi kontributin e vëllait z. E.H. me vlerë 450,000 lekë për blerjen e automjetit tip "BMW" gjatë vitit 2013, pasi u konsiderua si prova më bindëse deklarimi i bërë nga bashkëjetuesi në deklaratën *Vetting*, ku deklarohet si burim "të ardhurat të siguruara nga paga si punonjës i ALUIZNI-t".

9.7 Pas vlerësimit dhe konsideratave të mësipërme nga Komisioni, rezultati i analizës financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2008 – 2016, rezulton të jetë me vlerë negative prej 426,627 lekësh.

Analiza financiare për periudhën 2008 – 2016

Përshkrimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	-64,119	-23,921	194,180	-42,998	-130,349	10,831,708	438,079	-16,964	-1,112
Sipërfaqe toke prej 6,800 m ² , e llojit pemtore me adresë S***.Q*** P***. Pjesa takuese 1/24									
Sipërfaqe toke prej 40 000 m ² , e llojit kullotë, me adresë S***, P***. Pjesa takuese 1/24									
Sipërfaqe toke prej 13 100 m ² , e llojit tokë bujqësore, me adresë B***, S***. Pjesa takuese 1/24									
Apartament 2+1 me sip. 125,18 m ² , vlera 70,000 euro, T***.						9,814,700			
Automjet tip Citroen C3, me targa A***, blerë me datë 31.01.2014.							489,070		
Autoveturë tip "Audi" me targa A***, blerë me kontratën datë 26.10.2011.(T***)									
Autoveturë tip BMW, me targë A***, blerë me kontratën datë 27.8.2014.							1,000,000		
Autoveturë tip BMW, me targë A***, blerë me kontratën datë 22.10.2013.(targa A***)						950,000	-1,000,000		
Aksioner dhe administrator në shoqërimë "A****" shpk, me kapital 100,00 lekë pjesëmarrja 33,33 %.									
Shtesa/pakësime likuiditete në bankë	-64,119	-23,921	194,180	-42,998	-130,349	67,008	-50,991	-16,964	-1,112
<i>Total likuiditete</i>	<i>3,221</i>	<i>-20,701</i>	<i>173,479</i>	<i>130,481</i>	<i>131</i>	<i>67,140</i>	<i>16,149</i>	<i>-816</i>	<i>-1,928</i>
DETYRIME	0	0	0	528,142	-182,497	1,835,847	-78,343	0	0
Hua prej C*** H***, në shumën prej 15,000 euro						2,103,150			
Kontratë kredie me R*** Bank, dt. 14.07.2011 në vlerën 600,000 lekë				528,142	-182,497	-267,303	-78,343		
PASURI NETO	-64,119	-23,921	194,180	-571,141	52,148	8,995,861	516,422	-16,964	-1,112
TË ARDHURA dokumentuar	61,023	971,633	1,936,203	1,990,179	1,715,401	9,321,904	1,159,759	1,242,895	1,039,117
Të ardhura nga paga për subjektin e rivlerësimit	61,023	864,955	1,179,671	1,405,571	1,109,642	1,073,772	1,159,759	93,316	1,039,117
Të ardhura nga leja e lindjes për subjektin e rivlerësimit								762,899	
Të ardhura nga pensioni për M*** L*** prej shtator 2008 me masë mujore 13,753 lekë		27,506	165,036	165,036	165,036	137,530			
Të ardhura nga paga e L*** L*** prej shtator 2008 deri në tetor 2013		65,846	511,540	339,616	360,767	275,725			
Të ardhura nga pensioni për Dh*** L*** prej shkurt 1981 me masë mujore 6,663 lekë		13,326	79,956	79,956	79,956	66,630			
Të ardhura për F*** H*** nëntor 2013 deri në maj 2015 (vlera e urdhërit të ekzekutimit nr. 997 dt. 30.04.2015)								386,680	
Të ardhura nga shitja e apartament 2+1 me sip. 89,98 m ² , V*** shitur me vlerë 6,300,000 lekë në datë 24.12.2013.						6,300,000			
Të ardhura nga puna si konsulent ligjor pranë studio ligjore "C****".									
Të ardhura nga bashkëjetuesi përpara fillimit të bashkëjetesës						1,468,247			
SHPENZIME	35,437	291,033	683,100	850,772	806,695	752,670	477,415	892,828	734,633
Shpenzime interesi per kredine prane R*** Bank				32,138	67,039	35,134	3,969		
Shpenzime qeraje të subjektit	12,667	63,333							
Shpenzime mobilimi								220,000	
Shpenzime jetese	22,770	227,700	683,100	683,100	697,740	634,608	439,996	672,828	705,276
Shpenzime udhëtimi				135,534	41,916	82,928	33,450	-	29,357
Analiza dokumentuar	89,705	704,521	1,058,923	1,710,547	856,558	-426,627	165,922	367,031	305,597

Konkluzion përfundimtar për kriterin e pasurisë

Komisioni, në përfundim të këtij hetimi administrativ, pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar, përgjigjet dhe provat e paraqitura nga subjekti në pyetësorët e dërguar, si dhe provat dhe parashtrimet në përgjigje të barrës së provës, çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë, si vijon:

- i. Subjekti ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, në zotërim ose në përdorim të tij.
- iii. Pasaktësitë e konstatuara në deklaratat periodike sa i përket pasurive të personit të lidhur, si dhe ekzistenca e një balance të vogël në analizën financiare, nuk janë në atë shkallë sa të përbëjnë shkak për shkarkim, sipas pikës 3 të nenit 61 dhe nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit, duke cënuar besimin e publikut të drejtësisë.
- iv. Për sa më sipër, trupi gjykoës vlerëson se subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017 mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Silvana M. Lule, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 5.2.2021, të KDZH-së, nga ku rezulton se:

- a) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016;
- b) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës;
- c) për të nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Silvana M. Lule.

2. Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Përgjithshme¹³³ me kërkesën për informacion në lidhje me *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve për përfshirjen e subjektit drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta, që cenojnë figurën e tij.

¹³³Shkresa nr. *** prot., datë 23.11.2020.

Prokuroria e Përgjithshme përçolli¹³⁴ informacionin e ardhur nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, nga të cilat rezulton se për subjektin e rivlerësimit janë regjistruar dy kallëzime penale për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal¹³⁵.

3. Media elektronike¹³⁶ vë në dijeni të faktit se ndaj personit të lidhur të subjektit/z. F. H. (bashkëjetuesit të saj) kishte procedim penal

Për të vlerësuar nëse ekziston një kontakt i papërshtatshëm i subjektit me një person të përfshirë në krimin e organizuar dhe nëse është para pamjaftueshmërisë së deklaramit nga subjekti në deklaratën e kontrollit të figurës, Komisioni kërkoi informacion¹³⁷ të shoqëruar me dokumentacion, nëse shtetasi F. B. H. ka qenë ndonjëherë i kallëzuar, i dyshuar, person nën hetim apo i pandehur.

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë informoi¹³⁸ se në ngarkim të këtij shtetasi ishin regjistruar dy kallëzime penale me vendim mosfillimi dhe një procedim penal, dërguar në gjykatë në datën 12.7.2015 me të pandehur shtetasin F.B.H., për nenin 248 të Kodit Penal.

Nga dosjet bashkëlidhur shkresës, rezultoi:

- i. Një kallëzim¹³⁹ për të cilin është vendosur mosfillimi është bërë prej tij si kallëzues për faktin se i ka humbur karta e identitetit. Kallëzimet e tjera janë për veprën penale “shpërdorim detyre”. Konkretisht:
- ii. Kallëzimi nr***i vitit 2014 është bërë nga shtetasi I. A. kundër F. H., në cilësinë e ish Drejtorit të Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana 3, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Për këtë kallëzim, nga ana e prokurorit A. G. është vendosur mosfillimi i procedimit penal.
- iii. Procedimi penal nr. *** i vitit 2014 është bashkim i dy procedimeve penale për veprën “shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 148 i Kodit Penal.
 - Njëri procedim është regjistruar pas kallëzimit penal të bërë nga ALUIZNI. Ky i fundit ka bërë kallëzimin penal pasi nga verifikimi i 7 objekteve të legalizuara, të ndodhura në rrugën “****”, Tiranë, përbri ndërtesës së Korpusit Universitar, ka rezultuar se lejet e legalizimit janë marrë në kundërshtim me ligjin dhe me aktet nënligjore.
 - Procedimi tjetër është regjistruar pas kallëzimit të bërë nga një shtetase në lidhje me legalizimin e kundërligjshëm të një shtese kati në pallatet “****”.
 - Në përfundim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë gjykimin e kësaj çështjeje penale.
 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. ***, datë 18.5.2016 ka vendosur: *“Deklarimin fajtor të të pandehurit F. B. H. për veprën penale ‘shpërdorim detyre’ të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal e në bazë të këtij neni, dënimin e të pandehurit me 2 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurave Penale i ulet 1/3 e dënimin dhe i pandehuri dënohet me 1 vit e 4 muaj burgim. Në aplikim të nenit 60/9 të*

¹³⁴Me shkresën nr*** prot., datë 27.11.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 17.5.2021).

¹³⁵Kallëzim penal nr. ***, viti 2013, Prokuroria Fier dhe materiali hetimor *** i vitit 2019, Prokuroria Durrës, për veprën penale “shpërdorim detyre”. Për të dy është vendosur mosfillimi i procedimit penal, respektivisht në datat 7.11.2019 dhe 6.1.2014.

¹³⁶<https://www.gazeta-shqip.com/2015/02/04/lirohen-ne-arrati-zyrtaret-e-aluizni-t>

¹³⁷Shkresa nr. *** prot., datë 27.5.2021, drejtuar Prokurorisë Tiranë.

¹³⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 31.5.2021 (protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 31.5.2021).

¹³⁹Kallëzimi nr. ***, datë 22.1.2021.

Kodit Penal urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit, duke e vënë të pandehurin në provë për një periudhë prej 18 muajsh”.

- Ndjaj këtij vendimi ka bërë ankim z. F. H. dhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 20.6.2018 ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të tij.

Referuar pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, *“Krim i organizuar, trafikimi dhe korrupsioni përfshijnë veprat penale që sipas nenit 75/a të Kodit të Procedurës Penale janë në kompetencë të Gjykatës së Krimeve të Rënda, ose të çdo gjykate tjetër që mund të zëvendësojë atë në ushtrimin e këtyre kompetencave”.*

Bazuar në pikën 15, të nenit 3, të këtij ligji, *“Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë”.*

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në vlerësimin e rrethanave si më sipër, përveç faktit se vendimi i pushimit të çështjes është vendim i formës së prerë, ka parasysh edhe faktin se shpërdorimi i detyrës i përcaktuar në nenin 248 të Kodit Penal nuk bën pjesë në veprat e sipërpërmendura në të cilat referon ligji nr. 84/2016 për krimin e organizuar, pra kjo vepër penale nuk bën pjesë te krimi i organizuar në kuptim të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.* Për rrjedhojë, nuk është para kontaktit të papërshtatshëm të subjektit apo pamjaftueshmërisë së deklarimit nga subjekti në deklaratën e kontrollit të figurës.

Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës

Në përfundim të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk rezultuan të dhëna të tjera që subjekti të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në zbatim të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Silvana Lule, bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale, dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me shkresën nr. *** prot., datë 20.9.2021, si dhe në gjetjet e Komisionit gjatë hetimit administrativ. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;

- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura ngasubjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga Drejtoria e Menaxhimit të Dokumentacionit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse në Prokurorinë e Përgjithshme; (iv) të dhënave nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

GJETJET NGA FORMULARI I VETËVLERËSIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

Formulari paraqitet i nënshkruar dhe i plotësuar sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Duke iu referuar të dhënave të deklaruara në formularin e vetëvlerësimit, subjekti ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për periudhën tetor 2009 – shkurt 2016.

Në periudhën tetor 2013 – tetor 2015 ka ushtruar detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (e komanduar), ndërsa në periudhën tetor 2015 – shkurt 2016 ka ushtruar detyrën në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në shkurt të vitit 2016 e deri aktualisht, ka ushtruar detyrën si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa iu përket të dhënave statistikore në tri vitet e fundit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një shifër të përgjithshme të çështjeve të caktuara, të përfunduara dhe të mbartura, konkretisht:

- çështje të caktuara tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës -497 procedime penale, 23 kërkesa për revokim dhe 15 kërkesa për ekstradim;
- çështje të përfunduara tri vitet e fundit të detyrës - 452 procedime penale;
- çështje të mbartura vitin e fundit të ushtrimit të detyrës janë 45 procedime penale.

Subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka përzgjedhur dhe ka paraqitur tri dokumente ligjore: një vendim për pushimin e çështjes dhe dy kërkesa për gjykimin e çështjes penale, konkretisht:

- i) Vendim për pushimin e çështjes, procedimi penal nr. ***, viti 2015, për veprën penale “mjekimi i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.
- ii) Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr***, viti 2016, në ngarkim të shtetasit Sh. Ç., akuzuar për veprën penale “deklarata e rreme përpara oficerit të policisë gjyqësore”, parashikuar nga neni 305/b i Kodit Penal.
- iii) Kërkesë për gjykimin e çështjes penale nr. ***, viti 2016, në ngarkim të shtetasit M. S., akuzuar për veprën penale “plagosja e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal.

PËRSHKRIMI I PESË DOSJEVE TË PËRZGJEDHURA ME SHORT

Dosja 1 – kallëzimi penal nr. * datë regjistrimi 8.6.2016**, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Gjatë një kontrolli rutinë që iu është bërë tre shtetasve është sekuestruar një sasi lënde e dyshuar si narkotike, pas peshimit të së cilës rezultoi në masën 1 (një) gram. Në lidhje me këtë fakt i janë marrë të dhëna personave që kanë dijeni për rrethanat e veprës penale dhe është vendosur kryerja e ekspertimeve përkatëse. Pas administrimit të të gjitha akteve, duke vlerësuar se hetimet janë të plota, nga subjekti i rivlerësimit është arritur në përfundimin se fakti i mësipërm nuk përbën vepër penale dhe ka arsytuar, ndër të tjera, se përdorimi në sasi të vogla, për përdorim vetjak, nuk është i dënueshëm penalisht, por sasia çmohet rast pas rasti.

Në përfundim, duke vlerësuar se nuk plotësohen elementët e veprës penale, bazuar në nenin 290/1, germa “ç” dhe 291 të Kodit të Procedurave Penale subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Nga shkresa nr. *** prot., datë 31.8.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se lidhur me këtë kallëzim penal nuk ka asnjë vendim gjyqësor.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese – argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, teksti është i qartë dhe i kuptueshëm. Ka përputhje midis pjesës arsytuese të vendimit, bazës ligjore të identifikuar dhe dispozitivit.

Në vendim subjekti i rivlerësimit ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes me të, të palëve të interesuara me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit Silvana Lule, në cilësinë e prokurores së çështjes.

Dosja 2 – kallëzimi penal nr. *, datë regjistrimi 2.6.2016**, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Kallëzuesi ka kallëzuar se ka harruar telefonin në restorantin ku kishte drekuar dhe kur është kthyer ta marrë nuk e ka gjetur dhe kamarierët i kanë thënë se ndoshta mund ta ketë marrë ndonjë prej klientëve.

Pas administrimit të të gjitha akteve, duke vlerësuar se hetimet janë të plota, subjekti i rivlerësimit ka arritur në përfundimin se në rastin konkret, nuk ka elementë të ndonjë figure të veprës penale, pasi quhen vepër penale ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme, të cilat prekin një objekt të caktuar, marrëdhënie juridike që mbrohet posaçërisht nga ligji penal. Rregullimi ligjor mbi sendet e humbura gjendet në nenin 182 e në vijim të Kodit Civil, sipas të cilit: *“Personi që ka gjetur një send të humbur është i detyruar të njoftojë pronarin ose personin që i ka humbur dhe kur ky nuk njihet ta dorëzojë atë në bashkinë apo komunën në territorin e së cilës është gjetur sendi”*.

Në përfundim, bazuar në nenin 290/1, germa “ç”, e nenit 291, të Kodit të Procedurave Penale ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Nga shkresa nr*** prot., datë 31.8.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se lidhur me këtë kallëzim penal nuk ka asnjë vendim gjyqësor.

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese – argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Nga përmbajtja e tij konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Teksti është i qartë dhe i kuptueshëm. Vendimi përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit. Ka përputhje midis pjesës arsyetuese të vendimit, bazës ligjore të identifikuar dhe dispozitivit.

Në vendim, prokurori ka disponuar edhe për detyrimin e njohjes së palëve të interesuara me të, me qëllim që të ushtrohet e drejta e ankimit në gjykatë. Vendimi mban nënshkrimin e subjektit të rivlerësimit Silvana Lule, në cilësinë e prokurores së çështjes.

Dosja 3 – procedimi penal nr. *, datë regjistrimi 4.10.2013**, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialeve referuar nga policia gjyqësore, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” e kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal.

Në kuadër të hetimeve janë pyetur personat e kallëzuar dhe kallëzuesi i është nënshtruar ekspertimit mjeko-ligjor, nga i cili ka rezultuar se dëmtimet e shtetasit kategorizohen si plagosje e lehtë me dashje. Pasi është administruar akti, në datën 6.3.2014 pranë oficerit të policisë gjyqësore është paraqitur kallëzuesi (i dëmtuari), i cili ka hequr dorë nga e drejta e tij e ankimit.

Subjekti i rivlerësimit, pasi ka vlerësuar se veprimet hetimore ishin të plota, ka konkluduar se neni 284 i Kodit të Procedurave Penale parashikon se për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” të parashikuar nga neni 284 i Kodit Penal, ndjekja penale mund të fillojë vetëm me ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në çdo fazë të procedimit. Në këto kushte, në datën 17.3.2014, subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka përpiluar “Vendimin për pushimin e çështjes”, në mbështetje të nenit 328, pika 1, germa “c”, dhe 329 të Kodit të Procedurës Penale ku ka vendosur:

Vendimi është ndërtuar sipas standardit të akteve të kësaj natyre, i ndarë në pjesën hyrëse, përshkruese – argumentuese dhe përfundon me dispozitivin, për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Nga përmbajtja e tij konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit. Teksti është i qartë dhe i kuptueshëm. Akti përmban dhe mbështetet mbi faktet që kanë dalë gjatë hetimit.

Nga fashikulli i procedimit penal rezulton se vendimi i është njoftuar kallëzuesit me shkresën nr. *** prot., datë 4.4.2014.

Nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim pushimi ka kaluar një kohë prej rreth 5 muajsh. Referuar vendimit të zëvendësimit të prokurorit, subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me drejtimin e hetimeve të procedimit penal në datën 19.11.2013 dhe më 13.12.2013 ka urdhëruar policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore.

Nga shkresa nr***prot., datë 31.8.2020, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se lidhur me këtë kallëzim penal nuk ka asnjë vendim gjyqësor.

Dosja 4 – procedimi penal nr. *, regjistruar në datën 12.11.2013**, për veprën penale “organizim i palejuar i lojrave të fatit”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal

Subjekti i rivlerësimit, në çmim të të dhënave të grumbulluara bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për veprën penale “organizim i palejuar i lojrave të fatit”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal.

Vendimi është përpiluar sipas standardit të akteve të kësaj natyre. Dokumenti është përpiluar sipas kërkesave të nenit 34 të KPRP-së, duke treguar të dhënat e mjaftueshme për marrjen e personit si të pandehur. Vendimi i është njoftuar të pandehurit dhe në akt figuron data e njoftimit, sipas parashikimeve ligjore. Organi procedues ka vënë në dispozicion të mbrojtësit të të pandehurit aktet në ngarkim të tij, dokumentuar me procesverbalin “për njohjen e të pandehurit me aktet”.

Mbështetur në nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti ka marrë vendim për dërgimin e çështjes në gjyq dhe në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit.

Dokumenti ligjor “kërkesë” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi. Ai përmban të dhënat dhe elementët e kërkuar nga Kodi i Procedurës Penale dhe nga përmbajtja e tij konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta, përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm.

Kërkesa sa dhe vërehet është nënshkruar nga i pandehuri në përputhje me pikën 2, të nenit 331, të Kodit të Procedurës Penale.

Nga konkluzionet konstatohet se prokurori i ka kërkuar gjykatës:

- deklarimin fajtor të të pandehurit P. K. për kryerjen e veprës penale ‘organizim i palejuar i lojrave të fatit’, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 210,000 lekë gjobë;
- prova materiale e sekuestruar bazuar në nenin 190/1, germa “a”, e Kodit të Procedurës Penale t’i kalojë në favor shtetit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 14.10.2014, ka disponuar sipas kërkesës së prokurorit.

Sa vërehet, nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim për dërgimin e çështjes për gjykim ka kaluar një kohë e gjatë, 7 muaj. Konstatohet se subjekti i rivlerësimit, pas regjistrimit të procedimit penal, ka urdhëruar policinë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore në një afat të përcaktuar. Nga policia gjyqësore janë kryer veprime verifikuese kryesisht korrespondencë me autoritetet financiare dhe në datën 3.2.2014 në zbatim të urdhrit të prokurorit është vendosur ekspertimi teknik i pajisjeve. Aktekspertimi është realizuar në datën 21.5.2014. Pas administrimit të aktit bazuar në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori ka urdhëruar regjistrimin e emrit të personit, të cilit i atribuohet vepra penale “organizim i palejuar i lojrave të fatit”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal e më tej ka proceduar me marrjen e tij si të pandehur.

Dosja 5 – procedimi penal nr*, regjistruar në datën 6.11.2013, për veprën penale “organizim i palejuar i lojrave të fatit”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal**

Subjekti i rivlerësimit, në çmim të të dhënave të grumbulluara bazuar në nenin 34 të Kodit të Procedurës Penale ka konkluduar në vendimmarrjen “Për marrjen e personit të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për veprën penale “organizim i palejuar i lojrave të fatit”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal. Vendimi “Për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” është përpiluar sipas standardit të akteve të kësaj natyre. Dokumenti është përpiluar sipas kërkesave të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, duke treguar të dhënat e mjaftueshme për marrjen e personit si të pandehur. Vendimi i është njoftuar të pandehurit. Në akt figuron data e

njoftimit, sipas parashikimeve ligjore. Organi procedues ka vënë në dispozicion të mbrojtësit të të pandehurit aktet në ngarkim të tij, dokumentuar me procesverbalin “Për njohjen e të pandehurit me aktet”.

Mbështetur në nenin 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurore Silvana Lule ka marrë vendim për dërgimin e çështjes në gjyq. Në mbështetje të nenit 331 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar kërkesën për gjykimin e çështjes ndaj të pandehurit për akuzën si më lart.

Dokumenti ligjor “kërkesë” është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkruese – arsyetuese dhe dispozitivi. Ai përmban të dhënat dhe elementët e kërkuar nga Kodi i Procedurës Penale dhe nga përmbajtja e tij konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri dhe teksti paraqitet i kuptueshëm.

Kërkesa sa dhe vërehet është nënshkruar nga i pandehuri në përputhje me pikën 2, të nenit 331, të Kodit të Procedurës Penale.

Nga momenti i regjistrimit si procedim penal deri në disponimin me vendim për dërgimin e çështjes për gjykim ka kaluar një kohë prej 11 muajsh. Pas regjistrimit të procedimit penal është urdhëruar policia gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore.

Nga konkluzionet konstatohet se prokurori i ka kërkuar gjykatës:

- deklarimin fajtor të të pandehurit F. D., për kryerjen e veprës penale “organizim i palejuar i lojrave të fatit”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 300,000 lekë gjobë;
- prova materiale e sekuestruar bazuar në nenin 190/1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale t’i kalojë në favor shtetit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2015, ka vendosur:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit F.D., për kryerjen e veprës penale “organizim i palejuar i lojrave të fatit”, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 150,000 lekë gjobë.
- Prova materiale e sekuestruar bazuar në nenin 190/1, germa “a” e Kodit të Procedurave Penale t’i kalojë në favor shtetit.

TË DHËNAT ARKIVORE LIDHUR ME MASA DISIPLINORE, ANKESAT DHE VLERËSIME

1. Sipas të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, për prokuroren Silvana Lule, nuk ka pasur masa disiplinore. Nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cënimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta.

2. Mbi bazën e kërkesës për informacion:

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2020, ka bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit Silvana Lule rezulton të jetë regjistruar një kallëzim penal me nr. ***, viti 2013.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 30.7.2020, ka bërë me dije se ndaj subjektit të rivlerësimit Silvana Lule, prokurore pranë Prokurorisë Tiranë është regjistruar 1 (një) kallëzim penal me nr. ***, viti 2019.

Për të dy këto kallëzime penale është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Këto dy kallëzime dhe vendime të mosfillimit janë trajtuar në pjesën *kontrolli i figurës*.

3. Nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2020, rezulton se ndaj prokurores Silvana Lule nuk ka ankesa të regjistruara.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara rezulton se prokurore Silvana Lule shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. Identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Kështu, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit, përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Në vlerësimin e punës së subjektit të rivlerësimit për vitet 2012, 2015 dhe 2016 të bërë nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se për aftësitë profesionale në cilësinë e prokurorit është vlerësuar “shumë mirë”.

b) Arsyetimi ligjor

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej saj të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme, në respektim të rregullave drejtshkimore dhe etike. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se prej saj bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e saj logjik mbi zgjidhjen ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka ushtruar detyrën e saj funksionale në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (periudha tetor 2015 – shkurt 2016). Nga të dhënat statistikore rezulton se në periudhën e rivlerësimit subjekti ka trajtuar gjithsej 1027 çështje. Ky fakt konfirmohet nga statistikat evidentuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 22.1.2020, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka ushtruar kompetencat që ligji i njeh prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Prokurori ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikat 2 dhe 2.1 të Urdhrit nr. ***, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë.

Subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka ushtruar ndjekje penale në një sërë materialesh hetimore. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, të cilat vendosin detyrimin për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori subjekt rivlerësimi ka përballuar ngarkesën e punës.

Konkretisht kohëzgjatja e trajtimit të praktikave që i korrespondon dosjeve 1, 2, 3, 4 dhe 5 ka qenë respektivisht:

Dosja nr. 1 – materiali kallëzues nr. ***, regjistruar si kallëzim në datën 8.6.2016 dhe mosfilluar në datën 28.6.2016, kohëzgjatja 20 ditë.

Dosja nr. 2 – materiali kallëzues nr. ***, regjistruar si kallëzim në datën 2.6.2016 dhe mosfilluar në datën 30.6.2016, kohëzgjatja 28 ditë.

Dosja nr. 3 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 4.10.2013, pushuar në datën 17.3.2014, kohëzgjatja 5 muaj e 13 ditë.

Dosja nr. 4 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 4.11.2013, dërguar për gjykim në datën 22.10.2014, kohëzgjatja 11 muaj e 17 ditë.

Dosja nr. 5 – procedimi penal nr. ***, regjistruar në datën 12.11.2013, dërguar për gjykim në datën 9.6.2014, kohëzgjatja 6 muaj e 26 ditë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurore Silvana Lule, merr pjesë në gjykim si palë, duke përfaqësuar prokurorinë ku ushtron detyrën dhe konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe disponimin e gjykatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Silvana Lule dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e rëna në short, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit prokurore Silvana Lule. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të

dokumentuar. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rena në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit Silvana Lule për vitet 2012, 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm rezulton se është vlerësuar “shumë mirë. Bazuar në të gjitha burimet e informacioneve të këtij raporti nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t’u angazhuar, subjekti Silvana Lule rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër.

RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Komisioni, me qëllim vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si edhe të dhënat nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Pas verifikimit të raportit, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

DENONCIMET

Ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar në Komision 10 denoncime. Pasi shqyrtoi secilin prej tyre, trupi gjykues administroi dosjet penale, shqyrtoi dhe analizoi me objektivitet dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit dhe pas dërgimit të rezultateve të hetimit në lidhje me këto denoncime.

1. Denoncimi nr. * prot., datë 6.2.2020, të av. J. K.**

Denoncuesja është avokate dhe shpjegon se pas ndërhyrjes për të mbrojtur klientin e saj të moshuar, i cili u sulmua nga fqinji i tij më 26.7.2019, ky i fundit e ka rrahur atë (avokaten) dhe e ka kërcënuar me jetë për shkak të detyrës. Pas denoncimit, çështja ka kaluar në prokurori dhe denoncuesja pretendon se prokurorja e ka keqtrajtuar dhe i ka bërë presion në zyrën e saj duke i kërkuar që të heqë dorë nga kjo çështje, me pretendimin se nuk është goditur për shkak të detyrës, por kërkon të fitojë kohë për çështjen penale të klientit të saj. Në vijim, denoncuesja pretendon se prokurorja nuk ka bërë asnjë hetim paraprak, duke e favorizuar kriminelin dhe se në datën 13.9.2019 vendosi mosfillimin e procedimit penal. Gjithashtu, pretendon se nuk i është vënë në dispozicion vendimi i mosfillimit të procedimit dhe dosja, pavarësisht shkresave të njëpasnjëshme të paraqitura në prokurori deri në fund të dhjetorit të vitit 2019.

Denoncuesja shpjegon se nuk e ka ankimuar vendimin sepse do ta kalojë pranë organeve juridike ndërkombëtare, si rast konkret të shpërdorimit të ligjit.

2. Denoncimi nr*prot., datë 6.2.2020, nga shtetasi B. H. P.**

Ky denoncim është i lidhur me denoncimin e sipërpërmendur të paraqitur nga av. J.K. . Denoncuesi B.H.P. shpjegon se është klienti i avokates J. K. dhe denoncon të njëjtin rast. Ai pretendon se prokurorja Sivana Lule ka shpërdoruar detyrën dhe është bërë palë me personin që ka dëmtuar atë (denoncuesin) dhe avokaten. Pretendon se megjithëse ka qenë në kushtet e veprës penale “plagosje e rëndë”, prokurorja më 13.9.2019 ka marrë vendim për mosfillim të procedimit penal dhe se ky vendim nuk i është vënë në dispozicion deri në datën 25.12.2019, edhe pas shumë shkresave të bëra nga avokatja.

Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit vendimin për mosfillimin e procedimit penal, në të cilin prokurorja ka arsyetuar mosfillimin e procedimit penal. Në pikën 2 të dispozitivit të vendimit, është disponuar: *“Të njoftoj me këtë vendim ata që kanë bërë kallëzim, të cilët me marrjen dijeni kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit”*.

Në lidhje me këto dy denoncime

Për të vlerësuar në lidhje me këto denoncime që kanë të bëjnë me të njëjtin fakt, Komisioni kërkoi¹⁴⁰ nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë kopje të njëjësuar me origjinalin të dosjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal për kallëzimin penal me viktimitë këta dy shtetas, si dhe i kërkoi informacion në lidhje me njoftimet e viktimitave dhe nëse viktimitat kishin bërë ankim ndaj vendimit të mosfillimit.

Prokuroria në fjalë, vendosi në dispozicion¹⁴¹ një kopje të fashikullit të mosfillimit penal nr. ***, të vitit 2019, me viktimitë shtetasit J.K. dhe B.P., i cili është mosfilluar në datën 13.9.2019, të njëjësuar me origjinalin. Gjithashtu informoi se ndaj vendimit të mosfillimit nuk ka pasur ankime.

a. Në lidhje me pretendimin që prokurorja nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore

Në fashikullin në fjalë janë administruar një sërë aktesh/dokumentesh, si dhe aktekspertimet mjeko-ligjore sipas të cilëve *“tek shtetasi B. P. nuk u konstatuan dëmtime trupore”* dhe se *“dëmtimet e shkaktuara shtetases J. K., nuk shkaktajnë dëmtime që japin humbje të aftësisë për punë”*.

Subjekti, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *“Pavarësisht faktit se dëmtimet e shkaktuara J.K. nuk kanë sjellë humbje të aftësisë për punë, në kuptim të nenit 90 të Kodit Penal, ato përbëjnë veprë dhune. Sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale ‘Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet ...90 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Për sa më sipër, evidentohet një rrethanë e cila nuk lejon fillimin e procedimit penal dhe që është se kallëzuesi/i dëmtuari duhet t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për ushtrimin e ndjekjes penale në lidhje me këto vepra dhe se këto të fundit nuk ndiqen kryesisht apo me ankim nga prokuroria”*.

Për sa më lart, në datën 13.9.2019 prokurorja ka vendosur *“mosfillimin e procedimit penal, për shkak se viktima akuzuese/i dëmtuari duhet t’i drejtohet gjykatës me kërkesë për ushtrimin e ndjekjes penale në lidhje me këto vepra”*.

¹⁴⁰Me shkresën nr. ***prot., datë 1.7.2021.

¹⁴¹Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 28.7.2021).

Rezultoi se prokurorja ka kryer veprimet e nevojshme hetimore dhe në marrjen e vendimit është mbështetur, ndër të tjera, në konkluzionin e Institutit të Mjekësisë Ligjore.

b. Në lidhje me pretendimin e denoncuesve se nuk janë njohur me vendimin e mosfillimit të procedimit penal deri në dhjetor të vitit 2019

Pjesë e dosjes së vënë në dispozicion janë shkresat nr. *** prot., (S.L), datë 2.10.2019 të Prokurorisë, drejtuar z. B. P., me lëndë “dërgohet njoftimi për vendimin e mosfillimit”, si dhe shkresa me të njëjtin numër, datë dhe lëndë, drejtuar shtetases J.K., por nuk ka akt që konfirmon marrjen dijani nga ana e tyre për këto shkresa.

Materialet procedurale janë regjistruar në Prokurorinë Tiranë në datën 8.8.2019. Vendimi i mosfillimit është marrë në datën 13.9.2019, pra jashtë afatit ligjor 15-ditor të përcaktuar nga neni 291 i Kodit të Procedurës Penale.

Vendimi në fjalë i njofton ata për të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 10 ditëve nga njoftimi i vendimit, sipas përcaktimit ligjor të sipërcituar, ndërsa në lidhje me njoftimin e vendimit kallëzuesit, bazuar në nenin 27 pika 1.1, germa “e”, të Rregullores Standard të Organizimit dhe Funkcionimit të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm¹⁴², dërgimi me postë i njoftimeve të vendimeve të mosfillimit, pushimit, etj., është detyrë e kryesekretarit të prokurorisë dhe jo e prokurorit.

Gjithashtu, me këtë shkresë, nga Prokuroria në fjalë bëhet me dije se ndaj vendimit të mosfillimit nuk ka pasur ankime, fakt që e ka sqaruar edhe denoncuesja J. K. në denoncimin e saj.

Pas marrjes dijani për pushimin e çështjes, kallëzuesi gëzonte të gjitha të drejtat e njohura me ligj që të ankimonte vendimin e mosfillimit, të drejtë që nuk e ka ushtruar. Bazueshmëria në prova dhe në ligj e vendimit të prokurorit mund t’i nënshtrohet vetëm kontrollit gjyqësor.

Nga sa më lart, Komisioni vlerësoi se:

- në dosjen e prokurorisë ndodhet shkresa për njoftimin e vendimit të mosfillimit;
- dërgimi me postë i njoftimeve të mosfillimit, etj., nuk është detyrë e prokurorit, por e kryesekretarit;
- denoncuesit nuk kanë bërë ankim ndaj këtij vendimi;
- vendimi i mosfillimit është marrë jashtë afatit ligjor 15-ditor.

Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime, e cila paraqiti shpjegimet si vijojnë:

*“Në lidhje me kallëzimin nr. ***, datë 8.8.2019, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë konstatoi se kallëzimi është regjistruar në institucion në gusht të vitit 2019, muaj i cili sipas nenit 23, të ligjit nr. 96/2016, datë 6.10.2016, ‘Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’, përgjithësisht është muaji i lejes së zakonshme.*

Këtë vit, në gusht kam qenë me leje të zakonshme, kallëzimi është tërhequr nga sekretaria në fillim të muajit shtator dhe duke qenë se kanë qenë të administruara edhe përgjigjet e aktit të ekspertimit mjeko-ligjor për të dy të dëmtuarit, kam vendosur mosfillimin e procedimit penal, brenda afatit të parashikuar nga neni 291/1 i Kodit Penal.

Nisur nga pretendimet e kallëzueses në denoncim, sipas të cilave është trajtuar keq në zyrën time dhe se nuk i jam përgjigjur kërkesave të saj, kërkoj të sqaroj Komisionin se:

¹⁴²Miratuar me urdhrin nr. ***, datë 18.12.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Së pari, nuk ka pasur asnjë kërkesë në Prokurori të depozituar prej saj, jam telefonuar¹⁴³ nga kallëzuesja jashtë orarit zyrtar dhe se takimi në zyrë me të ka ndodhur pas datës 25.9.2019, datë në të cilën vendimi ishte marrë.

Së dyti, në këtë takim (por as në kallëzimin e administruar në dosje), ajo nuk ka pretenduar se ishte mbrojtësja e personit të dëmtuar, por ka pretenduar se ishte avokatja e një prej grupeve kriminale që në atë kohë gjykohehin në Gjykatën e Krimeve të Rënda”.

Pasi analizoi dokumentacionin e dosjes, si dhe shpjegimet e subjektit, trupi gjykues vlerësoi se shpjegimet janë bindëse.

3. Denoncimi nr. * prot., datë 26.6.2019, nga shtetasi D. P.**

Denoncuesi ka bërë denoncim për prokuroren me arsyetimin se nuk ka marrë asnjë njoftim me postë për procedimin penal edhe pse çështja është në gjykatë, se nuk është pajisur me aktet dhe provat e gjykimit dhe se nga pyetja në gjykatë i është thënë se çështja është në themel dhe jo paraprake.

Për të vlerësuar saktë denoncimin e paraqitur, Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴⁴, duke i kërkuar informacion nëse viktimi është njoftuar për përfundimin e hetimeve të procedimit penal të iniciuar sipas kallëzimit të tij, si dhe një kopje të akteve përkatëse të njoftimeve të bëra ndaj këtij shtetasi.

Prokuroria informoi Komisionin se çështja ishte në fazë gjykimi dhe vendosi në dispozicion një kopje të njoftimit për përfundimin e hetimeve, të njësuar me origjinalin. Këtë njoftim e kishte bashkëlidhur me denoncimin edhe denoncuesi, i cili pretendon se nuk ka marrë njoftim. Rezultoi se materialet për veprën penale të parashikuar nga neni 199/a/2 i Kodit Penal i janë referuar Prokurorisë në datën 12.3.2019, ndërsa njoftimi për përfundimin e hetimeve ka datën 28.5.2019, pra, është brenda afatit 3-mujor të hetimeve paraprake, të përcaktuar nga neni 323 i Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me datën kur ka marrë dijëni denoncuesi (kallëzuesi në këtë procedim), ky informacion nuk u vendos në dispozicion nga prokuroria, por bazuar në nenin 27, pika 1.1, germa “e”, e Rregullores Standard të Organizimit dhe Funkcionimit të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm¹⁴⁵, dërgimi me postë i njoftimeve të vendimeve të mosfillimit, pushimit, kërkesave për gjykim, etj., është detyrë e kryesekretarit të prokurorisë dhe jo e prokurorit.

Për sa më lart, nuk u evidentuan shkelje të afateve ligjore procedurale të kryera nga subjekti. Në lidhje me dërgimin e njoftimit denoncuesit (kallëzuesit), dërgimi me postë i njoftimeve është detyrë e kryesekretarit të prokurorisë dhe jo e prokurorit.

4. Denoncimi nr. *prot., datë 24.11.2017, nga shtetasi S. Z.**

Denoncuesi pretendon se prokurorja ka shkelur ligjin pasi ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin e bërë nga denoncuesi për veprën penale “mashttrim”.

Denoncuesi S.Z. ka lidhur dy aktmarrëveshje me personin që pretendon se e ka mashtruar, me anë të të cilave denoncuesi i ka dhënë palës tjetër (marrësit) shuma parash dhe për vlerat e marra marrësi do të paguante në fillim të çdo muaji interesin e përcaktuar në marrëveshje. Fillimisht,

¹⁴³Kopje e komunikimit me mesazh me znj. J. K. .

¹⁴⁴Me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2021.

¹⁴⁵Miraturar me urdhrin nr. ***, datë 18.12.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.

marrësi i ka paguar rregullisht vlerat e përcaktuara, por më pas nuk është përgjigjur më as për kthimin e interesave dhe as për kthimin e vlerës së marrë. Denoncuesi ka bërë kallëzim penal për veprën penale “mashttrim”, të përcaktuar në nenin 143 të Kodit Penal. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, prokurorja ka konstatuar se fakti i paraqitur në kallëzimin penal nuk ka elementë të figurës së veprës penale “mashttrim” dhe as elementë të ndonjë figure tjetër të veprës penale, pasi fakti i kallëzuar bën fjalë për një marrëdhënie juridike-civile në trajtën e kontratës dhe pasojat e mospërmbyshjes së detyrimit që rrjedh nga kontrata, rregullohet nga dispozitat e Kodit Civil.

Në përfundim, prokurorja ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal për shkak se fakti i konstatuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”*.

Komisioni vlerësoi se ky denoncim nuk ka të bëjë me elementë proceduralë, por me vlerësimin ligjor të çështjes nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, në këtë kuptim, vlerëson se bazuar në pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes.

5. Denoncimi nr. * prot., datë 30.8.2019, nga shtetasi F. O.**

Denoncuesi ka depozituar këtë denoncim për disa subjekte, një ndër të cilët është edhe prokurorja Silvana Lule, duke ngritur pretendimin se kallëzimet e tij penale pushohen dhe mbyllen si çështje nga ana e prokurorëve pa asnjë bazë ligjore. Ai ka shpjeguar se ka bërë shumë herë kallëzime penale për fakte të ndryshme dhe i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me ankesë, e cila i është deleguar subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka arsyetuar se *“kallëzuesi secilën prej kërkesave të referuara në ankimet e mësipërme e ka paraqitur si kallëzim penal dhe për secilin prej tyre është marrë vendim nga prokurorët e caktuar”*. Për këto arsye, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale.

Komisioni iu drejtua Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴⁶ duke i kërkuar dosjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe informacion nëse ndaj vendimit të mosfillimit është bërë ankim. Nga dosja rezultoi se për secilin prej pretendimeve denoncuesi ka paraqitur kallëzime, për të cilat prokuroria ka disponuar me vendim. Prokuroria informoi se ndaj vendimit të mosfillimit nuk ka pasur ankim.

Nga sa më lart, trupi gjykues vlerësoi se denoncimi nuk ka të bëjë me elementë proceduralë të çështjes së ndjekur nga ana e prokurorës, por me vlerësimin ligjor të çështjes prej saj, e cila ka vlerësuar se meqenëse për secilën prej kërkesave të paraqitura nga kallëzuesi ai ka bërë kallëzim më vete dhe për secilin prej tyre është marrë vendim nga prokurorët e caktuar, nuk kishte vend për të vijuar me procedimin.

Gjithashtu, ndaj vendimit të mosfillimit nuk ka pasur ankime, çka do të thotë që denoncuesi nuk e ka ushtruar të drejtën e tij ligjore për të bërë ankim ndaj këtij vendimi.

6. Denoncimi nr. * prot., datë 12.7.2019¹⁴⁷**

Në fletën e parë të formularit të denoncimit, ky denoncues përmend disa subjekte, ndër të cilët është edhe subjekti i rivlerësimit, por në brendinë e këtij denoncimi nuk ka asnjë pretendim në lidhje me këtë prokurorë. Nuk e përmend subjektin në asnjë prej parashtrimeve të tij dhe asnjë prej dokumenteve të bashkëlidhura nuk ka lidhje me këtë subjekt.

¹⁴⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 1.7.2021.

¹⁴⁷ Denoncuesi ka kërkuar të mbetet anonim.

7. Denoncimi nr. * prot., datë 18.5.2018, nga shtetasi F. A.**

Denoncuesi ka pasur konflikte pronësie me fëmijët e dajës së tij V.S., pasi pretendon se duhet të ishte bashkëpronar mbi një pasuri të fituar prj tyre si trashëgimtarë, meqenëse edhe ai është trashëgimtar i gjyshit, njëlloj si ata. Kushërinjtë e kanë fituar pronësinë me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë të vitit 2010¹⁴⁸. Denoncuesi ka kërkuar në gjykatë njohjen e tij pronar mbi këtë pasuri dhe në vitin 2012¹⁴⁹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur detyrimin e të paditurve (trashëgimtarëve S.) të njohin pronar ndër të tjerë F. A. (paditësin) në sipërfaqen e tokës. Me vendim të formës së prerë është vendosur rrëzimi i padisë¹⁵⁰.

Nga ky vendim (nr. ***, datë 30.4.2012) rezulton se avokat i njërit prej të paditurve ka qenë z. G. H., vëllai i bashkëjetuesit të subjektit.

Në shtator të vitit 2012, z. F. A. ka bërë kallëzim penal për vjedhje pronash dhe manipulim të dëshmisë së trashëgimisë duke shmangur me prova false nënën e tij, për të cilin prokurorja ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

Denoncuesi ka paraqitur ankim në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 19.2.2014 e ka sqaruar atë se zgjidhja e kërkesave të tij me objekt mosmarrjen parasysh nga gjykata të kërkesave të tij gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore civile, ku është palë nuk është objekt i punës së prokurorisë. Gjithashtu, e ka orientuar që të ankohet në gjykatën më të lartë ose në Këshillin e Lartë të Drejtësisë.

Z. F.A. ka paraqitur denoncimin në Komision, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të veprës penale dhe ka vendosur pushimin e çështjes në kundërshtim me ligjin.

Komisioni administroi dosjen e vendimit të mosfillimit¹⁵¹, vendim ndaj të cilit, sipas shpjegimit të prokurorisë, nuk është bërë ankim. Nga dosja, pjesë e së cilës janë edhe vendimet civile të gjykatave në lidhje me konfliktin e pronësisë, rezultoi se:

Vëllezërit A. (një prej të cilëve është denoncuesi) në datën 5.9.2012 i kanë dërguar shkresë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilën kanë ngritur pretendimin se kushërinjtë e tyre iu kanë vjedhur pronat dhe kanë manipuluar dëshminë e trashëgimisë, duke parashtruar edhe se në këto toka të përfituara nga kushërinjtë e tyre kanë blerë edhe avokatët 2.5 ha ... Në datën datën 26.9.2012, OPGj-ja pranë Prokurorisë Vlorë ka mbajtur procesverbalin për kallëzimin e veprës penale, ku kallëzuesi ka kallëzuar se kushërinjtë tij i kanë marrë pronat duke shmangur me prova false nënën e tij nga trangu familjar. Nga Rregjistri i Mosfillimit të Çështjeve Penale rezulton se çështja është regjistruar në datën 5.9.2012, sipas nenit 186 “Falsifikimi i dokumenteve”. Në datën 1.10.2012 subjekti ka vendosur: *“Mosfillimin e procedimit penal për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale”*. Në vendim ajo ka përcaktuar se kallëzimi penal bën fjalë për veprën penale “shpërdorim i detyrës” dhe ka arsyetuar se: *“Duke vlerësuar pretendimet dhe provat e paraqitura konstatohet se në rastin konkret nuk evidentohen elementë të ndonjë figure të veprës penale, aq më tepër nuk pretendohen dokumente konkrete të falsifikuara nga ana e kallëzuesve, por ndodhemi përpara një konflikti me natyrë civile dhe palët duhet t’i drejtohen*

¹⁴⁸Vendim nr. ***, datë 27.9.2010. Para këtij vendimi, ka pasur dhe vendim tjetër nr. ***, datë 10.5.2002.

¹⁴⁹Vendimi nr. ***, datë 30.4.2012.

¹⁵⁰Vendimi nr. ***, datë 30.4.2012, është prishur nga Gjykata e Apelit, e cila me vendimin nr. ***, datë 12.12.2013 ka vendosur prishjen e këtij vendimi dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues. Kjo çështje është rigjykuar dhe me vendimin nr. ***, datë 10.3.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur rrëzimin e padisë së paditësve, një ndër të cilët është F.A. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin e saj nr. ***, datë 14.6.2018.

¹⁵¹Shkresa nr. *** prot., datë 1.7.2021, e Komisionit dhe shkresa nr. *** prot., datë 27.7.2021, e Prokurorisë Vlorë (administruar në Komisionit me nr. *** prot., datë 30.7.2021).

gjykatës me padinë përkatëse, si edhe kanë vepruar. Për sa më sipër, evidentohet një rrethanë e cila nuk lejon fillimin e procedimit penal dhe që është se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale”. Pra, pavarësisht se kallëzuesi ka bërë kallëzim për manipulim të dëshmisë së trashëgimisë dhe për falsifikim provash me të cilat është shmangur nga trangu familjar nëna e tij, subjekti ka disponuar në vendim se nga ana e kallëzuesve nuk janë pretenduar dokumente konkrete të falsifikuara dhe ka vlerësuar se vepra penale për të cilën është regjistruar kallëzimi penal është vepra e parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “shpërdorim detyrë”.

Nuk rezultoi që në dosje të jenë administruar prova që lidhen me falsifikimin ose jo të dokumentit të pretenduar nga kallëzuesi dhe nuk ka asnjë arsyetim në lidhje me akuzën për falsifikim, por pjesë e dosjes penale janë kallëzimi penal, vendimet civile të gjykatave në lidhje me konfliktin e pronësisë dhe akte që kanë shërbyer për marrjen e këtyre vendimeve.

Gjithashtu, sikurse u tha më lart, rezultoi se avokat i njërit prej të paditurve në këtë konflikt civil nga i cili ka derivuar kallëzimi penal i mosfilluar, ka qenë vëllai i bashkëjetuesit të subjektit, z. G.H. . Vendimi i mosfillimit është marrë në datën 1.10.2012, ndërsa subjekti ka deklaruar se bashkëjetuesën me z. F. H. (vëllai i avokatit në fjalë) e ka filluar në tetor të vitit 2013. Ndërkohë, në pyetësin nr. 1 subjekti ka deklaruar se më 24.10.2012 (pra tri javë pas vendimit të mosfillimit) ka udhëtuar drejt Italisë për të takuar vëllain e saj, ka qendruar në banesën ku jetonte vëllai i saj dhe gjatë këtij udhëtimi ka qenë e shoqëruar nga shtetasi F. H. .

Ky fakt ngriti para Komisionit dyshime se në kohën e marrjes së vendimit në fjalë, datë 1.10.2012, subjekti ka pasur njohje me z. F.H., përderisa tri javë më pas nën shoqërinë e tij ka shkuar në Itali për të takuar vëllain, prandaj u ngritën dyshime se subjekti ka hetuar këtë çështje në kushtet e konfliktit të interesit.

Rezultoi¹⁵² se gjatë viteve 2013 - 2014 janë kryer veprime juridike për pasuri të paluajtshme nga vëllezërit e bashkëjetuesit të subjektit, G. dhe E. H., me bashkëpronarët S. (dhe disa të tjerë), të cilët kanë qenë palë e paditur në proceset gjyqësore të sipërpërmendura, ku njëri nga bashkëpronarët (Th.S.) si i paditur ka pasur përfaqësues av. G. H. .

Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime të shoqëruara me dokumentacionin përkatës¹⁵³. Në përgjigje, subjekti sqaroi se më 30.10.2013, është lidhur kontratë shitje pasurie mes palëve M.Xh., Th.S., Ll. S., F. B., etj. (në cilësinë e shitësve). Në këtë kontratë, shtetasi G.H. ka pasur cilësinë e blerësit, ndërsa vëllai tjetër, E. H., ka qenë përfaqësues me prokurë i njërit prej shitësve. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se sipas shpjegimeve të z. G. H., pjesa e tij takuese e çmimit të përcaktuar në kontratë, nuk është paguar, për shkak se ai ka qenë dhe është avokat i kësaj familjeje, në një seri procesesh civile, në lidhje me disa nga pronat e tyre. Ai nuk është paguar në të holla në lidhje me përfaqësimin dhe kanë nënshkruar këtë kontratë që përfaqëson shpërblimin e tij për punën e bërë dhe se kontrata është parë e arsyeshme nga palët të lidhet në këtë formë, për shkak të procedurave të regjistrimit. Subjekti i shoqëroi shpjegimet me dokumentacion¹⁵⁴.

Me pyetësin nr. 6, Komisioni pyeti subjektin nëse kjo pronë ka qenë apo është sot objekt i proceseve gjyqësore civile apo penale.

¹⁵²Shkresa nr. *** prot., datë 23.9.2021 (administruar në Komision me nr*** prot., datë 29.9.2021).

¹⁵³Pyetësi nr. 5.

¹⁵⁴Bashkëlidhur ka dërguar kontratën e shitblerjes të sipërpërmendur (kontrata nr. ***, datë 30.10.2013, notere M. Gj.), prokurën e lëshuar për përfaqësim nga z. G. H., si dhe disa vendime gjyqësore, ndër të cilët është vendimi nr. ***, datë 30.4.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ishte pjesë e dokumentacionit të prokurorisë, për kallëzimin e sipërpërmendur të mosfilluar nga subjekti.

Në përgjigje, subjekti deklaroi: *“Personalisht, nuk kam dijeni nëse kjo pronë ka qenë apo është objekt i proceseve penale apo civile, pasur parasysh se nuk kam pasur dijeni edhe për ekzistencën e saj. Z. G. H. shpjegon se ka pasur çështje civile në lidhje me të (sipas vendimeve të gjykatës, dorëzuar Komisionit në pyetësorin paraardhës¹⁵⁵) dhe nuk ka dijeni nëse ka pasur apo ka çështje penale. Ai më ka shpjeguar se nuk ka qenë palë/përfaqësues ligjor i palës, kallëzuesit apo të kallëzuarit, në ndonjë çështje penale, me objekt këtë pronë”.*

Po me pyetësorin nr. 6, Komisioni bëri me dije subjektin se ka rezultuar që prej saj është hetuar kallëzimi penal nr***, datë 26.9.2012, i bërë nga shtetasi F. A., i cili pretendon se duhet të ishte bashkëpronar me kushërinjtë e tij (shtetasit Th., A., B., Ll. dhe J.S.) mbi një pasuri të fituar nga këta të fundit dhe ka pyetur subjektin nëse prona objekt hetimi është e njëjtë me atë të përfituar nga shtetasi G.H. .

Në lidhje me këtë pyetje, subjekti sqaroi se: *“Nga ana ime pas mbërritjes së pyetësorit kam kërkuar një kopje të vendimit që i përket kallëzimit penal nr. ***, datë 26.9.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në lidhje me këtë çështje konstatoj se objekt hetimi nuk ka qenë prona, dokumentet e origjinës së saj etj., por është vlerësuar pretendimi i kallëzuesit në lidhje me të drejtën e tij të trashëgimisë, pretendim ky tërësisht me natyrë civile. Po ashtu, në kallëzim nuk ka të dhëna në lidhje me pronën dhe unë nuk kam dijeni nëse bëhet fjalë për të njëjtën pasuri. Z. G. H. më ka shpjeguar se palët kanë pretendime për disa pasuri të paluajtshme në këtë zonë”.*

Komisioni e pyeti subjektin¹⁵⁶ nëse prona ishte regjistruar në emër të z. G.H. dhe, në përgjigje, subjekti sqaroi se: *“Sipas shpjegimeve të marra nga z. G. H., kjo pronë është regjistruar në emër të tij, por nuk ka certifikatë pronësie, për shkak se bëhet fjalë për një zonë të pamenaxhuar, e cila nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar sistematik. Aktualisht, nuk ka një certifikatë pronësie në emër të z. G. H.”.*

E pyetur nga Komisioni¹⁵⁷ se cila është gjendja faktike e kësaj prone, a ka sot ndërtime të zhvilluara në të, subjekti sqaroi se sipas shpjegimeve të z. G. H., aktualisht nuk ka ndërtime të zhvilluara në të dhe se është lidhur një kontratë sipërmarrjeje, që synon ta zhvillojë atë.

7.1 Në përfundim, trupi gjykues i dërgoi subjektit barrën e provës se:

7.2 Ngrihen dyshime se në kohën e marrjes së vendimit të mosfillimit të procedimit penal, datë 1.10.2012, subjekti ka pasur njohje me z. F.H., përderisa tri javë më pas nën shoqërinë e tij ka shkuar në Itali për të takuar vëllain, prandaj ngrihen dyshime se subjekti ka hetuar këtë çështje në kushtet e konfliktit të interesit.

7.3 U evidentuan kontrata shitblerjeje pasurish të paluajtshme, të lidhura para dhe pas vendimit të mosfillimit, midis shtetasit G.H., vëllai i bashkëjetuesit dhe bashkëpronarëve S., të kallëzuar në kallëzimin penal për të cilin subjekti ka vendosur mosfillimin.

7.4 Përfaqësues i njërit prej shitësve ka qenë vëllai tjetër i bashkëjetuesit të subjektit, z. E.H. .

7.5 Sipas deklarimit të subjektit, z. G. H., si blerës nuk e ka paguar çmimin e përcaktuar në kontratën e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, të lidhur pas vendimit të mosfillimit dhe kjo kontratë përfaqëson shpërblimin e tij për punën e bërë si avokat.

¹⁵⁵Njëri prej këtyre vendimeve të depozituara nga subjekti, është edhe vendimi i sipërpërmendur, pjesë e dosjes së prokurorisë.

¹⁵⁶Pyetësori nr. 6.

¹⁵⁷Pyetësori nr. 6.

7.6 Prona objekt i vendimeve të gjykatës për konfliktin civil ku avokat i të paditurit ka qenë z. G. H., është e njëjtë me pronën për të cilën kallëzuesi (paditësi në procesin civil) ka pretenduar falsifikim të provave për dëshminë e trashëgimisë, duke e manipuluar atë. Ky vendim në të cilin është pasqyruar që z. G. H. është avokat i njërit prej të paditurve, është pjesë e dokumentacionit të dosjes së mosfillimit të kallëzimit penal, të vendosur në dispozicion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

7.7 Pavarësisht se kallëzimi penal ishte për manipulim të dëshmisë së trashëgimisë nëpërmjet provave false, subjekti nuk ka kryer asnjë hetim në lidhje me falsifikimin dhe ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, me arsyetimin se nuk pretendohen dokumente konkrete të falsifikuara dhe se ndodhet para një konflikti me natyrë civile, që palët duhet ta zgjidhin gjyqësisht.

7.8 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me sa më lart.

Qëndrimi i subjektit

7.9 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti në Komision prapësimet si vijojnë:

7.10 Në lidhje me gjetjen e parë

“Në lidhje me gjetjen e parë, më duhet të vë në vëmendjen tuaj faktin se në kohën e marrjes së vendimit nga ana ime, datë 1.10.2012, unë nuk kam pasur asnjë marrëdhënie me z. G.H. (marrëdhënie të cilat, sipas nenit 5, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave, në ushtrimin e funksioneve publike’, tregojnë se nga mund të burojnë interesat private të zyrtarit). Dua të them se jo vetëm që nuk kam pasur marrëdhënie familjare/bashkëjetese, por në atë periudhë kohe, as nuk e kam njohur personalisht z. G. H. . Në muajin tetor 2012 unë sapo kisha filluar ta njoh z. F.H., ai ka qenë një udhëtim shoqëror (kujtoj se kanë qenë edhe shtetasit E.B., G. C.), kam pasur për qëllim të takoj vllain tim në këtë shtet dhe në datën 1.10.2012 as nuk kisha mundësi objektive, të kisha dijeni në lidhje me interesat apo marrëveshjet që kishte apo mund të kishte në të ardhmen vëllai i z. F. H., të cilin sikurse sqarova më sipër, në atë kohë unë nuk e njihja. Në lidhje me këtë situatë, deri në momentin që jam pyetur prej Komisionit, as unë dhe as vëllai i bashkëjetuesit nuk kemi qenë në dijeni. Këtu duhen mbajtur në konsideratë dy fakte: 1. Vendimi i mosfillimit nuk u njoftohet palëve të kallëzuara, por vetëm kallëzuesit, për pasojë personat e përfaqësuar nga ana e z. G.H. gjatë proceseve civile, nuk janë njoftuar në lidhje me vendimin e mosfillimit të datës 1.10.2012 dhe 2. Unë nuk kam pasur dhe nuk kam dijeni në lidhje me veprimtarinë apo punën e z. G. H. . Vetëm pasi më është kërkuar nga ana e Komisionit, unë kam kërkuar informacion nga z. G. H., për sa isha pyetur nga Komisioni. Vendimet e gjykatës, prokurat, kontratat që i kam dërguar Komisionit, më janë vënë në dispozicion prej tij, i cili ka qenë tërësisht bashkëpunues në këtë proces.

Z. G. H. ka qenë avokat vetëm në çështje civile/administrative dhe në asnjë rast nuk më ka lindur nevoja të vlerësoj heqjen dorë nga hetimi/konflikti i interesit.

*Pavarësisht sa më sipër, sikurse kam sqaruar edhe më herët, vetëm pasi jam pyetur nga Komisioni kam administruar një kopje të vendimit që i përket kallëzimit penal nr***, datë 26.9.2021, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe kam shpjeguar se objekt verifikimi nuk ka qenë prona, dokumentet e origjinës së saj etj., por është vlerësuar pretendimi i kallëzuesit në lidhje me të drejtën e tij të trashëgimisë, pretendim ky tërësisht me natyrë civile. Sa më sipër, kërkoj të theksoj se jo vetëm që nga ana ime nuk është konstatuar se përfaqësuesi i njërit prej*

*palëve të paditura të cituara në vendimin nr***, datë 30.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ka qenë shtetasi G.H., por edhe nëse një gjë e tillë do të ishte konstatuar nga ana ime, sigurisht që nuk do ta gjeja veten në kushtet e konfliktit të interesit, pasi unë personalisht nuk e njihja z. G.H. .*

G.H. nuk ka qenë avokat i palës së kallëzuar në çështjen penale, ai nuk ka pasur asnjë pozitë procedurale në këtë çështje. Gjatë procesit të verifikimit të materialit kallëzues nuk janë kryer veprime hetimore procedurale me të kallëzuarit, z. G. H. nuk është paraqitur ndonjëherë si mbrojtës apo përfaqësues ligjor i tyre apo të ketë bërë ndonjë kërkesë. Ai më ka shpjeguar se për këta persona ka prokurë, vetëm për çështjet civile dhe kurdoherë ka ndjekur vetëm këto të fundit. Në lidhje me konfliktin e interesit të pretenduar për ankesën e shtetasit F. A., ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, 'Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike', në nenin 5/1 germa 'dh' pika 'i' parashikon marrëdhënien e bashkëjetesës si marrëdhënie nga e cila mund të burojnë interesa private. Sipas nenit 24 të të njëjtit ligj, 'Kufizimi i interesave të personave të lidhur me zyrtarin', përcaktohet rrethi i personave të lidhur të zyrtarit dhe vëllai i bashkëjetuesit nuk përfshihet në rrethin e personave të cilët mund të përbëjnë konflikt të mundshëm interesi. Premisë për të qenë në kushte e konfliktit të interesit është si fillim ekzistenca e bashkëjetesës. Në lidhje me sa më sipër dua të sqaroj se:

Së pari: marrëdhënia e bashkëjetesës parashikohet në nenin 163 të Kodit të Familjes 'Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie'. Në datën 1.10.2012 kur është marrë vendimi i mosfillimit, nuk ka ekzistuar marrëdhënia e bashkëjetesës. Një udhëtim i përbashkët nuk përbën bashkëjetesë pasi nuk ka karakter të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm.

Së dyti: Njohja me një person nuk nënkupton domosdoshmërisht njohjen me vëllain e tij, për më tepër të proceseve gjyqësore ku ky person (vëllai) ka pasur cilësinë e avokatit. Kjo është çështje fakti dhe nuk mund të prezumohet”.

7.11 Shpjegime në lidhje me gjetjen e dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë

7.11.1 Në lidhje me këto gjetje, subjekti sqaroi se informacionin në lidhje me kontratat e shitblerjes i është vënë në dispozicion nga z. G. H. . Ajo shpjegoi se prona e përfutur nga z. G. H. me anë të kontratës së shitjes nr***, datë 30.10.2013, nuk është e njëjtë me pronën për të cilën është disponuar me vendimin nr. ***, datë 30.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (pjesë e praktikës së materialit kallëzues nr. ***), pasi nëse i referohet të dhënave të dispozitivit të vendimit dhe të kontratës në fjalë, ato ndodhen në zona të ndryshme kadastrale (përkatësisht z. k. *** dhe z. k. ***).

7.11.2 Në lidhje me faktin nëse prona objekt i vendimit nr. ***, datë 30.4.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ku avokat i të paditurit Th. S. ka qenë z. G. H., është e njëjtë me pronën për të cilën kallëzuesi (paditësi në procesin civil) ka pretenduar falsifikim të provave për dëshminë e trashëgimisë, duke e manipuluar atë, subjekti sqaroi se në vendimin nr. ***, datë 24.12.2008, janë përcaktuar trashëgimtarët ligjorë të trashëgimlënësit V. S., duke përcaktuar pjesën takuese të secilit trashëgimtar, pa saktësuar se cilat janë pasuritë e trashëgimlënësit.

7.12 Në lidhje me konstatimin e gjashtë të Komisionit, se subjekti nuk ka kryer hetime në lidhje me kallëzimin për manipulimin e dëshmisë së trashëgimisë, por ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, subjekti shpjegoi:

7.12.1 “Për t’u dhënë përgjigje pretendimeve të kallëzuesit, i rikthehemi vendimit nr. ***, datë 24.12.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendim në të cilin pretendohet se është bërë manipulimi, në lidhje me rrethin e trashëgimtarëve. Vërejmë se ky vendim ka për objekt lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin V.S. dhe natyrshëm lind pyetja, nëse sipas legjislacionit në fuqi, e ndjera V. S. (A.), e ëma e kallëzuesit, hyn në radhën e trashëgimtarëve të radhës së parë, për këtë trashëgimlënës. Referuar nenit 361 të Kodit Civil, trashëgimtarë të radhës së parë për trashëgimlënësin V.S., janë fëmijët e tij dhe bashkëshortja (e cila kishte vdekur më herët se trashëgimlënësi) dhe, për pasojë, themi se vendimi nr. ***, datë 24.12.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që ka përcaktuar rrethin e trashëgimlënësve për të ndjerin V. S. është i bazuar në ligj. E ndjera V. S.(A.), motra e trashëgimlënësit, nuk mund ta trashëgonte atë, pasi nuk është një nga trashëgimtarët e radhës së parë dhe për pasojë nuk mund të thuhet se ajo është përjashtuar nga trangu familjar, pasi ajo nuk është pjesë e trangu familjar të të ndjerit V.S. Në kallëzimin e tij z. A. ndër të tjera ka thënë se: ‘ Këto prona i kanë marrë fëmijët e dajos, duke shmangur me prova false nënën time nga trangu familjar. Ata kanë bërë dëshmi trashëgimie në vitin 2008 dhe më pas kanë bërë gjyq duke marrë pronat meqenëse kanë qenë në emër të dajos në momentin e marrjes së tyre nga shteti...’. Pra, nga ana e tij është pranuar fakti se në momentin që prona është shpronësuar si pasojë e Reformës Agrare, ajo ndodhej e regjistruar në emër të dajos së tij z. V.S., ndonëse në atë kohë pjesë e familjes ka qenë edhe nëna e tij. Pra, shohim se problemi nuk lidhet me dëshmitë e trashëgimisë, por me pretendimet e tij për pasurinë para se ajo të konfiskohej nga shteti për shkak të Reformës Agrare, fakt i cili mund të provohet dhe të marrë zgjidhje vetëm nëpërmjet një procesi civil. Sa më sipër rezulton se asnjë nga dëshmitë e trashëgimisë të cituara më sipër dhe të lëshuara me vendim gjykate nuk është e manipuluar. Nga ana e tij i ndjeri V. S. me vendimin nr***, datë 10.5.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është “... njohur pronar mbi 13 ha tokë kullotë në vendin e quajtur ‘***’, ***...’, si dhe është rivendosur në afat për të kërkuar të drejtën e tij.

Neni 391, i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: ‘(i) Në vendimin e gjykatës duhet të tregohet fakti i vërtetuar prej asaj dhe provat në bazë të të cilave është vërtetuar fakti; (ii) ...(iii) vendimi nuk ka fuqi provuese kundër personave fizikë a juridikë që nuk kanë qenë thirrur në rast se e kundërshtojnë faktin e vërtetuar në vendim’. Parashikimi i paragrafit të tretë të nenit 391 të Kodit të Procedurës Civile mbulon tërësisht interesat e palëve, të cilët nuk kanë qenë të thirrur gjatë një procesi vërtetim fakti, duke kundërshtuar faktin e vërtetuar me atë vendim, situatë e cila zgjidhet përsëri nëpërmjet një procesi civil. Në lidhje me faktin e parashtruar si në shkresë ashtu edhe në kallëzim nga z. F. A., se pronat e përfituara më pas u ishin shitur personave të ndryshëm, duhet theksuar se marrëdhënia juridiko-civile e shitblerjes është një veprim juridik i lejuar nga ligji dhe për pasojë thënia e këtij fakti nga ana e kallëzuesit, për sa kohë nuk ngriheshin pretendime se ishin bërë në kundërshtim me ligjin, nuk mund të thuhet se këto veprime përmbanin element të figurës së ndonjë vepre penale.

Të gjitha sa u thanë më sipër, sqarojnë besoj në mënyrë shteruese se kërkesa dhe kallëzimi i z. F. A. nuk përmbante element të asnjë figure të ndonjë vepre penale dhe për pasojë, materiali kallëzues nuk plotësonte elementin thelbësor për t’u regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave, që është vetë ekzistenca e veprës penale. Nisur nga sa më sipër, në datën 1.10.2012 nga ana ime është marrë vendim ‘Për mosfillimin e procedimit penal’, në bazë të germës ‘ç’ të nenit 290 të Kodit të Procedurës Penale, pasi është vlerësuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Pikërisht të njëjtën gjë ka thënë edhe Prokuroria e Përgjithshme, e cila me shkresën nr. 85/1, datë 19.2.2014 e ka sqaruar atë se ‘zgjidhja e kërkesave të tij me objekt mosmarrjen parasysh nga gjykata të kërkesave të tij gjatë shqyrtimit të çështjeve gjyqësore civile

ku është palë, nuk është objekt i punës së prokurorisë. Gjithashtu, e ka orientuar që të ankohet në gjykatën më të lartë ose në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, duke vlerësuar se ankimi i paraqitur nga z. A. nuk përmbante element të figurës së ndonjë veprë penale, pasi në të kundërt ankimi do të kishte kaluar për verifikim prokurorisë kompetente. Z. A. nuk rezulton ta ketë kundërshtuar në gjykatë këtë vendim, ndonëse në denoncimin e paraqitur pranë Komisionit shprehet se prokurori nuk ka kryer hetimin e veprës penale dhe ka vendosur pushimin e çështjes.

Në lidhje me faktin se materiali kallëzues është regjistruar në regjistrin e mosfillimit të çështjeve penale, për veprën penale ‘falsifikim të dokumenteve’ parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, kërkoj të sqaroj se çdo material kallëzues, i cili depozitohet në prokurori pasqyrohet në regjistrin e kallëzimit të veprave penale me qëllim dokumentin e tij, ku merr edhe një numër regjistri/kallëzimi, veprim i cili është tërësisht administrativ dhe bëhet nga ana e zyrës së regjistrit.

Në praktikë, materiali kallëzues i kalonte zyrës së regjistrit nga ana e titullarit, pasi bëhej shënimi se cilit prokuror duhet t’i kalonte materiali. Zyra e regjistrit pasi bën shënimet përkatëse në regjistër, i kalon materialin prokurorit të caktuar, kundrejt nënshkrimit. Deri në këtë moment, prokurori i çështjes nuk ka asnjë ndikim mbi mënyrën se si apo se çfarë do të pasqyrohet në regjistrin e kallëzimeve nga ana e zyrës së regjistrit. Në kushtet kur nga ana e prokurorit, në përfundim të vendimit është arritur në konkluzionin se fakti i kallëzuar nuk përmban element të figurës së veprës penale, nuk bën sens që në regjistrin e Mosfillimeve të Çështjeve Penale të thuhet se materiali kallëzues bën fjalë për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal, në një kohë që prokurori i çështjes është shprehur se në rastin konkret vepra penale nuk ekziston, pasi fakti i kallëzuar nuk përmban element të ndonjë veprë penale.

Në lidhje me citimin në vendimin e mosfillimit se ‘nga ana e kallëzuesit nuk ishin pretenduar dokumenta konkretë të falsifikuar’, sikurse sqarova nga analiza e bërë më sipër dhe në vendimin e mosfillimit, ka rezultuar se fakti i kallëzuar nga z. A. nuk përmbante elementë të figurës së ndonjë veprë penale. Pavarësisht këtij argumenti, nga ana ime u gjend e nevojshme të citohej se nga ana e kallëzuesve nuk pretendohen dokumente konkretë të falsifikuar, pasi në kushtet ku nga veprimet verifikuese nuk u evidentuan dokumente të falsifikuara apo të dhëna që të mbështesnin pretendimet e kallëzuesit, duhej theksuar se verifikimi i materialit, në kushtet ku nuk konstatoheshin element të figurës së ndonjë veprë penale, nuk mund të vazhdonte për sa kohë nuk kishte pretendime konkrete, për dokumente konkrete, përveç atyre të administruara bashkë me procesverbalin e kallëzimit.

Në lidhje me citimin në vendimin e mosfillimit se materiali kallëzues bën fjalë për veprën penale ‘shpërdorim të detyrës’, parashikuar nga neni 248 i Kodit të Procedurës Penale, kërkoj të sqaroj Komisionin që kjo pjesë e vendimit të mosfillimit të datës 1.10.2012 është një mbartje, nga një vendim tjetër mosfillimi, për shkak se duhet të jetë punuar mbi një vendim mosfillimi, pasi kuptohet që nuk mund të ndodhë që në fillimin e vendimit të mosfillimit të thuhet se materjali kallëzues bën fjalë për një vepër penale të caktuar dhe nga ana tjetër në konkluzion të thuash se fakti i kallëzuar nuk përmbante element të figurës së ndonjë veprë penale. Theksoj edhe një herë që ky është vetëm një lapsus nga ana ime”.

7.13 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashitroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim, për secilën nga çështjet e mësipërme.

Vlerësimi i Komisionit

7.14 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me provat e administruara gjatë hetimit, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal denoncuesi nuk e ka ushtruar të drejtën e ankimit, trupi gjykues çmoi se shpjegimet janë bindëse.

7.15 Rezultoi se pasuria e përfutur nga vëllai i bashkëjetuesit me anë të kontratës së shitblerjes nuk ndodhet në të njëjtën zonë kadastrale me pasurinë objekt i proceseve gjyqësore civile nga i cili ka derivuar kallëzimi penal, për të cilin subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal.

7.16 Vendimi i subjektit për mosfillim të procedimit penal nuk është marrë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi në kohën e marrjes së vendimit subjekti nuk kishte filluar bashkëjetesën me z. F. H. dhe nuk u provua që në atë kohë ajo kishte njohje me vëllain e bashkëjetuesit, z. G.H., avokat në procesin civil.

7.17 Z. G. H. nuk kishte asnjë pozitë procedurale në procesin penal të hetuar nga subjekti.

8. Denoncimi nr. * prot., datë 9.9.2021, nga shtetasja F. G.**

Denoncuesja ka ngritur një sërë pretendimesh për shkelje të etikës profesionale nga avokati i saj mbrojtës në procesin penal, si dhe ka pretenduar se nga ana e prokurores janë kryer shkelje procedurale dhe hetime të njëanshme. Pasi iu kërkua nga Komisioni informacion dhe/apo dokumentacion në lidhje me procedimin në fjalë, shpjegoi se ankesa është posaçërisht ndaj avokatit dhe se gjatë sqarimeve i është dashur të përmendë emra të ndryshëm, jo vetëm emrin e prokurores¹⁵⁸.

Pavarësisht nga sa më lart, me qëllim vlerësimin e saktë të rrethanave të denoncuara, Komisioni i kërkoi¹⁵⁹ Gjykatës së Lartë (gjykata ku ndodhej dosja) një kopje të njëzuar me origjinalin të dosjes gjyqësore, duke përfshirë edhe fashikullin hetimor, që i përket procedimit të mësipërm.

Nga dosjet që vendosi në dispozicion Gjykata e Lartë¹⁶⁰, rezultoi se:

Denoncuesja ka qenë mësuese në një shkollë 9-vjeçare në Tiranë. Një prind ka kallëzuar se ajo në klasë ka ushtruar dhunë ndaj djalit të tij. Për këtë kallëzim penal¹⁶¹, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë (prokuror Silvana Lule) ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “keqtrajtim i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b i Kodit Penal. Në përfundim të hetimeve, subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka kërkuar dërgimin për gjykim të çështjes nr. ***, të vitit 2019, me të pandehur shtetasen F.G., akuzuar për kryerjen e veprës penale “keqtrajtim i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b/1 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtari i hetimeve paraprake dhe seancës paraprake) ka vendosur “*Pushimin e çështjes penale*”¹⁶².

Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit penal të sipërpërmendur, pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin për gjykim të çështjes në fjalë me të pandehur shtetasen F. G., e akuzuar për kryerjen e veprës penale “keqtrajtim i të miturit”, parashikuar nga neni 124/b/1 i Kodit Penal.

¹⁵⁸E-mail te datës 10.9.2021.

¹⁵⁹Shkresa nr. *** prot., datë 13.9.2021.

¹⁶⁰Shkresa nr.*** prot., datë 20.9.2021 (administruar në Komision me nr. ***prot., datë 24.9.2021).

¹⁶¹Kallëzim penal nr. ***, viti 2019.

¹⁶²Vendimi nr. ***, datë 13.7.2020.

Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar ndër të tjera se: *“Në analizë të veprimeve të marra deri në fazën e hetimeve paraprake nga prokurori, sipas procedurës penale, rezulton se veprimet procedurale të kryera janë të plota dhe konform ligjit dhe në respekt të funksionit të tij kushtetues për ndjekjen penale duke e përmbyllur me të drejtë atë në kalimin për gjykim”*.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni vlerësoi që në kushtet kur me vendim të formës së prerë të gjykatës është vlerësuar që veprimet procedurale të kryera nga subjekti janë të plota dhe sipas ligjit dhe funksionit të saj kushtetues, nuk ka të dhëna për të hetime të mëtejshme nga Komisioni.

9. Denoncimi nr. * prot., datë 14.6.2019, nga shtetasi R. K.**

9.1 Denonuesi ka ngritur pretendime se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të plotë e të gjithanshëm të çështjes, ka kryer shkelje procedurale në hetimin e çështjes ku ai ka qenë i kallëzuar dhe më pas i pandehur. Ai ka shpjeguar rrethanat e ngjarjes për të cilën është hetuar nga subjekti i rivlerësimit. Ai ngre pretendimin se nuk është pyetur kurrë nga prokurorja dhe se aktekspertimi i marrë nga prokurorja si provë, është bërë në kundërshtim me KPP dhe Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore nr. 7194/1, datë 24.1.2006, duke parashtruar edhe arsytet për të argumentuar këtë pretendim.

9.2 Prokuroria administroi¹⁶³ vendimin penal nr. ***, datë 15.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasit R. K. . Me këtë vendim, gjykata ka vendosur deklarinim fajtor të të pandehurit R.Dh.K. për kryerjen e veprës penale “dhuna në familje” dhe dënimin e tij me një muaj burgim.

9.3 Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 15.7.2020, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 15.5.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit R. K. . Ajo ka arsyetuar se: *“Gjykata e Apelit çmon se nga ana e organit të prokurorisë dhe gjykatës së shkallës së parë nuk është bërë një analizim i drejtë i provave, të cilat çojnë në zbardhjen e çështjes. Gjykata çmon të theksojë se barrën e provës për të provuar akuzën e ka organi i akuzës, i cili nëpërmjet provave të paraqitura në gjykim, duhet t'i krijojë gjykatës bindjen ‘përtej çdo dyshimi të arsyeshëm’ se vepra penale është kryer dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Pra, në procesin penal organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri. Rezulton se nga provat e paraqitura në gjykim nuk provohet lidhje shkakësore mes veprimeve të kryera dhe ardhjes së pasojës. Nga ana e organit të prokurorisë, por edhe nga gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj nuk është treguar se kush është veprimi i kryer nga ky i pandehur që e ngarkon atë me faj. Nga provat e shqyrtuara në dosjen gjyqësore, gjykata vëren se nuk ka një mendim të qartë nga ana e mjekut ligjor për të provuar pretendimin e të dëmtuarës”*.

9.4 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se pretendimi i denoncuesit për shkelje procedurale dhe për mosmarrjen e provave të duhura dhe në përputhje me ligjin, si dhe për mosanalizimin e duhur të provave nga ana e prokurores, është i bazuar, i konstatuar dhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.

9.5 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërua të japë sqarime për sa më lart.

¹⁶³Me shkresën nr***prot., datë 9.7.2021, (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 9.7.2021).

Qëndrimi i subjektit

9.6 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti në Komision prapësimet si vijojnë:

9.6.1 Në lidhje me shkeljet procedurale dhe marrjen e provave të duhura subjekti shprehet se:

“Gjatë hetimit të çështjes nga ana ime denoncuesi, i cili në fund të hetimit ka qenë i asistuar nga një mbrojtës, nuk ka bërë asnjë kërkesë për marrjen e provave të tjera. Pasi është njohur me aktet e dosjes ka pasur vetëm një kërkesë nga mbrojtësi i tij për kopje të akteve, kërkesë kjo e pranuar me vendimin datë 10.3.2017, në bazë të neneve 105 dhe 110 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu, referuar vendimit të shkallës së parë, pavarësisht se Prokuroria është përfaqësuar nga një prokuror tjetër, nuk ka pasur pretendime në lidhje me vlefshmërinë e akteve (neni 128 e vijues i Kodit të Procedurës Penale) apo përdorshmërinë e provave (neni 151/3 i Kodit të Procedurës Penale). Nëse do të ishin konstatuar shkelje procedurale, me ose pa kërkesën e palës, normalisht gjykata do të ishte shprehur.

Gjithashtu, edhe vendimi i Gjykatës së Apelit në lidhje me këtë çështje, nuk ka konstatuar asnjë shkelje procedurale, por ka vendosur pushimin e çështjes në bazë të çmuarjes së provave (neni 152 i Kodit të Procedurës Penale)”.

9.6.2 Në lidhje me analizën e provave subjekti shprehet se:

“Në lidhje me këtë procedim konstatoj se ai është regjistruar më 25.10.2016, dhe oficeri i policisë gjyqësore ka vendosur kryerjen e ekspertimit mjeko-ligjor, për personin e dëmtuar.

Kallëzuesja E. Sh., ndër të tjera, ka kallëzuar se shtetasi R. K., e ka kapur nga duart dhe e ka tërhequr forcërisht dhe e ka gjuajtur me grushta dhe shkelma në të gjithë trupin. Ajo ka pretenduar se si pasojë e dhunës fizike ka pësuar dëmtime në dorën e majtë dhe në ijë. Këtë pretendim ajo e ka konfirmuar edhe e pyetur në cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e veprës penale. Në vijim, një prej deklaruësve, znj. L. K. ka shpjeguar se ‘ ... nipi im R. K. e ka shtyrë nga vetja mbesën time ’.

Pra, nga ana e deklaruësve konfirmohet se ka pasur një konflikt fizik mes palëve dhe prej këtij konflikti pretendime për dëmtime, ka pasur znj. E. Sh. .

*Gjatë hetimit është administruar shkresa nr. *** prot., datë 3.10.2016, e Institutit të Mjekësisë Ligjore sipas të cilit e dëmtuara nuk është paraqitur për vizitë mjekësore, pranë ambulancës së këtij instituti.*

E dëmtuara është pyetur sërish më 1.12.2016, ku ka pretenduar se ditën e ngjarjes ka shkuar vonë në I.M.L. dhe nuk ka mundur të kryejë vizitën, por ka shkuar në Spitalin e Traumës, ku ka marrë mjekimin e duhur dhe ka paraqitur një kopje të kartelës ditore. Në këto kushte, nga ana e policisë gjyqësore në bazë të nenit 294/1 të Kodit të Procedurës Penale është vendosur kryerja e ekspertimit ligjor, mbi bazën e dokumentacionit të administruar.

*Në vijim, është administruar aktekspertimi mjeko-ligjor nr. ***, viti 2017, nga studimi i të cilit rezulton se së pari, ekspertimi është kryer mbi bazën e këqyrjes së kartelës ditore të të dëmtuarës, kartelë nr. ***, Spitali Ushtatrac, Tiranë, ku ajo është paraqitur më 24.8.2016 dhe së dyti, është konstatuar shembje e indeve të buta të pjesës së mbrapme dhe të poshtme të bacinit dhe të kyçit të dorës së majtë, dëmtime të shkaktuara me mjet të fortë mbretës.*

Për sa më sipër, rezulton nga aktet e dosjes se procedimi nuk është pushuar apo pezulluar ndonjëherë, se pas administrimit të aktekspertimit mjeko-ligjor është regjistruar emri i personit nën hetim dhe vlerësuar deklaratimet e të dëmtuarës, si edhe të deklaruës L. K., se mes tyre ka pasur konflikt fizik, pasur parasysh edhe dëmtimet e konstatuara në aktekspertimin mjeko-ligjor, të cilat përputhen me pretendimet e të dëmtuarës, por edhe me mekanizmin e ngjarjes shpjeguar nga deklaruësit e tjerë, nga ana ime është vlerësuar se veprimet konkrete të shtetasit R.K. kanë qenë shkaku i drejtpërdrejt dhe përcaktues i dëmtimeve të kallëzueses (neni 13 i Kodit Penal). Pasi është pyetur në cilësinë e të pandehurit z. R. K. e ka mohuar akuzën, e drejtë e cila i jepet ne bazë të nenit 34/a të Kodit të Procedurës Penale.

Në kërkesën për gjykim, drejtuar gjykatës nga ana ime është cituar qartë se veprimet e dhunës fizike ndaj motrës së tij (shtyrja) kanë qenë ato që i kanë sjellë asaj dëmtimet e përcaktuara në akt”.

Në vijim, subjekti ka shpjeguar se gjatë gjykimit të çështjes nuk ka qenë ajo përfaqësuese e prokurorisë, për shkak se z. K. ka nisur një seri shkrimesh fyese në cilësinë e saj si prokurore dhe ajo ka paraqitur ndaj tij kallëzim penal ndaj tij, në këto kushte, ka hequr dorë nga hetimi i çështjes. Gjithashtu, ka shpjeguar se: *“Në momentin që kam vendosur dërgimin për gjykim të çështjes penale neni 327/2 të Kodit të Procedurës Penale, kam vlerësuar:*

- *deklarimet e viktimës, e cila ka shpjeguar dëmtime të cilat me vonë u konstatuan pikërisht të tilla prej ekspertimit mjeko-ligjor;*
- *deklarimet e L. K., e cila ka shpjeguar se mes palëve pati konflikt fizik;*
- *aktekspertimin mjeko-ligjor.*

Nisur nga marrëdhënia e posaçme familjare motër/vëlla, shtetasi R. K. është marrë i pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal”.

9.7 Në seancën dëgjimore të zhvilluar më 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashitroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

9.8 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me provat e administruara gjatë hetimit, Komisioni çmoi se vendimi për dërgimin për gjykim të çështjes penale është bërë bazuar në vlerësimin e provave nga subjekti i rivlerësimit. Analiza dhe vlerësimi i provave nga subjekti ka të bëjë me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit. Në këtë kuptim, vlerësohet se bazuar në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk është në kompetencën e Komisionit të gjykojë mbi korrektësinë e vendimit dhe themelit të çështjes.

Nuk u konstatuan shkelje procedurale nga ana e subjektit të rivlerësimit. Gjykata e Apelit në vendimin e saj nuk ka konstatuar shkelje procedurale dhe disponimi i saj se nga ana e prokurores, subjekt i rivlerësimit, nuk është bërë një analizim i drejtë i provave të cilat çojnë në zbardhjen e çështjes, ka të bëjë me themelin e çështjes, me vendimmarrjen e subjektit, sikurse u sqarua më lart, gjykimi i të cilës nuk është kompetencë e Komisionit.

10. Denoncimi nr. * prot., datë 13.9.2021, nga shtetasi A. Ç.**

10.1 Denoncuesi ka bërë denoncim për prokuroren me arsyetimin se ka zvarritur në mënyrë të qëllimshme hetimet për kallëzimin penal të bërë prej tij me nr. ***, të vitit 2019, për të cilin prokurorja më 8.12.2020 ka vendosur mosfillimin.

10.2 Komisioni administroi një kopje të njësuar me origjinalin të fashikullit të mosfillimit të procedimit penal për këtë kallëzim penal¹⁶⁴, nga i cili rezultoi se:

10.2.1 Denoncuesi ka zgjidhur martesën me bashkëshorten e tij S. Ç. dhe në lidhje me fëmijën e lindur nga kjo martesë, gjykata ka vendosur ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga nëna. Babait (denoncuesit) gjykata i ka lënë të drejtën për të takuar fëmijën e tij ditën e diel të çdo jave në orarin 10:00 – 18:00 dhe detyrimin ushqimor në masën 5,000 lekë/muaj.

Ai ka respektuar detyrimin e tij për pagimin e pensionit ushqimor dhe ka kërkuar të takojë djalin e tij sipas vendimit të gjykatës, por kjo e drejtë i është mohuar nga ish-bashkëshortja, e cila në mënyrë të fshehtë është larguar bashkë me djalin. Pas investigimeve të bëra prej tij, ka zbuluar që fëmija është larguar për në Greqi, por pa mundur të sigurojë informacion se kush e ka shoqëruar djalin e tij në këtë lëvizje të paligjshme, për të cilin ai nuk ka dhënë miratim. Ka bërë kallëzim penal me akuzën “keqtrajtim i të miturve”, “mosnjoftim i ndryshimit të vendbanimit” dhe “marrja e padrejtë e fëmijës”, parashikuar nga nenet 124/b, 126 dhe 127 të Kodit Penal.

10.2.2 Në përfundim, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur dërgimin e çështjes penale në gjykim, me të pandehur shtetasen S. Ç., e akuzuar sipas nenit 320 të Kodit Penal dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë më 28.9.2020¹⁶⁵ ka vendosur deklarimin fajtor të të pandehurës për veprën penale “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës” dhe në bazë të nenit 320 të Kodit Penal, dënimin e saj me 6 muaj burgim.

10.2.3 Meqenëse sërish nuk arrinte të takonte djalin, në nëntor të vitit 2020 z. A. Ç. ka depozituar sërish kallëzim penal, duke sqaruar këtë herë se nga sistemi *TIMS* i ka rezultuar se fëmija i tij ka kaluar në PKK Kakavijë i pashoqëruar nga e ëma, por nga një person tjetër, për të cilin ka përcaktuar targën e automjetit dhe se ish-bashkëshortja e tij ka hyrë dhe ka dalë disa herë nga kufiri shqiptar, por asnjëherë nuk e ka pasur fëmijën me vete dhe nuk dihet fati i fëmijës. Gjithashtu, në kallëzim ka theksuar se dyshimet e tij janë edhe për përfshirje të personave të tjerë në veprimtari kriminale lidhur me djalin e tij të mitur dhe se në PKK Kakavijë nuk janë kryer verifikime se me çfarë dokumenti shoqërues ka kaluar djali i tij kufirin, sepse nga ana e tij (kallëzuesit) nuk është dhënë pëlqimi për lëvizje të tilla.

10.2.4 Në këtë kallëzim, denoncuesi ka identifikuar pronarin e automjetit me të cilin ka kaluar kufirin djali i tij, si dhe adresën e pronarit të automjetit, në Vlorë dhe në kallëzimin penal ka kërkuar fillimin e ndjekjes penale në ngarkim të ish-bashkëshortes së tij, për veprën penale “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, “mosnjoftim i ndryshimit të vendbanimit”, “marrja e padrejtë e fëmijës”, “trafikimi i të miturve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar respektivisht nga nenet 320, 126, 127 dhe 128/b të Kodit Penal.

10.2.5 Subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka vendosur mosfillimin e procedimit për këtë kallëzim penal, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në vendim ka arsyetuar: *“Shtetasja S. H. është deklaruar fajtorë për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me faktin penal se ajo ka larguar fëmijën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke bërë të pamundur ekzekutimin e vendimit të gjykatës, në lidhje me të drejtën e të atit të takojë fëmijën. Në kallëzimin e dytë, nuk janë paraqitur të dhëna të ndryshme dhe pretendimet e tij për veprat penale të parashikuara nga*

¹⁶⁴Shkresa nr. *** prot., datë 23.9.2021, e Komisionit drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe shkresa e kësaj prokurorie nr. *** prot., datë 17.9.2021 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 17.9.2021).

¹⁶⁵Vendimi nr. ***, datë 28.9.2020.

nenet 124/b dhe 128/b mbeten vetëm në faktin se e ëma është larguar me fëmijën, fakt për të cilin ajo është dënuar.

Gjithashtu, e rëndësishme është të theksohet se edhe nëse do të kishte elementë të veprës penale të parashikuara nga neni 186 i Kodit Penal, pasur parasysh se fëmija është larguar në vitin 2011, në bazë të nenit 66 të Kodit Penal, pika ‘ç’, vepra penale është parashkruar”.

10.3 Trupi gjykues mban parasysh faktin se germa “ç” e nenit 66, të Kodit Penal parashikon parashkrimin e ndjekjes penale, kur nga kryerja e veprës deri në çastin e marrjes së personit si i pandehur kanë kaluar 5 vjet për krimet që parashikojnë dënim deri në pesë vjet burgim ose gjobë dhe vepra penale e parashikuar në nenin 186 të Kodit Penal, e referuar nga subjekti si e parashkruar është vepra penale “falsifikimi i dokumenteve”.

Në arsyetimin e vendimit të mosfillimit, subjekti ka arsyetuar se *në kallëzimin e dytë nuk janë paraqitur të dhëna të ndryshme dhe pretendimet e tij për veprat penale të parashikuara nga nenet 124/b dhe 128/b mbeten vetëm në faktin se e ëma është larguar me fëmijën, fakt për të cilin ajo është dënuar.*

Në fakt, nga kallëzimi (kallëzimi i dytë, hetuar nga subjekti) rezulton se kallëzuesi ka paraqitur të dhëna të tjera që nuk i kishte paraqitur në kallëzimin e parë: ka identifikuar pronarin e automjetit me të cilin ka kaluar kufirin djali i tij, si dhe adresën e pronarit të automjetit, në Vlorë, dhe ka ngritur dyshime edhe për përfshirje të personave të tjerë në veprimtari kriminale lidhur me djalin e tij. Në denoncim ka pretenduar se sipas të dhënave të marra prej tij, rezulton se automjeti në fjalë është në pronësi të shtetasit H. G. me banim në lagjen “****”, në Vlorë. Gjithashtu, ka sqaruar se nga verifikimet e bëra nga ana e tij rezulton se fëmija S. Ç. është i regjistruar në regjistrat e gjendjes civile të lagjes “****” në Vlorë, që në prill të vitit 2012 dhe që nga viti 2014 nuk figuron në këtë vendbanim apo në ndonjë vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

10.4 Trupi gjykues solli në vëmendje faktin që lagjja “****” në Vlorë është lagjja ku subjekti ka deklaruar adresën e saj në DIPP-të e viteve 2008 – 2011.

10.5 Përveç kësaj, në këtë kallëzim, krahas veprave penale të pretenduara në kallëzimin e parë, kallëzuesi ka pretenduar edhe konsumimin e veprës penale “trafikimi i të miturve”, kryer në bashkëpunim, që nuk ishte pjesë e veprave të pretenduara në kallëzimin e parë.

10.6 Nga fashikulli i mosfillimit rezulton se subjekti nuk ka kryer hetime në lidhje me këto pretendime të kallëzuesit dhe ka administruar kopje të kallëzimit penal të parë (të vitit 2018) dhe kopje të njoftimit për përfundimin e hetimeve në kuadër të procedimit penal të vitit 2018. Pjesë e fashikullit të prokurorisë, përveç kallëzimit penal, janë këto dy akte, vendimet e gjykatave (vendimi për zgjidhjen e martesës dhe vendimi për deklarimin fajtores të ish-bashkëshortes së denoncuesit), kërkesa për dërgimin në gjyq të çështjes së parë, si dhe printime nga sistemi *TIMS* për ish-bashkëshorten e denoncuesit dhe për fëmijën.

10.7 Përveç kësaj, në arsyetim prokurorja ka arsyetuar gjithashtu se në procedimin e vitit 2020 (kallëzimi i parë), në njoftimin për përfundimin e hetimeve, i është dhënë shpjegim pretendimeve të kallëzuesit për veprat penale 126, 127 dhe 124/b të Kodit Penal. Në fakt, nga ky njoftim rezulton se nuk është bërë arsyetim mbi ekzistencën ose jo të elementëve të këtyre veprave penale, thjesht është referuar ajo çka rezulton nga sistemi *TIMS*.

10.8 Vepra penale “pengim për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal për të cilin ish-bashkëshortja e kallëzuesit është dënuar, është një veprë që vijon të kryhet, pra ish-bashkëshortja vijon ta kryejë këtë veprë edhe pas dënimit.

10.9 Gjithashtu, trupa evidentoi një element që rezultoi nga shqyrtimi i këtij denoncimi. Sikurse u tha më lart, në kallëzimin për të cilin është vendosur mosfillimi, denoncuesi ka identifikuar pronarin e automjetit me të cilin ka kaluar kufirin djali i tij, si dhe adresën e pronarit të automjetit, në Vlorë, dhe prokurorja nuk e ka marrë në pyetje këtë person dhe as personat që kallëzuesi ka pretenduar që kanë dijeni për ngjarjen, që janë nëna dhe vëllai i ish-bashkëshortes së tij.

10.10 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga kallëzuesi dhe vendimi i mosfillimit të procedimit penal për këtë kallëzim, është bërë në shkelje të ligjit procedural.

10.11 Me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime për sa më lart.

Qëndrimi i subjektit

10.12 Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti paraqiti në Komision shpjegimet, sipas të cilave kallëzimi penal i denoncuesit është paraqitur vetëm 8 ditë pasi vendimi ka marrë formë të prerë, ose 1 muaj e 20 ditë pasi ajo është deklaruar fajtores. Ka shpjeguar se kallëzimi i datës 20.11.2020, të cilin ajo ka vlerësuar, është bërë për të njëjtat vepra penale dhe për të njëjtat fakte, duke shtuar vetëm nenin 128/b të Kodit Penal (trafikimi i të miturve), por jo të dhëna apo elementë të mundshëm për këtë veprë penale.

10.13 Sipas shpjegimeve të saj: *“Në kallëzimin penal nr***, viti 2018, për të cilin është regjistruar procedimi penal nr. ***, i të njëjtit vit është pretenduar vënia para përgjegjësisë penale e personit për veprat penale ‘keqtrajtimi i të miturit’, ‘mosnjoftimi i ndryshimit të vendbanimit’, ‘marrja e padrejtë e fëmijës’, parashikuar nga nenet 124/b, 126 dhe 127 të Kodit Penal. Në vijim të hetimit të këtij procedimi, rezulton se pas veprimeve hetimore nga prokurori është përpiluar akti ‘njoftim mbi përfundimin e hetimeve paraprake’, ku rezulton e cituar se ‘gjatë deklarimit ai ka pretenduar se e kallëzuara duhet të ketë siguruar me anë të falsifikimit ndonjë dokument noterial ... dhe ka kërkuar të merren në përgjegjësi penale për veprat penale nenet 124/b, 126 dhe 127 të Kodit Penal, përveç nenit 320 të Kodit Penal, për të cilin ajo është marrë e pandehur”.*

*Pikërisht, nëpërmjet këtij akti kallëzuesi është njohur se nga hetimi ka rezultuar se fëmija është larguar nga Shqipëria, me mjetin me targa ***.*

Pra, pretendimet që ai ka paraqitur në kallëzimin e datës 20.11.2020, janë vlerësuar dhe marrë në konsideratë gjatë procedimit penal për të cilin ajo është dënuar dhe nuk ka rezultuar nga dosja apo nga vendimi i gjykatës, se gjatë seancës paraprake ka pasur pretendime¹⁶⁶. Në kallëzimin e dytë, ai ka identifikuar drejtuesin e mjetit. Të gjitha pretendimet që ka paraqitur në kallëzimin e dytë, i referohen fakteve me të cilat është njohur nga procedimi i parë.

Referuar procedurës, njoftimi për përfundimin e hetimeve, sipas nenit 237/2 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori njofton mbi përfundimin e hetimeve paraprake të pandehur, mbrojtësin apo viktimën e veprës penale. Pas kësaj prokurori, ka kërkuar dërgimin e cështjes në

¹⁶⁶Vendim nr. *** akti, datë 20.12.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

gjq. Sipas nenit 332/C të Kodit të Procedurës Penale, kur çmon se hetimet paraprake nuk janë të plota, gjykata urdhëron plotësimin e tyre, duke përcaktuar drejtimin dhe kur është rasti, aktet që duhet të kryhen.

*Për sa më sipër, rezulton se nuk ka ndodhur një gjë e tillë, gjykata me vendimin e datës 4889 akti, datë 20.12.2018, ka vlerësuar tërësinë e fakteve në kuadër të procesit penal dhe kallëzuesi nuk ka pasur pretendime në lidhje me to. Në pikën 10 të këtij vendimi gjykata është shprehur se ‘Në kuadër të vlerësimit të elementëve thelbësorë të kërkesës, gjykata vlerëson se në rastin konkret, hetimet e kryera nga organi i prokurorisë janë të plota. Nga vlerësimi në tërësi i akteve të ndodhura në fashikullin e hetimeve paraprake, vlerësohet se organi i prokurorisë ka kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në kuadër të grumbullimit të provave për të provuar faktin penal. Në kushtet kur, të gjitha pretendimet e denoncuesit, janë hetuar në kuadër të procedimit të parë, tërësia e hetimeve është vlerësuar nga gjyqtari i seancës paraprake dhe me tej nga gjykata e themelit, fillimi i procedimit penal do të ishte në kundërshtim me nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit ‘askush nuk mund të gjykohet për të njëjtin fakt për të cilin është gjykuar me vendim të formës së prerë, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga gjykata kompetente. Vendimi për mosfillimin e procedimit penal është marrë në bazë të nenit 290, paragrafi c, i Kodit të Procedurës Penale (fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale), për shkak se pavarësisht sa më lart shpjeguar në lidhje me hetimin, fakti që e kallëzuara është dënuar dhe vendimi ende nuk është ekzekutuar (8 ditë pasi vendimi kishte marrë formë të prerë), nuk do të thotë se ajo mund të hetohet sërish për të njëjtat fakte/prendime. Sipas doktrinës juridike ‘veprat penale vazhduese karakterizohen nga veprime të njëjlojta dhe mendim unik kriminal dhe përbëjnë një vepër penale të vetme’ (komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë I. E., S. K., M. H., f. ***, G., Tiranë 2001). Në vijim, neni 34 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se: ‘Askush nuk mund të dënohet më shumë se një herë për të njëjtën vepër penale dhe as të gjykohet sërish, me përjashtim të rasteve kur është vendosur rigjykimi i çështjes nga një gjykatë më e lartë, sipas mënyrës së parashikuar me ligj’.*

*Në lidhje me konstatimin se një prej personave në kallëzim penal H. G., ka pasur adresën në lagjen ‘***’, Vlorë, lagje në të cilën gjendet banesa e prindërve të mi në Vlorë dhe ku unë kam jetuar përpara vitit 2013, deklaroj se ky person nuk njihet nga ana ime”.*

10.14 Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 27.10.2021, subjekti mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashitroi të njëjtat shpjegime me ato të parashtruara me prapësimet e paraqitura me shkrim.

Vlerësimi i Komisionit

10.15 Pasi analizoi shpjegimet e subjektit në raport me provat e administruara gjatë hetimit, Komisioni çmoi se në kallëzimin e dytë të kallëzuesit (denoncuesit), hetuar nga subjekti i rivlerësimit, kallëzuesi ka kërkuar që znj. S. H. të merret në përgjegjësi penale për 4 vepra penale, konkretisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 320, 126, 127, 128/b të Kodit Penal. Për njërën nga këto vepra, konkretisht për atë të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal “pengime për ekzekutimin e vendimeve të gjykatës”, znj. S. Ç. është dënuar. Dy vepra të tjera penale të cilat kallëzuesi ka pretenduar se janë konsumuar nga ish-bashkëshortja e tij, konkretisht, veprat e parashikuara nga nenet 126 dhe 127 të Kodit Penal, janë pretenduar prej tij edhe në kallëzimin e parë, të hetuar nga tjetër prokuror dhe ky i fundit në kërkesën për dërgimin e çështjes penale në gjykim ka kërkuar gjykimin e çështjes penale me të pandehur shtetasen S.

H., e akuzuar sipas nenit 320 të Kodit Penal, pa u shprehur me vendimmarrje në lidhje me veprat penale të parashikuara nga nenet 126 dhe 127 të Kodit Penal.

Pretendimi i kallëzuesit (denoncuesit) në kallëzimin e hetuar nga subjekti, se znj. S. H. ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 128/b “trafikimi i të miturve”, është pretendim i ri, i cili nuk ka qenë pjesë e kallëzimit të parë dhe i vendimmarrjes së parë.

10.16 Për sa më sipër, trupa çmoi se nuk është para rastit të gjësë së gjykuar dhe subjekti nuk ka kryer veprimet e hetimore për kallëzimin e paraqitur nga kallëzuesi A. Ç. .

10.17 Në lidhje me konstatimin se adresa e pronarit të automjetit me të cilin ka kaluar kufirin shqiptar fëmija ndodhet në lagjen ku subjekti ka deklaruar adresën e saj në DIPP-të e viteve 2008 – 2011, nuk u provua njohja e subjektit me këtë shtetas.

10.18 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga kallëzuesi dhe vendimi i mosfillimit të procedimit penal për këtë kallëzim është bërë në shkelje të ligjit procedural, por e parë në raport me vlerësimin tërësor të subjektit, këto mosveprime të saj nuk janë të asaj shkalle sa të jenë tregues i cilësisë së papranueshme në punë dhe që të sjellin shkarkimin e saj sipas pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Silvana Lule ka plotësuar së bashku kushtet si vijon:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Silvana Lule, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Vendimi u shpall në Tiranë, në datën 29.10.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta